



78 VJET GENOCIDI ÇAM

Të mbijetuarit pushtojnë Kuvendin
Britanikët hapin arkivat e kohës

NEWS BOMB.al

Një punonjës i komunes së Tiranës
27 vjeç, me motrën e vet Police
25-vjeçare krijuan kompaninë fiktive
që lëvroi 5.5 milionë euro. Pleqtë
milionerë të 24 firmave: Një e moshuar
ka vdekur; një çoban lopësh në Greqi;
një nënë 81-vjeçare jeton në azil;
dy bashkëshortë 67-vjeçarë,
të pastrehë; Merita mbledh
gjithë ditën kanaçe nëpër kazanë...
Si funksionoi skema korruptive
e lëvrimin të 19 miliardë lekëve



JANË PLEHRA!

LORO BORIÇI
NJË SHEKULL
NIPI NGA KANADAJA TREGON FUTBOLLISTIN,
BARDH SPANIA PËRGATIT SHKODRËN



BAJRAM BEQAJ
PRESIDENTI
NË SYTË E MIQVE
DHE EKSPERTËVE,
MJEKU QË U BË
GJENERAL DHE TANI
NË KRYE TË SHTETIT

BASHKIM ALIBALI
KËNGËTARI I PAKOHË
QË SFIDOI SKENËN
ME RECITALET
E VETA: FESTIVALI
SOT, ZHYTUR
NË KORRUPSION

TE MAMA'S
RESTORANTI
NË KOSOVË,
FLET PRONARI
PRISHTINALI QË
U KA "VËNË VIZË"
EVROPIANËVE



Redefine
Office



INVESTO ME ZGJUARSI!



**CEL
CEL
EMAIL
EMAIL
WEB**



+355 69 20 73 531
+355 69 20 73 530
info@aksestirana.com
shitjet@matrixkonstruksion.com
www.aksestirana.com

“Çdo shtëpi është një dritare
që sheh drejt jetës.”

-Marco Casamonti



ALTANA
luxury residence



IR
REAL ESTATE
& MANAGEMENT

PËR MË SHUMË INFORMACION KONTAKTONI
ME ZYRËN TONË TË SHITJES NË:

☎ +355 69 607 5324
INFO@IR.AL
WWW.ALTANA.AL

ALTANA LUXURY RESIDENCE ËSHTË NJË PROJEKT EKSKLUZIV PËR SHITJE I MENAXHUAR NGA KOMPANIA IR REAL ESTATE AND MANAGEMENT.



RINGJALJA E DOKTORIT

**NJË PROTESTË KORRIKU QË
LAJMËRON VJESHTËN E NXEHTË POLITIKE**

18

14

BAJRAM BEGAJ

SI E SHOHIN EKSPERTËT DHE
MIQTË PRESIDENTIN E RI

Nga ANTA MUÇAKU

22

GJIRI I KAKOMESË

“BUKUROSHJA” E BRAKTISUR
BËHET GATI PËR TURIZËM

Nga FATOS ÇOÇOLI

36

ABORTI NË KOMUNIZËM

NJË LOPË DHURATË PËR NËNAT,
TAKSA SHITESË PËR BEQARËT

Nga LUELA MYFTARI




66

BASHKIM ALIBALI

ARTISTI I PAKOHË...

Nga SUADA DACI





RROGËTARË TË SHTETIT E PLEQTË MILIONERË, SI PO DEGJENERON SKANDALI I PLEHRAVE

Nga NIKOLETA KOVAÇI

08



RIKTHIMI I ÇAMËRISË NE PARLAMENT

Nga REZARTA DELISULA

26



LORO BORIÇI NJË SHEKULL

NIPI NGA KANADAJA TREGON FUTBOLLISTIN, SPAHIA PËRGATIT SHKODRËN

Nga RETIN TOKA

70

36 TE "MAMA'S", RESTORANTI NË PRISHTINË QË U VURI "VIZËN" EVROPIANËVE

Nga REZARTA DELISULA

42 DOSJA E AMBASADAVE 1990 VRASJA E 17-VJEÇARIT DHE LINDJA E GERMANA-S NË AMBASADË

Nga AFRIM KRASNIQI

52 MODA NË SHQIPËRI/ NGA STILISTJA ITALIANE PARA LUFTËS, TEK VESHJET E DOKUT TË SOCIALIZMIT

Nga ERGYS ALUSHI

80 QUIZ BOMB

Nga KADRI VOKOPOLA

32 RAPORTI SEKRET/ BRITANIKËT: "18 MIJË ÇAM U DËBUAN, 800 U VRANË", SI U KRYE GENOCIDI GREK NË SHQIPËRI

Nga ERALED KAPRI

NEWS BOMB.al

KORRIK
2022



ABONOHU!

POSTA SHQIPTARE:

+355 68 50 80 753

Redaksia Newsbombal:

+355 69 67 32 020

abonime@newsbomb.al

ADRESA:

Rruga: "Emin Duraku",
Hyrja 1, Apartamenti 14, Tiranë

Mobile: +355 69 922 2201 | +355 69 922 2202

E-mail: info@newsbomb.al

Newsbomb SHPK
NIPT: L42417011Q



DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ANILA BASHA

BASHKËPUNUAN

ENKEL DEMI

AFRIM KRASNIQI

FATOS ÇOÇOLI

REZARTA DELISULA

ANTA MUÇAKU

LUELA MYFTARI

NIKOLETA KOVAÇI

ERALD KAPRI

ERGYS ALUSHI

RETIN TOKA

SUADA DACI

KADRI VOKOPOLA

GRAPHIC DESIGN

ALTIN ALIAJ

ÇËSHTJA ÇAME? IA KANË GJETUR ILAÇIN... HARRESËN

Të shkruash dhe rishkruash për Çështjen Çame ka gjasë të biesh në përsëritje, por mbi të gjitha në vesh të shurdhër.

Shqiptarët kanë një sëmundje kombëtare serioze, e cila është kujtesa e shkurtër. Harresa ka shënuar hapat e breshkës që ka bërë ky popull pellazgjik në udhën e tij të përparimit. Duket se në AND-në tonë është i shkruar ky ves, falë të cilit shqiptaria është rrudhur në shekuj sikur me qenë Lëkura e Shagrinut.

Të flasësh sot për Çështjen Çame duket sikur merr një shkëputje në kohë, e ngjashme me kërkimet arkeologjike. Në fakt, jemi duke përmendur genocidin e kryer ndaj shqiptarëve në zgrip të Luftës së Dytë Botërore. Në histori një periudhë e këtillë kohore konsiderohet një rrahje qepallash, por për ne duket sikur flitet për pre historinë.

Deri më sot, Çështja Çame nga pushtetet është munduar të mbahet në harresë (si bënë komunistët e Enver Hoxhës) ose në folklorizëm qaraman si kanë bërë demokratët e socialistët. Askush nuk e thotë që jemi duke folur për një krahinë, e cila është veç 5 për qind më e vogël se Kosova, pasuria ekonomike, gjeopolitike e saj është e pamatshme në vlerat tejet të mëdha.

Gjithsesi, duke shmangur me ndërgjegje patetizmin nacionalist duhet rënë dakord që Çështja Çame duhet parë politikisht dhe vetëm politikisht. Qeveritë shqiptare deri më sot (dhe me gjasë dhe në të ardhmen) mundohen ta lënë mjananë atë, madje nganjëherë mos ta përmendin aspak, thua se është ende një thëngjill i ndezur që të djeg duart. Në Shqipëri konsiderohet ende fitore nëse ministri i jashtëm në ndonjë takim me homologun grek e përmend nënëzë, pasi kryeministrat dhe Presidentët ulin sytë si virgjëresha. Kompleksi i inferioritetit që politika shqiptare majtas apo djathtas ka ndaj palës greke, ma merr mendja është fitorja më e shkëlqyer që kanë arritur fqinjët tanë ndaj pasuesëve të ilirëve.

Çështja Çame, në fakt duhet të jetë në krye

të agjendës shqiptare, në çdo takim duhet përmendur si pika e parë. Këtë nuk duhet ta bëjë vetëm diplomacia, por edhe ministri i ujrave, ai i ndërtimit apo i financave, kryetarët e bashkive e kështu me radhë, sepse kryeministri e presidenti as që bëhet fjalë. Duhet të marrim shembull fjala vjen nga fqinjët tanë grekë si sillen për Çështjen e Qipros turke. Historia atje është e ngjashme, por kësaj here viktimat janë vetë grekët.


Më e pakta, Çështja Çame duhet të kthehet në nivelet e vitit 1994, ku në tryezën e bisedimeve u pranua nga pala greke ekzistenca e saj dhe u ngrit një komision dy palësh për trajtimin e pronave dhe jo vetëm. Qeveritë perëndimore kudo që ndodhen kanë vijueshmëri, kanë kujtesë dhe nuk i lënë vendimet e tyre të myken nëpër arkiva me lagështirë. Në vitin 2022 mund ta nisim nga viti 1994. Edi Rama kryeministër, nëse do të kishte vullnet, për të cilin unë dyshoj fort, mund ta gjejë fillin e zgjidhjes së lëmshit tek kryeministri paraardhës Leka Mexsi. Ka gjasa ta bëjë një gjë të këtillë? Pak shpresë kam, madje edhe për atë që do të vijë pas tij apo ka qenë para tij.

Flitet gjerë e gjatë për Ligjin e Luftës, por pak e dinë se kemi të bëjmë me një paketë ligjesh, e cila

në thelb pengon të drejtën e pronësisë në një brez sigurie shumë të gjerë. Këtu nuk e pësojnë vetëm çamët, por shumë shqiptarë që kanë investuar në prona të patundshme e pasuri në atë krahinë. Ka shkodranë, korçarë, tiranas, të cilët ky ligj lufte i trajton sikur me qenë çamë. Grekët as kanë në plan ta anullojnë ligjin në fjalë, përndryshe do u jepnin mundësi shqiptarëve që të ankohen në gjykatat greke për kthimin e pronës, madje nëse ata i humbin të gjitha shkallët e drejtësisë fqinje u jepet e drejta e Gjykatës së Strasburgut. Kaq duhet dhe Çështja Çame shkon drejt zgjidhjes, sepse në fund të fundit politika është ekonomi. A do e bëjnë grekët një gafë të tillë? Kurrë! Po shqiptarët? Ata do të mjaftohen me ilaçin e harresës dhe ndonjë këngë a valle trimërie, kur luan Kombëtarja.



Nga ENKEL DEMI



RROGËTARË TË SHTETIT E PLEQTË MILIONERË, SI PO DEGJENERON SKANDALI I PLEHRAVE

Nga NIKOLETA KOVAÇI

Santiliano Çifliki ishte vetëm 27 vjeç kur u paraqit në një zyrë noterie në Berat në 2015-ën, për të rregjistruar një kompani ku ai vetë do të ishte pronar dhe administrator. Kompania AL-BER CO&CO do të zhvillonte aktivitetin e vet në qytetin e Beratit, në një gamë të gjerë fushash, nga ndërtimi tek transporti.

Në ekstraktin e QKB duket qartë firma e tij naëve vendosur mbi dokument. E shkruar me dorën e vet Santilianos, fiksohet emri dhe mbiemri i tij, e siç mund të konstatohet me sy të lirë, firma ka deridiku pamjen e një zhgarravine.

Vetëm 27 vjeç dhe themeloi kompaninë që, siç po rezulton sot nga dokumentet që dalin nën dritën e hetimit të çështjes së Inceneratorëve, lëvroi plot 5,5 milionë euro që shkonin tek firma e Klodian Zotos por edhe disa firmave të ndërtimit.

AL-BER CO&CO është një ndër 24 firmat e përfshira në skemën e kompanive të krijuara për evazion fiskal dhe përvetësim të paligjshëm të pasurisë.

Në korrik 2016, 9 muaj më vonë, regjistroi bilancin e parë pranë QKB-së, ku duket se kompania nuk ka asnjë aktivitet. Bilanci gjithë e gjithë

ka vetëm tre faqe. Por, edhe pse vula e njomë e kompanisë është e dukshme, firma e Santilianos, nuk është e njëjtë me firmën që ishte në aktin e themelimit të kompanisë dhe në statutin e saj.

Shkurt dhe saktë, Santiliano, nuk do tia kishte haberin fare se ç'bëhej me kompaninë që kishte krijuar. Nuk kishte faj: ishte vetëm 27 vjeç në qytetin e Beratit.

Siç tregojnë dokumentet, Santiliano si administrator i kompanisë nuk kishte shumë kohë për t'u marrë me transaksionet bankare. Në mars 2016, pra pesë muaj pas themelimit të kompanisë, i jep prokurë të posaçme një tjetër të riu, Xhon Lama, lindur në Tepelenë e datëlindja 1996. Xhoni vetë, ishte 20 vjeç. Nuk kishte kohë atë vit në Tepelenë të merrej me moshatarët e tij, apo edhe të dilte maleve për hashash. Do kujdesej për firmën AL-BER CO&CO për transaksionet financiare në të gjitha bankat e nivelit të dytë në vend.

Një vit më vonë nga themelimi, në nëntor 2016, edhe pse kompania nuk kishte asnjë aktivitet real në terren, bën ndryshime sërish në QKB duke shtuar fushën e veprimit të saj, përveç ndërtimit e transportit, tani do të bënte dhe shtrime e asfaltime rrugësh, prodhime elementesh betoni, tregtime të mallrave të ndryshme, eksporte mineralesh, eksport import veshjesh e pijesh, por edhe kancelari

24 kompani fiktive që kanë lëvruar afro 19 miliardë lekë kanë pasur pronarë një punonjës komunaleje të Tiranës, një vajzë police, e shumë pleq, njëra prej të cilave ka ndërruar jetë; një tjetër çoban lopësh në Greqi; një çift pensionistësh të pastrehë; një të moshuar azilante që e ka braktisur i biri, apo edhe një invalide që mbledh kanaçe në Tiranë. Skandali i Inceneratorëve po njih përmasa të papara ndonjëherë në Shqipëri. SPAK hesht, kryeministria hesht, bashkia hesht, policia hesht, media hesht... qytetarët protestojnë në rrjetet sociale

e mallra kozmetike, punime hidraulike elektrike, ndërtim banesash civile e industriale e deri tek hapja e një bar restoranti.

E meqë u shtua kaq shumë punë në objekt, firma hapi disa zyra të tjera dhe regjistroi në kapitalin e vet mbi 7 mjete të renda kamionë e fadroma për të filluar nga puna.

Gjithçka po shkonte mirë, por Santiliano nuk donte të ishte pronar i kompanisë sepse, pikërisht në 2017, dy vjet pas krijimit të firmës dhe kur në bilancin e saj kishin filluar lëvizjet e para të lekëve, ai, nuk mund të pranonte 300 mijë lekëshin e pagës si administrator, por donte më shumë. Që në nëntor 2016, Santiliano fillon punë si POLIC te drejtorja e Policisë me një pagë prej 480 mijë lekësh të vjetra, bruto.

Firma që kishte në pronësi, nuk mund të binte në duar të panjohura, ndaj në tetor 2017, Santiliano i shet 100 përqind kuotat e kapitalit të shoqërisë, motrës


së tij 25 vjeçare, më e vogël se ai, e datëlindjes 1992, Esmeralda Çifliku në një shumë prej 1 milionë lekësh të vjetra. Vëlla e motër, hedhin firmat tip zhgarravinë në kontratën e shitjes.

Meqë të dy ishin biznesmenë tashmë, ajo 25 vjeçe ai 29 vjeç, u shpërngulën nga Berati, dhe po jetonin të dy në Tiranë, në një banesë të thjeshtë te pallati 32 në rrugën "Muhamet Gjollësja".

Kur u bënë të dy biznesmenë, e Santiliano kishte filluar punë si polic, një operacion i policisë së Tiranës në janar 2019 e vë në pranga së bashku me 13 biznesmenë të tjerë, për evazion fiskal. Kishin ndër-tuar një skemë fiktive për të përfituar nga TVSH e dëmi sipas letrave të prokurorisë për buxhetin e shtetit ishte 18 milionë euro për gjithë firmat sëbashku. Përveç arrestimit të Santilianos, edhe e motra Esmeralda, si administratore e atë-kohshme, u vu nën hetim. Në fund të 2017, firma kishte një kapital prej afro 48 milionë lekësh të vjetra, sipas balanceve depozituar në QKB.

Por për Santilianon këto "shashka" hetimesh për evazion fiskal ishin "asgjë". Pasi, në momentin që i janë vënë prangat e doli për masë sigurie në gjykatë, ai edhe pse kishte ikur nga detyra e policit, kishte filluar punë tek Ujësjellës-Kanalizime në Tiranë nga korriku 2018 deri në mars 2019 me një pagë prej 570 mijë lekë të vjetra në muaj.

Ndikuar edhe nga hetimet e prokurorisë dhe arrestimi i tij për evazion fiskal, Santiliano kalon në Drejtorinë e Pastrim Gjellbërimit të bashkisë së Tiranës ku merrte 480 mijë





ESMERALDA ÇIFLIKU



SANTILIANO ÇIFLIKU

lekë të vjetra në muaj, punë që rezultojnë se e ka mbajtur deri në mars të vitit 2022. Është koha kur çështjes së inceneratorëve po i dilte flaka mbi sipërfaqe, dhe Santiliano, nuk gjen më vend të administratës bashkisë.

Ndërkohë fati i Esmeraldës ishte i njëjtë me të të vëllait. Ajo qëndroi dy vjet si administratore e Kompanisë që kishte themeluar vëllai i madh, deri në shkurt të 2019, një muaj pas hetimeve të prokurorisë për evazion fiskal kur vendosi të pezullojë aktivitetin e kompanisë.

Esmeralda 27 vjeçare nuk mund të ishte e papunë. Ajo dhe vëllai kishin krijuar një rrjet miqsh e shokësh që do të nxirrnin nga ky moment i vështirë. Si administratore në kompaninë e vet

kishte një rrogë minimale.

Ndaj, ajo filloi punë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, nga marsi 2021 me një pagë mujore 710 mijë lekë në muaj. Detyrë që e mbajti deri në prill 2022. Si edhe për vëllain, jemi në kohën kur hetimet ishin intensifikuar. Një punonjëse e policisë kishte aq njohje në prokurori sa të kuptonte ç'po ndodhte. Ose edhe vetë ndonjë zyrtar i devotshëm në prokurorinë speciale, ka lajmëruar drejtuesit e lartë të policisë për punonjësen e tyre që ishte përfshirë tek skema e vjedhjes nga inceneratorët dhe mund të kenë vendosur ta heqin nga policia.

Santiliano dhe Esmeralda janë motër e vëlla. Ata me firmën AL-BER CO&CO që e regjistruan në emër të tyre dhe me firmat e tyre kanë lëshuar fatura fiktive prej 553,514,718 lekë ose afro 5.5 milionë dollarë.

Nga këto fatura fiktive, vetëm për Integrated Technology Services me pronar Klodian Zoton, janë lëvruar 109,994,000 lekë. Me gjithë kompanitë e tjera, që janë kryesisht firma ndërtimi, motër e vëlla kanë autorizuar lëvizjen e 553,514,718 lekë ose 5.5 milionë dollarë.


Të dy të rinjtë nga Berati, shpërngulur në Tiranë në rrugën "Muhamet Gjollës" nën moshën 30 vjeç kanë qenë punonjës të shtetit: Santiliano punonte në punëra të rëndomta në Bashkinë e Tiranës (ujësjellës dhe komunale); ndërsa Esmeralda, e motra, në detyrë të rëndësishme në policinë e shtetit.

SANTILIANO MITAT ÇIFLIKU ME NID: I80403080H

1. Për muajin: Nëntor 2012 i punësuar tek : AMA-DRESS me NIPT : L13407001E me pagë 0 Lekë.
2. Për periudhën: Janar 2013 – Dhjetor 2013 i punësuar tek : QEND. FURNIZIMIT MATERIAL TEKNIKE me NIPT: K31617017U me pagë: 0 – 32676 Lekë të reja bruto.
3. Për periudhën: Nëntor 2015 – Nëntor 2017 i punësuar tek: AL-BER CO&CO me NIPT: L53516002S me pagë: 15000 – 30000 Lekë të reja bruto.
4. Për periudhën: Nëntor 2016 – Shkurt 2018 i punësuar tek: DREJTORIA E POLICISE me NIPT: J81620005Q me pagë: 26,800– 48,071 Lekë të reja bruto.
5. Për periudhën: Korrik 2018 – Mars 2019 i punësuar tek: UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË me NIPT: L72320033P me pagë: 33,592– 56,945 Lekë të reja bruto.
6. Për periudhën: Maj 2019 – Mars 2022 i punësuar tek: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT, GJELBËRIMIT me NIPT: K51725020Q me pagë: 21,149– 40,345 Lekë të reja bruto.
7. Për muajin: Gusht 2021 i punësuar tek: ALBA - TRANS me NIPT: K31931031T me pagë 5769 Lekë të reja bruto.

ESMERALDA MITAT ÇIFLIKU ME NID: J25414064Q

1. Për periudhën: Nëntor 2017 – Shkurt 2019 e punësuar tek subjekti: AL-BER CO&CO me NIPT: L53516002S me pagë nga 15,000 – 24,000 Lekë të reja bruto.
2. Për periudhën: Mars 2021 – Prill 2022 e punësuar tek: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISE me NIPT: K12217003P me pagë nga 3,828 – 71,640 Lekë të reja bruto.





COLLINA VERDE

PROJEKTUAR PËR ËNDRRËN TUAJ!

Tipologjitë e shumëllojshme ju japin mundësinë
të plotësoni dëshirat dhe nevojat tuaja.

+355 69 801 4999 | sales@balfinrealestate.al | www.balfinrealestate.al

PLEQTË MILIONERË TË INCENERATORËVE, SKANDALI S'PO NJEH TË MBARUAR

Haxhire Gurakuqi, është 89 vjeçe! Nëna e një djali, për të cilin është ankuar edhe publikisht që e ka braktisur, e ka lënë të vetme prej 20 vitesh. Nga një shtëpi me qira, gruaja e moshuar përfundoi në azilin e pleqve, në Laprakë. Aty u strehua dhe vazhdon të jetë, ndërsa i doli emri si person që posedonte një pasuri prej 5 milionë eurosh por që ajo nuk i justifikonte dot. Për pasojë banka i kishte bllokuar edhe një shumë prej 60 mijë lekësh të kursimeve të saj dhe nuk ia lëshonte, por ajo nuk e dinte se për çfarë arsyeje i kishin bllokuar paratë. Gruaja, rrëfeu për mediat se një ditë i kishin shkruar në azil dy djem të ri dhe iu kishin prezantuar si prokurorë. I kishin kërkuar firmën dhe dokumentet e identifikimit dhe i kishin premtuar se do të hetonin se përse i ishte bllokuar shuma modeste e parave dhe se ata do t'ia zhblokonin. Por, duke hyrë në skemën se si është përfshirë emri i 89-vjeçares në aferën galopante të incineratorëve, lehtësisht kuptohet edhe përfshirja e gjithë bashkëmoshatarëve të saj, bashkë me një zonjë që nuk jeton më!

'LIDHJET' E HAXHIRESE ME 3 KOMPANI

Në QKB, Haxhire Gurakuqi e datëlindjes 1933, rezulton pronare në dy kompani, me aktivitet në fushën e ndërtimit dhe pajisjeve industriale: "Sopotonia" shpk dhe "Koleci 2003" shpk. Më herët ajo ka qenë pronare në "Lumi -06", kompani, që sipas dokumenteve ka përfituar rreth 5 milionë euro nga skema e incineratorëve. Shkresat tregojnë se emri i Haxhire Gurakuqit shoqërohet gjithnjë me të njëjtat emra të tjerë në skemë; anëtarë të familjes Murati, Thanas Çanit dhe Kreshnik Ymerajt.

SKEMA E KOMPANIVE TË
KRIJUARA PËR EVAZION
FISKAL DHE PËRVETËSIM TË
PALIGJSHËM TË TVSH-së



KOMPANIA "SOPOTONIA"

Kjo kompani private u regjistrua në vitin 2014. Fillimisht me emrin "XH-Y", në pronësi të Kreshnik Ymerajt. Në vitin 2017, kompania u ble nga Klevis Murati. Një vit më pas, në mars 2018, ndryshon sërish pronësi. Tashmë, në vendin e parë të kompanisë vendoset Thanas Çani. Në gusht 2018, Thanas Çani i shet kompaninë sërish Klevis Muratit. Në shkurt 2019, Klevis Murati ia shet kompaninë, e cila tashmë quhej "Sopotonia" Haxhire Gurakuqit. Një muaj më pas, pra në mars 2019, kompania kalon në status pasiv, gjendje në të cilën vijon ende.

"KOLECI 2003" SHPK

Kompania u regjistrua në korrik të vitit 2008 nga Agim Xhuli, atëkohë ishte 85 vjeç. Dy vjet më pas, në maj 2010, pronësia e kompanisë i kalon të birit të tij, Artur Xhuli. Në mars 2019, kompania kalon në status "pasiv". Një muaj më vonë, Artur Xhuli i shet aksionet e kompanisë tek e moshuara Haxhire Gurakuqi.

"LUMI -06" SHPK

Kompania "Lumi 06" është ajo që, sipas dokumenteve të publikuara, ka siguruar miliona euro fitime për 89-vjeçaren Haxhire Gurakuqi dhe i ka sjellë edhe bllokimin e 60 mijë lekë të kursimeve të jetës. U regjistrua në vitin 2016, në pronësi të Lumturije Muratit (nëna e Klevis Muratit që u shfaq te kompania "Sopotonia"). Në dhjetor 2017, zonja Murati ia shet kompaninë Haxhire Gurakuqit. Një vit më pas, e moshuara Gurakuqi ia shet sërish kompaninë Lumturije Muratit. Në korrik 2019, pronar i "Lumi -06" bëhet Thanas Çani.

* * *

THANAS ÇANI, sot është 83 vjeç! Është nga fshati Kudhës i Vlorës dhe aktualisht banon në lagjen e 'Brakës' në Tiranë në një apartament 2+1! Emri i tij

AM CO & CO (NPT L52100016) 1,953,462,062 Lekë ARBEN PËLLALA, MERIA PËLLALA	SG LOGISTIC (NPT L5020014) 714,359,045 Lekë RESAN BËRDAN
PM & A COMPANY (NPT L52100016) 1,785,508,533 Lekë ARBEN PËLLALA	LUMI 06 (NPT L52320018) 668,899,554 Lekë LUMTURIJË MURATI
ELVIS 03 GROUP (NPT L4000014) 1,717,116,694 Lekë DËSHAMIR YMERAJ, bashkëpronar i Vjollës (Frangaj) Tiranë	AA-117 (NPT L17400014) 590,166,504 Lekë DRITA FRANGAJ, bashkëpronar i Vjollës (Frangaj) Tiranë
ELVIS COO (NPT L71000010) 1,695,792,212 Lekë DËSHAMIR YMERAJ, bashkëpronar i Vjollës (Frangaj) Tiranë BULEJDI ZIGO	ELVIS - 03 (NPT K500113019) 573,929,105 Lekë DËSHAMIR YMERAJ, bashkëpronar i Vjollës (Frangaj) Tiranë
KOLECI 2003 (NPT K00125340) 1,458,052,563 Lekë ARTUR XHULI	AL - BER CO&CO (NPT L50140001) 553,514,718 Lekë SANKTJANO CIFLIKU, BERNARDELLA CIFLIKU Pajisjes le Polices, Receptores se Gufierimit, Tirane
ALFA POWER GROUP (NPT L4000014) 1,321,816,723 Lekë ARDIT HAXHINI, UJENI HAXHINI	GLE - VAN (NPT L74020010) 529,094,993 Lekë OLEDIR VANOJELL, pajisjes le Polices pajisjes le Polices
MVR (NPT L41000014) 1,143,978,488 Lekë BULEJDI ZIGO, KRESHNIEK YMERAJ, djali i Dëshamir Ymeraj	LELI17 (NPT L74140010) 490,876,227 Lekë RIVEN SHËRBI
SOPOTONIA (NPT L40020014) 1,058,746,361 Lekë KLEVIS (MURATI) MURATI, djali i Lumturije Murati KRESHNIEK YMERAJ, djali i Dëshamir Ymeraj	R.S.J & T GROUP (NPT L52140010) 488,213,946 Lekë LIRIN JELLA, ROBERT SHABANI

TOTALI I EVAZIONIT: 18,981,886,772 LEKË

gjendet në dy kompani si ndërveprues me 'bosen' tjetër të firmave fiktive të incineratorëve, Haxhire Gurakuqi. Emri i tij ka hyrë në QKB në marsin e vitit 2018 kur Klevis Muarataj i shet kompaninë "Sopotonia", kompani që mbeti në emrin e Çanit vetëm për 5 muaj, pasi në gusht, Klevisi ia rimerr kompaninë. Çani rikthehet sërish në QKB në korrikun e vitit 2019 kur ai bëhet pronar i kompanisë "Lumi-06", kompani e shitur nga nëna e Klevis Muarataj. I moshuari nga Vlora nuk u prononcua, ndoshta për shkak të lidhjeve familjare që ai ka me një prej eksponentëve më në emër të partisë në pushtet sot, por në emër të tij është prononcuar i biri, i cili ka mohuar jo vetëm praninë e të atit në ato afera, por edhe dijeninë për përfshirjen e emrit të tij si pronar kompanish.

* * *

GJYSTE SERRMI, sot duhej të ishte 82 vjeçe, por ajo mësohet se ndërroi jetë 5 vite më parë, në 17 korrik 2017, në kohën kur kishte nisur edhe lulëzimi i kompanive fiktive. Gruaja e moshuar, e cila thuhet se ka vdekur në varfëri ekstreme, u përfshi një vit para vdekjes dhe disa muaj pas vdekjes në veprime në QKB dhe në Tatime. Ajo rezultoi të ishte pronare e kompanisë 'Elvis 03', kompani që gjeneroi fatura rreth 5.5 milion euro. Emri i saj doli në të paktën 5 episode ku ka vepruar pas vdekjes duke firmosur dokumente të kompanisë që kishte rezultuar 'pronare'. Në janarin e vitit 2017, Dashamir Ymeri ia shet kompaninë Gjyste Serrmit. Por në momentin që kishte kryer këtë shitje rezultoi që Dashamir Ymeri kishte lënë pa plotësuar dokumentet e shitjeve të vitit 2015, që shkonin në rreth 3 milionë euro. Më 7 korrik, pra 10 ditë përpara që Gjystja të ndërronte jetë, ndodh falsifikimi i parë, kohë kur Vjollca Ymeri paraqitet pranë QKB me një dokument të firmosur nga Serrmi dhe kërkon që kompania të bëhet aktive. Më 27 korrik pranë tatimeve dhe QKB

shkon Dashamir Ymeri, e me një tjetër autorizim të firmosur nga e ndjera, kërkon ndryshimin e emrit të kompanisë nga 'Elvis 03' në 'Elvis 03 SHPK'. Dhe vetëm një ditë më pas, pra më 28 korrik dorëzon pasqyrat financiare të prapambeturra të vitit 2015, kohë kur ishte kryer transaksioni në afro 3 milionë euro. Për vonesën, kompania e drejtuar nga e ndjera Gjyste Serrmi gjohet në shumën 15 mijë lekë. Po nuk ndalet këtu përdorimi i emrit të

së ndjerës. Në shtator të po atij viti në emrin e Merita Hajdarit paraqitet një dokument me firmën e Serrmit, e cila kërkon që kompania të pezullohet në QKB, veprim që u krye pa asnjë hezitim ndërkohë që më vonë ndaj së ndjera 'përfundoi' edhe në Gjykatë.

MERITA HAJDARI, të martën e 12 korrikut, mbërriti rreth mesditës në dyert e SPAK-ut. I kishte dalë emri në shitblerjen e kompanisë 'Elvis 03'. Gruaja që kishte brendhur komisariatet e Tiranës përfundoi në dyert e Prokurorisë së Posaçme për të mësuar se kush ia kishte përfshirë emrin në 'punët e pista'. Ajo tregoi se kishte jetuar prej shumë kohësh duke mbledhur kanoçe, ishte e pastrehë dhe e papunë, pasi ishte invalide dhe nuk e merrte kush në punë. Merita, në moshë 60 vjeçare u përfshi në skemën e kompanive fiktive pikërisht në lidhje me kompaninë me të cilën ka vepruar dhe ndërvepruar e ndjera Gjyste Serrmi. Nga të dhënat e dala nga dokumentet e kompanive mësohet se emri i Merita Hajdarit, bashkë me Kartën e Identitetit dhe nr. e ID-së, rezultoi të jetë përdorur në vitin 2017, ku është autorizuar nga Gjyste Serrmi, pronare e vetme e kompanisë "Elvis 03" për të bërë veprimet në QKB për pezullimin e aktivitetit ekonomik të kësaj kompanie. Bashkë me emrin e saj, Gjyste Serrmi (e vdekur) ka shtuar edhe nr. e ID-së së Merita Hajdarit, e cila më pas rezultoi të ketë bërë veprimet në QKB.

* * *

VEZIR BRAHAJ, është një i moshuar 71 vjeç me origjinë nga Fieri. Jeton në Greqi prej vitesh dhe është çoban. Por në fakt, Brahaj deklaroihej i punësuar në Tatime nga kompania "Elvis 03" gjatë periudhës dhjetor 2019 – dhjetor 2021 dhe nga muaji shtator 2021 deri në prill 2022 i punësuar në kompaninë 'Elvis CO'. Vetë Veziri që njehe vetëm stanet e lopët thotë se në këtë periudhë ka qenë në Greqi, madje i sëmurë e për shumë kohë i shtruar në spital. Në dokumente, rezultoi të jetë administrator i kompanisë Elvis CO që e kishte blerë nga Ruzhdi Meta. Nga viti 2019 e deri në momentin kur plasi skandali i firmave fiktive, Vezir Brahaj rezultoi të drejtojë 'Elvis 03' dhe kryen vetë të gjitha veprimet me institucionet shtetërore për 'kompaninë e tij' që kapin shifrën e 30 milionë eurove, ndërkohë që ai vijonte të ishte i punësuar si çoban lopësh në Greqi!

* * *

RUZHDIJE DHE SHKËLQIM META, janë burrë e grua, të së njëjtës moshë; 67 vjeç secili. Shkëlqimi është nga Tirana, ndërsa Ruzhdi, nga Kavaja. Emrat e tyre dolën si shitës aksionesh dhe blerës të dy kompanive me vlerën prej 30 milionë eurove, që më pas ia shitën Vezirit, çobanit që punonte në Greqi. Gruaja në një dalje publike tregoi se ishin të pastrehë dhe se i kishte strehuar momentalisht në banesën e tij, vëllai i saj. Nga ekstraktet që u siguruan më herët nga QKB, rezultoi se Ruzhdi dhe Shkëlqim Meta kanë blerë dhe më pas shitur aksione të kompanive "ELVIS-03 GROUP" dhe "ELVIS CO". Shitjet sipas dokumenteve rezultojnë të kenë ndodhur në vitin 2020. Kompanitë janë regjistruar me adresë në Lezhë, Laç e Mamurras, teksa lanë vazhduar të jenë aktive deri në fillimin e muajit korrik të këtij viti.

	PELLUMBI 2015 PPT LSH 00043 435,968,494 Lekë PELLUMBI HAQANI, ARIAN HAQANI
	BEST SERVICES PPT LSH 00043 421,316,958 Lekë EDMOND SHESHI
	FRANGAJ - INTERNATIONAL PPT LSH 00043 370,965,19 Lekë VJOLLEA (FRANGAJ) YMERI
	"R. B. - GENERAL SERVIS PPT LSH 00043 251,591,376 Lekë RESAN NERDANI
	FROGGY PPT LSH 00043 240,088,655 Lekë ENIS XHAFERRI, RESAN NERDANI
	FROGY 03 PPT LSH 00043 239,925,416 Lekë VLADIMIR SHESHI
	EL ZA PPT LSH 00043 200,966,530 Lekë ENIS XHAFERRI
	PUPA SERVICE PPT LSH 00043 177,536,404 Lekë SHABAN PUPA

BAJRAM BEGAJ

SI E SHOHIN EKSPERTËT DHE MIQTË PRESIDENTIN E RI

| Nga ANTA MUÇAKU

Më 25 korrik në karrigen e Presidentit do të ulet Bajram Begaj. 55 vjeçari nga Rrogozhina, është i pari mjek në historinë e Forcave të Armatosura që u bë gjeneral major.

Këtë gradë madhore ia dha pikërisht Ilir Meta në korrik të vitit 2020-ës dhe atëhere, kreut të shtetit as që i shkonte në mendje se 2 vjet më vonë, gjeneral majori do e pasonte në detyrë.

Mazhoranca u përpoq të tregonte se emri i Presidentit të ri do të dilte nga konsultimet me opozitën, shoqërinë civile apo propozimet në zarf të deputetëve socialistë, por në fund... u duk se emri i Bajram Begajt ishte në “zarfin sekret” të Ramës.

“Do ta telefonoj dhe do të kem një takim sonte me të, nëse është në qytet”, tha Rama pas mbledhjes së Kryesisë para gazetarëve që për javë të tëra kishin vrapuar pas emrave që u kishin dhënë njerëzit pranë tij; nga Majlinda Bregu, te Ardian Dvorani.

Bajram Begaj jo vetëm që ishte në qytet, por brenda një ore, i veshur me kostum, u shfaq në Kryeministri, tërësisht i gatshëm për detyrën e re përballë Kryeministrit që i pohonte se ai ishte kandidatura e duhur për ta ricivilizuar zyrën e Presidentit të Republikës.

Aty për aty, Begaj iu zotua Ramës se do të ishte në lartësinë e detyrës.

3 QERSHOR, TAKIMI RAMA-BEGAJ NË KRYEMINISTRI

“Rama: Ju falenderoj që ju nuk shfaqët refuzim, por pranim. Do të jetë nder për ne që t’ju japim votën dhe të zgjidheni zyrtarisht President i Republikës.

Begaj: Faleminderit kryeministër, është vlerësim shumë i madh të jesh president i një vendi. Do të parpiqem të jem gjithmonë personi i duhur për atë që përfaqëson ky post. Do të jem në lartësinë e detyrës, i përgjegjshëm në kryerjen e saj. Vij nga ushtria dhe mjekësia. Janë të dyja profesione shumë të mira, shumë të përkushtuara. Nëse do të votohem do jem i lumtur ta kryej detyrën me dinjitet.

Rama: Ne kemi bindjen se ju do të jeni në lartësinë e kësaj detyre. Me thënë të drejtën, të gjithë ata që morën fjalën, folën me respekt dhe bindje që ju do të bëni më të mirën në atë detyrë. Uroj që të jeni deri në fund besnik ndaj shtetit.

Begaj: Zoti Kryeministër, për ushtarakun, nderi, detyra dhe Atdheu janë motoja e punës ndaj besoj se do e përmbush me sukses dhe do jem 24/7 në shërbim të kësaj motoje!”

Mjeku dhe Ushtaraku vështirë të ndahen nga kostumi i Presidentit të ardhshëm. Miqtë japin vlerësime maksimale për anën humanitare të tij. A ishte stërvitja “Defender 21” që e çoi në zyrën e Presidentit? Ekspertët e komunikimit, tregojnë anën tjetër të kreut të ri të shtetit



PREMIUM
QAFSHTAMA
UJI I SHËNDETIT



ZERO
NITRATE

I PASUR ME
MAGNEZ

**Furnizimi me ujë
shoqërohet me
pajisjen dhe
mirëmbajtjen e saj.**

Kontakt

+355697009900

www.qafshtama.com

I vetmi ujë i mbushur në lartësinë 1350m



- Ujë i nxehtë
- Ujë ambienti
- Ujë i ftohtë



Sistemi ftohës
gaz R134a



Frigorifer
i poshtëm
16L



Dalje direkte
e ujit



I përshtatshëm për
11 dhe 19L

KY DIALOG I SHKURTËR MES TYRE, U KOMENTUA GJATË...

Për ekspertin e Komunikimit Edlira Gjoni, në këtë bisedë me kryeministrin, presidenti i ardhshëm e shfaq veten të pozicionuar në rolin e një fitimtarit të zënë në befasi, të papërgatitur, që mundohet të sigurojë atë që e zgjodhi se do bëjë çmos të legjitimojë zgjedhjen e tij.

Në analizën e këtij komunikimi të shkurtër për revistën Newsbomb, Gjoni konstaton se presidenti i ardhshëm ka përdorur 17 herë variacione të fjalës “nuk do të të zhgënjej”, në format e vlerësimit, surprizës, shpjegimit të detyrës, lartësisë e lumturisë që ndjen, së bashku me detyrimin për ta justifikuar atë.

Për ekspertin e komunikimit, ka ngushti leksikore, lënë në hije nga detyrimi gjuhësor për të shprehur mirënjohjen. Kurse theksimi i profesioneve në fjalinë e dytë, tregon disiplinën e përvetësuar për të nxjerrë sidoqoftë në pah edhe ndjenjën parësore të një ushtaraku: shërbimin.

Megjithatë, thotë ekspertja, gjuha e presidentit të ardhshëm në këto pak përgjigje, mund të dekodohet lehtë si një zgjedhje e thjeshtë për t'i qëndruar besnik zonës së sigurisë në tekst e mendim, me përforsime të panevojshme shtjelluese e nënrenditëse që zgjasin dëshirën e tij për të bindur bashkëbiseduesin se ka nevojë të fitojë besimin e tij. “Gjuhë e kujdesshme dhe diplomatike, pa vend për retorika politike”, konstaton Gjoni.

Gjuha e trupit është një tjetër element që mori vëmendje në takimi mes Ramës dhe Begajt.

Pedagogu i komunikimit Erlis Çela thotë se Presidenti i ri i vendit, ka një paraqitje të rezervuar publike, për rrjedhojë është vështirë të analizosh prezencën e tij përballë kamerave dhe publikut. Megjithatë në dy daljet e tij të para, ai identifikon disa elemente të gjuhës joverbale.

Në takimin e tij të parë, presidenti i zgjedhur shtrëngon duar me kryeministrin e vendit.

Nga pamja duket dukshëm se kryeministri Rama qëllimisht, shkel hapësirën personale të presidentit duke u afruar në një distancë të afërt. Duke iu referuar teorisë së shkeljeve të pritshmërive të autores Judee Burgoon, pedagogu Çela konstaton se kjo sjellje në komunikimin ndërpersonal shkakton një tërheqje të presidentit duke e vënë atë në një pozicion jo komfort. Më pas qëndrimi i tij me duar të bashkuara përmbi gju, me pozicionin e trupit të përkulur disi para, përballë kryeministrit, i cili pasi ka fituar “betejën e parë” në komunikimin jo verbal, është vendosur qartazi në një pozicion tepër të rehatshëm, i mbështetur në kolltuk



Për pedagogun e komunikimit, shtërngimi i të dyja duarve kryeministrit është një shenjë “mirënjohjeje” e ekzagjeruar nga ana e presidentit të zgjedhur. Nga ky moment sërish kemi mesazh të nënkuptuar që tregon për nevojën që ndjen presidenti për të shlyer “nderin” e bërë nga kryeministri. Ai dukshëm do të tregojë se ka detyrim mirënjohjen personale ndaj kryeministrit

dhe me trupin e çtendosur, krijon përshtypjen se presidenti është në një pozicion inferioriteti që sipas pedagogut, përcjell mesazhin se ai ndihet i detyruar për “nderin” që i ka bërë kryeministri.

Momenti i dytë që ra gjithashtu në sy është shtërngimi i duarve pas votimit në Kuvend. Presidenti i sapozgjedhur u zgjat nga llozha për t'i dhënë dorën Kryeministrit.

Për pedagogun e komunikimit, shtërngimi i të dyja duarve kryeministrit është një shenjë “mirënjohjeje” e ekzagjeruar nga ana e presidentit të zgjedhur. Nga ky moment sërish kemi mesazh të nënkuptuar që tregon për nevojën që ndjen presidenti për të shlyer “nderin” e bërë nga kryeministri. Ai dukshëm do të tregojë se ka detyrim mirënjohjen personale ndaj kryeministrit.

PRESIDENCA E RE E BEGAJT

Por zbatimi i protokollit për Bajram Begajn fillon tani, me betimin në Kuvend. Gjasat janë që Presidentin e ri ta shohim rrallë në media. Të paktën jo për të kundërshtuar e për të akuzuar qeverinë që me një ligj apo me një tjetër, po shkel Kushtetutën.

Presidenti do flasë me dekrete. Kush e njuh dhe e ka parë të veprorë në pozicione të tjera drejtuese, si në mjekësi,





ashtu dhe në ushtri, thotë se para se të arrijë te beteja, Bajram Begaj tenton të negociojë.

Që do të thotë, se ka më shumë gjasa që të shkojë të flasë me Ramën për ta bindur që të tërhiqet nga një ligj sesa ta kthejë mbrapsht atë e të krijojë një konflikt.

Për disa, kjo tregon se Presidenti i ri do të jetë nën “ombrellën” e kryeministrit, por për të tjerë, ky do të jetë normaliteti i munguar.

Begaj nuk është mësuar të mos i respektojë institucionet. Metën, deri dje e ka pasur Komandant të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Nga ana tjetër, Meta e ka dekretuar njëherë si gjeneral e pastaj si Shef i Shtabit të Forcave të Armatosura ndaj për shumikënd nuk kishte asnjë surprizë në faktin që ai firmosi nga Stambolli edhe dekretin e shkarkimit dhe i hapi rrugën për t’u zgjedhur President.

KUSH ËSHTË BAJRAM BEGAJ

Bajram Begaj ka një karrierë 31 vjecare të ndërthtur mes mjekësisë dhe ushtrisë. Ai rrjedh nga një familje e zakonshme shqiptare, dy prindër që i kanë mesuar t’ia dalë vetë në jetë pasi as njëri dhe as tjetri nuk e ka pasur rrugën e shtruar. Është i martuar me zonjën Armanda Begaj dhe janë prindër të dy djemve, të dy mjekë të rinj që shkollimin nuk e kanë bërë në Shqipëri, por në Gjermani.

Ai ka përfunduar doktoraturën në Mjekësi dhe ka mbajtur një sërë postesh me rëndësi. Ka shërbyer si Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, Shef i Njësisë Mjekësore Ushtarake, Drejtor i Spitalit Usharak, Drejtor i Inspektoratit Shëndetësor, dhe së fundmi, Shef i Shtabit të Forcave të Armatosura Shqiptare.

POR SI RINË USHTARAKU DHE MJEKU TE BAJRAM BEGAJ?

Në pamje të parë duket sikur ushtaraku është në krahun tjetër të anës humane, por miqtë e tij thonë se ajo që e veçon Bajramin është pikërisht humanizmi.

Drini Nikolli, ish-ushtarak, e ka njohur doktorin në një rast specifik. Atëkohë, Bajrami ishte drejtor i Spitalit Usharak dhe Drini shkoi t’i kërkojë ndihmë për një ushtar të ri, të sëmurë rëndë.

“Çfarë më bëri përshtypje ishte ndjeshmëria e tij njerëzore, njëjtë siç duhet ta ketë një mjek që ka bërë betimin e Hipokratit. Rasti i ushtarit ishte vërtet delikat dhe në Shqipëri nuk na jepnin shpresa për jetën. Turqia dhe Greqia atë vit jepnin për 30-40 individë

shërbime falas. Por nuk ishte aspak e lehtë sepse ato shërbime ruheshin për ushtarakë të gradave të larta, dhe pse jo, politikanë. Ushitari në fjalë nuk i kishte ato grada, por kjo nuk e pengoi Doktor Bajramin të bënte të pamundurën”, thotë Drini.

Ai kujton se Bajrami e vizitoi vetë atë ditë ushtarin dhe i premtoi se do e çonte për ndërhyrje jashtë.

Sot e kësaj dite, ushtari falenderon Drinin që është në jetë, ndërsa Drini falenderon doktor Bajramin për ndihmën që i dha një të riu pa grada e pa para.

Edhe doktor Hekuran Braho, një nga miqtë më të mirë të Bajramit, humanizmin ia dallon mbi gjithçka. Normat, rregullat dhe ligjet janë shtyllat mbi të cilat është mësuar të jetojë përditshmërinë e tij Presidenti i ri.

“Ka çarë vetë në jetë, pa asnjë lloj përkrahje. Me korrektësi dhe urtësi ka përballuar çdo situatë. Rruga e tij e vetme është ligji”, thotë me gojën plot dhe me krenari Hekurani për mikun e tij. Ai pohon se jo vetëm do mësohemi me natyrën e qetë dhe institucionale të Begajt, por do duam ta shohim gjatë në Presidencë.

“DEFENDER 21”, STËRVITJA

QË E BËRI BAJRAM BEGAJN PRESIDENT?

Figura e Bajram Begajt spokati veçanërisht në stërvitjen më të madhe ushtarake të 30 viteve të fundit që u organizua në vendin tonë, “Defender 21”.

Si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, ai ishte njeriu përgjegjës që mirëpriti 1 mijë trupa për realizimin e stërvitjes në tokë, ajër dhe det.

Bajram Begaj u kujdes për çdo detaj, organizimin, logistikën, ecurinë, raportimin sa te ministri e sa te Kryeministri që donte të sigurohej se gjithçka po shkonte siç duhej.

Për suksesin e “Defender 21” ai mori vlerësime të mëdha edhe nga gjeneralë të lartë amerikanë.

Pak ditë para se të zgjidhej President, Begaj sapo ishte kthyer nga një takim në Pentagon me Shefin e Shefave të Shtabit të Bashkuar të Ushtrisë amerikane, Mark Milley. Nga ky takim, ai erdhi bashkë me lajmin se Shtetet e Bashkuara i kishin dhënë ushtrisë shqiptare 17 milionë dollarë. Vlerësimi i amerikanëve por dhe i vetë ambasadores Yuri Kim u duk edhe menjëherë pas votimit të Begajt në Parlament.

“Si Shef i Shtabit të Përgjithshëm, ai kontribuoi në mënyrë domethënëse në bashkëpunimin midis SHBA dhe Shqipërisë në fushën e mbrojtjes. Ne presim me kënaqësi që të vazhdojmë të punojmë me të në detyrën e tij të re dhe të forcojmë më tej partneritetin midis vendeve tona”, shkruante ambasada amerikane.

Pas kësaj, ishte e qartë se në 78 vota pro për Bajram Begajn, 4 kundër dhe 1 abstenim, kishte edhe një “VOTË PRO” amerikane.

Gjeneral Begaj u zgjodh President i Shqipërisë në një moment kur NATO dhe siguria janë kryefjalë. Madje, kryeministri Rama i ka propozuar Aleancës Euroatlantike të ketë një bazë të saj detare në Porto Romano.

Vështirë të thuhet sesa kohë mund të dojë realizimi i këtij projekti, por deri atëherë, një gjë është e sigurtë: marrëdhënia institucionale Kryeministri-Presidencë do të rrjedhë në ujëra të qeta.

Bajram Begaj ka një karrierë 31 vjecare të ndërthtur mes mjekësisë dhe ushtrisë. Ai rrjedh nga një familje e zakonshme shqiptare, dy prindër që i kanë mesuar t’ia dalë vetë në jetë pasi as njëri dhe as tjetri nuk e ka pasur rrugën e shtruar.

RINGJALLJA E DOKTORIT

NJË PROTESTË KORRIKU QË LAJMËRON VJESHTËN E NXEHTË POLITIKE

| Nga NEWSBOMB.AL

Protestat e opozitës në Bulevard janë shoqëruar gjithnjë me debatin mbi numrin e pjesëmarrësve. E enjtja e 7 korrikut nuk i shpëtoi këtij debati. Megjithatë, pati një konsensus nga të gjithë anët, se shumë njerëz zunë vend në tubimin e thirrur nga Sali Berisha, atë mbrëmje ku temperaturat ishin rreth 35 gradë.

Një manifest-
siç e cilësoi kreu
ka si synim final
Ramës. Të tjera
vijm, por ndoshta
torit, duke
se fundi i
ti e zbe-
dukee

tim inagurues, që
i demokratëve,
rrëzimin e Edi
do të ketë në
jo përpara shta-
marrë parasysh
korrikut dhe gush-
hin nervin politik
çuar në pikën zero.

7 korriku solli rik-
thimin e Sali Berishës
në Bulevard, në rrugë,

aty ku ai ka një përvojë të çmuar. Nga ana tjetër, ishte noterizim zyrtar tanimë se Opozita drejtohet prej tij, dhe se ai është aktori i dytë politik në vend, pas Kryeministrit.

Edhe më skeptikët e pranuan se populli opozitar ju përgjigj Berishës dhe njerëzit u rreshtuan në shumicë prej Kryeministrit së përgjatë pjesës veriore të Bulevardit, deri pranë sheshit Skenderbej.

Organizatorët u kujdesën që në krye, që ky akt revolte ndaj qeverisë të kishte fytyrë sociale dhe ekonomike, por sigurisht se kur në drejtim është opozita, marshimi merr në fund tiparin mirëfilli politik, dhe për këtë nuk la asnjë moment dileme vetë lideri i demokratëve, me mesazhin që përcolli.

PLURALIZËM MESAZHESH

Gjatë drejtimit të PD nga Lulzim Basha askush nuk mund të thotë se protestat kanë

Pjesmarrja masive në thirrjen që Sali Berisha u bëri mbështetësve dhe qytetarëve për manifestimin e 7 korrikut, duket se ka sjell një rend të ri politik në vend. Tanimë, lojtari i dytë në Shqipëri, është Sali Berisha, i cili kur zbret në rrugë bëhet i paneglizhueshëm. Çfarë nuk u pa në protestën e parë të doktorit të rikthyer, dhe cilat janë arritjet. Një raport i detajuar nga revista Newsbomb.al...

munguar, apo se kanë qenë të vogla. Problemi është se me to, nuk është arritur ndonjë objektiv politik domethënës, përveç rastit të çadrës.

Protestat e Bashës kanë patur po ashtu një veçori. Kishte një përkujdesje gati tiranike për mesazhin. Duhej të ishte i artikuluar qartë, e çdo zë të rrotullohej rreth tij. Ish-kreu i demokratëve ka qenë i fiksuar deri në mani në këtë drejtim.

Në protestën e 7 korrikut, dhe në ditët që i paraprinë asaj, u vu re një larmi, një pluralizëm mesazhesh. Edhe pse lajtmotivi ishte përmbledhur në dy fjali; “Shqipëria në rrezik”, dhe; “Mos thuaj ç’më duhet mua”, gati çdo kontribues, folës, thirrës, u la i lirë të thoshte arsyet pse ishte aty, pse kërkonte largimin e qeverisë. E pati një laryshi me përmbajtje në ato dy orë të darkës, një grumbull përmbajtjesh, që buluroi nga mikrofonat e protestës.

Nga çmimet, tek reforma në drejtësi, tek Soros, e vlerat konservatore.

Aktivistë të shoqërisë civile pasuan njërijetrin në podium e lëshuan revoltën.

Adresimi politik nisi të konturohej prej dy folësve nga PD, që qenë përzjedhur të ishin Belind Këlliçi e Agron Shehaj, të dy që nuk ja dolën të fitonin garën për nën-kryetar, përballë Luçiano Boçit e Oerd Bylykbashit.

Lakonik, Shehaj tha se qytetarëve u duhet ofruar alternativa e ndershmërisë.

Ndërsa Këlliçi ishte më denoncues, duke akuzuar qeveritarët, Ramën e Veliajn, se po e vrasin Shqipërinë.

Kjo përgatiti terrenin për ngjitjen në skenë të Sali Berishës, i cili bëri publik qëndrimin aspak të moderuar në lidhje me qeverinë. Ai shpalli se Edi Ramën, e ka armik.

“NE JEMI ARMIQ”

Sali Berisha tha se arsyeja kryesore e kësaj proteste ishte shkundja, ndërjegjësimi i pjesës së heshtur të shoqërisë, dhe ftesa që ata të bashkohen për të shpëtuar Shqipërinë.

Mirëpo, në një moment, ai e emëtoi pikën më të fortë të qëndrimit, ç’ka do të jetë me gjasë një gur themeli për raportet me mazhorancën, dhe do të tregojë se çfarë stine të nxehtë politike do të kemi në vijim.

Ai i tha Edi Ramës, që nuk janë kundërshtarë, rivalë, por armiq.

“Edi Rama, ne të dy jemi armiq, është e

rëndë ta them këtë, por zemra ime fjalë tjetër nuk nxjerr. Ti do vetëm pushtetin, ndërsa une me këta burra e gra, djem e vajza, kemi parim lirinë dhe vetëm lirinë”, u shpreh lideri i demokratëve.

Jemi armiq, shtoi Berisha, sepse ti e do pushtetin për t’u pasuruar e varfëruar Shqipërinë, ndërsa ne duam lirinë për të zhvilluar vendin.

Kjo kthesë radikale nënkupton shumë gjëra, por mbi të gjitha se nuk do të jetë e lehtë ulja në tryezën e bisedimeve për çështje ku palët në këto vite kanë patur vullnetin të merren vesh. Dhe sidomos, tregon se kur kjo të ndodhë, Berisha nuk e ka ndërmend të dalë nga tavolina pa marrë rezultatin që dëshiron.

....



DEPUTETËT SKEPTIKË

Nëse një nga synimet e protestës ishte bashkimi mes vetë demokratëve dhe afrimi i deputetëve që janë skeptikë me Berishën, e anojnë ende nga Basha, mund të thuhet se në këtë sens u arrit jo pak. U vunë re në protestë, edhe përfaqësues si Jorida Tabaku, që nuk është dakort me kursin e politikës së doktorit, për të cilat, ajo u kujdes më tej, në dy ditët që pasuan të bëjë publike vendosmërinë e saj, me disa shënime në rrjetin social, ku mori shumë kontestime prej demokratëve.



Aleatët

Me protestën e 7 korrikut, Sali Berisha gjithashtu konfirmoi aleatët e tij, ata të vegjlit pranë PD, dhe më e rëndësishmja, LSI-në, kryetarja e së cilës qendroi në krah të liderit demokrat gjithë kohës.

Deputetët që ngelen dyshues ndaj Berishës e s'janë pasues të tij mirëfilli, e që u paraqiten me 7 korrik, ishin:

Flamur Hoxha, Jorida Tabaku, Alfred Rrushaj, Helidon Bushati Saimir Korreshi, Emilia Koliqi Merita Baku, Tomorr Alizoti Xhelal Mziu, Dashnor Sula Bledion Nallbati, Fatjon Veizaj Kastriot Piroli, Lefter Geshtenja Greta Bardeli, Lindita Metaliaj Zef Hila, Dhurata Çupi

ÇFARË ARRITI BERISHA

Berisha arriti jo pak me protestën e 7 korrikut. Ai është cilësuar dhe damkosur prej një viti edhe në shkelje të një etike njerëzore, si i vdekur, si pastë dritë, si katran me bojë, e plot epitete të ashpra prej Ramës e pasuesve të tij. Më anë tjetër, jo pak kanë menduar se i shpallur non-grata, lideri i demokratëve do ta kishte të pamundur të ngrinte sërish krye, e jo më të rikthehej në fuqi.

Pjesëmarrja masive mbrëmjen e 7 korrikut, ishte si përgënjeshttrim i athët për shumëkënd. Ishte po ashtu një mesazh i qartë për ata që e duan jashtë politikës, se nuk i kanë bërë llogaritë mirë.

Gjithashtu, debati brenda kampit demokrat mori fund një herë e mirë. Askush tjetër tanimë nuk mund të pretendojë fronin e kryetarit, në atë parti, në atë strukturë, në atë formacion politik. Do të ishte qesharake, dhe diabolike, të kapësh tanimë në artifica, në elementë të tjerë, apo në

vendime gjykatash, për të mbajtur nën kontroll Partinë Demokratike.

Ata që janë kjo parti, e demonstrojnë se kë duan në krye, e si dëshirojnë t'i udhëheqë.

Pra pas 7 korrikut, është botërisht e qartë, se nuk ka më dy PD, dhe marrin fund diskutimet me; po sikur.


Një arritje tjetër mund të konsiderohet edhe kursi i ri i shpallur. Ajo çka dihet me siguri është se Sali Berisha nuk tërhiqet, dhe e çon deri në fund një projekt. Pas shpalljes armik, që i bëri në Bulevard, Rama me gjasë, do të duhet ta marrë në konsideratë PD-në dhe opozitën. Nuk është më në selinë blu ai djali i mirë, të cilit ja prish marrëveshjet, një ditë pasi i ke firmosur.

Sinjalet e forcës që Berisha i dërgon Ramës, vijnë bash në momentin që ka nisur diskutimi i reformës zgjedhore dhe territoriale. Aty ku opozita do të duhet të korrë maksimumin, për të patur rezultate në betejën më të afërt, që janë zgjedhjet vendore të pranverës së vitit të ardhshëm.

Për të cilat, Berisha s'do të humbë asnjë minutë kohë, duke qenë se kandidatët do të dalin herët, me primaret që do të zhvillohen në shtator.

Me protestën e 7 korrikut, Sali Berisha gjithashtu konfirmoi aleatët e tij, ata të vegjlit pranë PD, dhe më e rëndësishmja, LSI-në, kryetarja e së cilës qendroi në krah të liderit demokrat gjithë kohës.

Tani ata që kanë besuar se të vdekurit nuk i shkon njeri pas, do të duhet të bëjnë strategji të tjera politike.



Spitali Amavita

Duaje jetën!

- Laborator Analizash
- Ekografi të Ndryshme
- Kirurgjia e Nishaneve
- Onkoplastika
- Imazheri
- Sherbimi i Kimioterapisë

- Kirurgji Onkologjike
- Kirurgji e Përgjithshme
- Kirurgji Gjinekologjike
- Kirurgji Maksilofaciale
- Kirurgji e Tiroideve
- Kirurgjia Plastike



GJIRI i KAKOMESË



“BUKUROSHJA” E BRAKTISUR BËHET GATI PËR **TURIZËM**

Kakomeja mund të jetë ndër rastet unike sesi shteti ka dështuar në tërheqjen e investitorëve të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit. Me një bukuri që të lë pa frymë, prej vitesh investimi gjigand ka mbetur i bllokuar: por tanimë, ka një shpresë për rifillimin nga puna



Nga **FATOS ÇOÇOLI**

Me një bukuri sa marramendëse, aq edhe pikëluese, Gjiri i Kakomesë, në bregdetin e Jonit, vetëm 10 kilometra larg Sarandës, është ndër më të bukurit e Rivierës sonë.

Nga toka, zor se mund të hysh ta shijosh këto

vite. Kush shkon nga deti, me skaf, motobarkë apo mjete të tjera lundruese, nuk harron të mbajë në celular si kujtim fotot e Gjirit të famshëm por edhe ujrat e kristalta që të bëjnë të mendosh se nuk është një plazh shqiptar.

Ndoshta është aq i bukur ende, sepse është ende i paprekur. Por, dhe kjo paprekshmëri ka pasur ndër vite kostot e saj, si financiare, ashtu edhe njerëzore.

Gjiri futet në tokë disa qindra metra dhe ka një gjerësi 300–400 m, me një plazh me rërë të ashpër e të bardhë, të tipit zall, Shpati malor në jug të gjirit është i veshur me bimësi natyrore të ruajtur mirë, ndërsa shpati verior është shkëmbor, i zhveshur nga drurët.

Sot gjendet i braktisur në shkurret e tij dhe i pafutur në hartën e destinacioneve turistike elitë për Mesdheun, njëlloj si Sazani, ishulli shqiptar, ndër të paktët (numërohen me gishtat e njëres dorë) i lënë ende në gjendje të egër në Mesdhe.

Në këtë zonë kanë qenë disa ndërtesa një dhe dykatëshe të ish-Repartit Ushtarak 5588 Delvinë dhe më vonë të Repartit Ushtarak 5500 Gjirokastrë. Në vitin 1993, me miratimin e Planit Urbanistik nga Ministria e Turizmit dhe nga Kryeministria, Gjiri i Kakomesë u kthye në zonë turistike.

Më datë 23 qershor 2004, Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë miratoi një projekt turistik në Gjirin e Kakomesë, paraqitur nga kompania “Riviera” e sipërmarrësit Dritan Çelaj.

Mbi bazën e këtij vendimi të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRTRSH), Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, si përfaqësues e Shtetit shqiptar, nënshkroi më 5 korrik 2004 dy marrëveshje me kompaninë “Riviera”, sot e emërtuar “Riviera Kakome”, për zhvillimin e projektit turistik të miratuar nga KRTRSH, Marrëveshjen e Zhvillimit dhe Marrëveshjen e Qerasë për 99 vjet, për një sipërfaqe prej 70 ha në pronësi shtetërore.

Kompania “Riviera”, më vonë e emërtuar “Riviera Kakome” gëzonte titullin e Personit të Stimuluar, që në mars të 2004 me vendim të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të kohës, në një procedurë, që bazohej në ligjin për zhvillimin e zonave me përparësi turizmin.

MARKA “CLUB MED” NË 2004 DO KISHTE PATUR RËNDËSINË E COCA-COLËS SË 1994!

Në vitin 1994, kompania e mirënjohur në botë e pijeve freskuese “Coca Cola” ndërtoi fabrikën e parë të ambalazhimit të pijeve freskuese, duke prodhuar marka ndërkombëtare të njohura pijesh në vendin



FOTO E NËJË RESORTI TURISTIK TË MENAXHUAR NGA CLUB MED NË CANCUN, MEKSIKË

tonë. Shqipëria kishte me pak se 4 vite që kishte dalë nga ferri komunist, me një ekonomi të rrënuar që kërkonte dëshpërueshmërisht emra të njohur dhe investime perëndimore. Fabrika e ambalazhimit e Coca-Colës në të dalë të Tiranës nënkuptoi shumë për ekonominë tonë në atë kohë. Ishte dallëndyshja e shpresës se Shqipëria do të modernizohej.

E ndërtuar për afro tre muaj, 28 vitë më parë, me 20 punonjës fillimisht, sot Coca-Cola Shqipëri ka 342 të punësuar dhe një portofol pijesh freskuese si Coca Cola, Fanta, Sprite dhe Schëepes, duke sjellë 5,437 vende pune në ekonominë tonë, përmes zinxhirit të saj të furnizimit. Sipas një studimi kërkimor të Universitetit SDA Bocconi, dega Menaxhim, Itali, kjo kompani, me prodhimin dhe rrjetin e saj të shpërndarjes, ndihmon në gjenerimin e 0.2 përqind të prodhimit tonë kombëtar.

Të njëjtën gjë do të kishte bërë 10 vite më vonë, në vitin 2004 në Kakome, edhe kompania e mirënjohur ndërkombëtare e menaxhimit të destinacioneve turistike, Club Med (Klubi Mesdhetar) (https://en.wikipedia.org/wiki/Club_Med), me 1.4 miliardë euro të ardhura vjetore dhe mbi 20 mijë punonjës në mbarë botën. Kompania kishte shprehur interesin dhe ishte e gatshme të menaxhonte resortin turistik që do të ndërtohej në Kakome.

ÇËSHTJA LEGALE E KAKOMESË

Po në vitin 2004, nisin punimet e para për sistemin e terrenit në Gjirin e Kakomesë, për ndërtimin e resortit turistik të projektuar dhe ku priste për ta menaxhuar Club Med. Punimet u bllokuan nga protestat e fshatarëve të një fshati malor 7 km në lindje të Gjirit të Kakomesë, të quajtur Nivicë Bubas.

Fshatarët pretendonin pronësinë mbi truallin e Gjirit, por nuk kishin asnjë dokument ligjor për ta vërtetuar këtë.

Dokumentat e vjetra të pronësisë mbi tokën janë shumë të njohura tek ne. Në tokat rreth qytetit të Gjirokastrës disa dhjetëra km më larg nga Nivica e Kakomeja, familjet gjirokastrite të paraqesin edhe dokumenta pronësie në turqishten e vjetër, përpara vitit 1908, kohës së revolucionit të Xhonturqve.

Në fakt, që në kohën e Mbretit Zog, tokat në bregdetin e ashpër dhe shkëmbor të Jugut, me mungesë të theksuar të ujit të pijshëm, konsideroheshin të papërshtatshme për investim dhe banim dhe ishin ruajtur në kadastrat e Zogut tërësisht si toka shtetërore, me ndonjë përjashtim shumë të rrallë.

Fshatarët e Nivicës nuk kishin asnjë dokument të vjetër shkresor që të provonte pretendimet e tyre, vetëm folklor dhe histori fshati për trashëgimi tokash brez pas brezi në bregdet.

Megjithatë, në vitin 2006, dy vite më vonë, subjekti “Bashkëpronësia e fshatit Nivicë” iu drejtua Komisionit Vendor të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Qarkut Vlorë, duke kërkuar njohjen dhe kthimin e një prone prej 4 mijë hektarësh kullota, duke filluar nga Saranda në jug dhe duke mbaruar me Lukovën në veri. Në këtë kërkesë, përfshihej dhe sipërfaqja në Gjirin e Kakomesë.

Duke parë se realizimi i projektit turistik në Kakome i kishte hyrë një rrugë të ndërlikuar dhe të gjatë ligjore, për fat të keq të vendit dhe ekonomisë sonë, Club Med u detyrua të hiqte dorë nga plani për të menaxhuar një resort turistik në Shqipëri.

Nërkohë, Komisioni Vendor i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Qarkut Vlorë, me Vendimin Nr. 204, datë 18 korrik 2006, e rrëzoi kërkesën e subjektit “Bashkëpronësia e fshatit Nivicë”.

Më tej, Bashkëpronësia e fshatit Nivicë e ankmoi vendimin e këtij komisioni pranë Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave. Kjo Agjenci, me Vendimin Nr. 244, datë 7 shtator 2007, e rrëzoi kërkesën e subjektit “Bashkëpronësia e fshatit Nivicë”, duke mos njohur edhe pronësinë e fshatit Nivicë mbi Gjirin e Kakomesë.

Më tej, Bashkëpronësia e fshatit Nivicë e hedh në gjyq Agjencinë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave për Vendimin Nr. 244 të saj. Padia e subjektit “Bashkëpronësia e fshatit Nivicë” rrëzohet në të gjitha shkallët e Gjyqësorit, me *Vendimin me Nr. 7153, datë 28.07.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin me Nr. 786, datë 15.06.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me Vendimin me Nr. 362, datë 07.07.2011 të Gjykatës së Lartë dhe me Vendimin me Nr. 75, datë 15.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese.*

Koha kaloi e pamëshirshme dhe legjislacioni shqiptar ishte po ashtu i tillë, në rast se nuk ke respektuar kontratën për investimin e premtuar. Ligji 10186 datë 5 nëntor 2009 “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, në Nenin 16 pika 1 e tij parashikonte që personat e stimuluar ose subjektet me marrëveshje qiraje dhe zhvillimi, që nuk kanë përmbushur detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja e qirasë, i humbin të drejtat e tyre.

Në këto kushte, kompania “Riviera Kakome”, u detyrua të siguronte projektin



e saj, duke i blerë ALUIZNI-t, në formën e Kontratës së Privatizimit, më 23 mars 2012, në bazë të të gjithë legjislacionit në fuqi, të 29 hektarëve në Gjirit të Kakomesë, prona të pakundërshtueshme shtetërore.

Në bazë të Kontratës së Privatizimit, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme Sarandë lëshoi më 16 mars 2012 Vërtetimin Hipotekor me Nr. 34 për pronën në Gjirin e Kakomesë, në emër të kompanisë “Riviera Kakome”, e cila zotërohet në mënyrë të barabartë nga dy ortakët Dritan Çelaj dhe Luan Leka.

HYRJA NË SKENË E NJË SIPËRMARRËSI TË SUKSESSHËM

Luan Leka, një shqiptar shumë i njohur në komunitetin investues të vendit, drejtues prej afro tre dekadash i një prej kompanive më të rëndësishme në tregun e përpunimit të mishit dhe prodhimit të sallameve në vend, prodhues dhe shpërndarës i ujit Qafë Shtama, përfaqësues në vend i rrjetit të mirënjohur ushqimor italian Conad, punëdhënës i mbi 1 mijë punëmarrësve në Shqipëri dhe me një xhiro vjetore të sipërmarrjeve të tij prej mbi 104 milionë euro, pagues i rregullt i taksave dhe i detyrimeve të tjera fiskale ndaj shtetit tonë, shprehet se zhvillimi i një projekti investimi në atë vend iu duk tërheqës.

Fillimisht bleu toka nga kompania “Riviera Kakome”, duke besuar se projekti i saj për Kakomenë do të ishte unikal (sikurse është) në këtë pjesë të Mesdheut.

Mirëpo mungesa e sigurisë juridike dhe pamundësia për të gëzuar në mënyrë të qetë pronën e blerë në mënyrë të rregullt, kanë penguar deri tani realizimin e investimit tejet të rëndësishëm turistik në Gjirin e Kakomesë.

Në vitin 2017, si qershia e prishur mbi tortë, Bashkia Himare jep dy Akte të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMT), me sipërfaqe komplekse rreth 2400 metra katrorë, me përfitues dy fshatarë të fshatit Nivicë, në zonën e Gjirit të Kakomesë. Për këto dy tituj abuzivë mbi pronësinë e tokës, Jerosimo Basho, Drejtori i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Bashkinë Himarë, shpallet fajtor nga gjykata dhe dënohet me një vit burg, me kondicion (shërbim prove).



LUAN LEKA

Edhe pse titujt abuzivë nuk përbënin as edhe 1 përqind të sipërfaqes në Gjirin e Kakomesë, sërisht ato u bënë shkaktarë të bllokimit prej më shumë se një vit e gjysëm të nisjes së projektit.

PROJEKTI I RI

Me pronësinë e tokës më në fund të qartë, pas përfundimit të betejave ligjore, grupi serioz shqiptar investues, i përbërë nga kompanitë “Riviera Kakome”, “Agikons” dhe investitorët Luan Leka dhe Dritan Çelaj, po përpiqet të fillojë projektin sa më shpejt.

Fillimisht investimi ishte parashikuar në 220 dhoma. Projekti i ri e ka rikonceptuar dhe ripërmasuar ndërhyrjen, duke e bërë më miqësore me mjedisin dhe morfologjinë e tokës në Kakome.

Resorti do të funksionojë si një i vetëm, i menazhuar nga një kompani ndërkombëtare me emër dhe me synimin e sjelljes së turistëve elitarë në Shqipëri. Bëhet fjalë për resortin më të madh dhe tërheqës të Rivierës shqiptare, ndër më të bukurit edhe ndër brigjet dhe rivierat e Kroacisë, Malit të Zi dhe Greqisë.

Resorti në Kakome do të ketë 379 dhoma hoteliere të standartit 5 yje. Do të ketë gjithashtu 6 restorante, spa, dy pishina të brendshme dhe salla konferencash, të cilat do të kontribuojnë në zgjatjen e sezonit turistik në Jugun e vendit gjatë gjithë vitit.

Projekti parashikon ndërtimin e strukturave për sporte ujore dhe jo vetëm, si zhytje nëndet, kite surfing (fluturim me balona të motorizuara), barka me vela, etj., duke u përpjekur ta shndërrojë Gjirin e Kakomesë në një tërheqje dhe destinacion turistik për shumë më tepër se dy muaj në vit, sa është sot periudha e shfrytëzimit tërësor e gjithë Jugut turistik shqiptar.

Ekziston mundësia që investimi të njohë edhe një fazë të dytë zgjerimi dhe shtese, duke arritur në 600 dhoma hoteliere. Parashikohet që resorti të fillojë të funksionojë në verën e vitit 2025, nëse nisen tani punimet.

Studimi i fizibilitetit (leverdisshmërisë) të projektit është bërë nga kompania ndërkombëtare Horwath htl, kompania konsulente hoteliere dhe e projekteve të turizmit më e njohur në botë. Një kontribut të veçantë ka dhënë Shefi i Zyrës së Horwath në Itali, Zoran Bačić.

Horwath ka përgatitur edhe një listë të kompanive të interesuara për menaxhimin e resortit të Kakomesë, ku bëjnë pjesë disa nga operatorët turistikë më të njohur në botë, si Hilton, Accor, Radisson, Barcelo dhe Marriot.

SHTETI NË KAKOME

Nëse nuk ka ndërtim në zonën Sarandë-Lukovë është për një arsye të thjeshtë: nuk ka ujë. Të gërmosh për ujë deri në 70 m thellësi nuk arrin të gjejë ujë, ndërsa në një thellësi më të madhe, uji del i kripur.

Shteti shqiptar do të marrë 2 milionë euro takse infrastrukture për ndërtimin në Kakome. Ai duhet t'i garantojë Kakomesë ujin dhe dritat. Të dyja sipërmarrjet e shërbimeve esenciale, tubacioni i dedikuar



MAKET I PROJEKTI PËR KAKOMENË



Shteti shqiptar do të marrë 2 milionë euro taksë infrastrukture për ndërtimin në Kakome. Ai duhet t'i garantojë Kakomesë ujin dhe dritat. Të dyja sipërmarrjet e shërbimeve esenciale, tubacioni i dedikuar për Kakomenë dhe shtrirja e linjës elektrike, nuk kushtojnë të dyja më shumë se 1.2 milionë euro

për Kakomenë dhe shtrirja e linjës elektrike, nuk kushtojnë të dyja më shumë se 1.2 milionë euro. Pra, më pak se taksa që merr shteti nga ky ndërtim.

Jo vetëm investimin në Kakome, por në të gjithë Jugun, në nivel të pranisë së turistëve të huaj, do ta ndihmonte shumë, krahas rrugës së porsainaguruar Kardhiq-Delvinë dhe përfundimit të Tunelit të Llogarasë, edhe përsheptimi i ndërtimit të Aeroportit turistik në veri të Sarandës. Me të, aksesit për në resortet e bukura të Rivierës, duke përfshirë edhe resortin e Kakomesë, nuk shkon më shumë se 30-40 minuta, nga 3.5 orë që kërkon tani rruga nga Aeroporti i Rinasit. Dhe një turist i huaj perëndimor, që ka pritur dy orë në aeroportin e nisjes, që ka fluturuar një ose disa orë për të mbërritur në Shqipëri, nuk mund të pranojë 3.5 orë rrugë!

Kompanitë e mëdha turistike që mund të sjellin me mijëra e dhjetëra mijëra turistë perëndimorë në brigjet e Jonit, dy gjërat e para që pyesin për resortet tona (si dhe kudo) janë: 1-Sa shtretër ka resorti dhe 2-për sa kohë arrihet nga aeroporti më i afërt.

PSE KA RËNDËSI KAKOMEJA PËR NE TË GJITHË

Së pari, me investimin në Kakome, turizmi në Jug të vendit fiton më shumë muaj. Resorti aty do jetë i përgatitur mirë për turizmin e konferencave të biznesit dhe të tematikave të tjera, përgjatë gjithë vitit.

Së dyti, kompania e mirënjohur ndërkombëtare që do ta menaxhojë, do të organizojë oferta tërheqëse për të gjitha moshat dhe portofolet, gjatë gjithë vitit. Në dimër ose vjeshtë e vonë mund të vijne turistët e moshës së tretë në mes të një panorame mbresëlënëse dhe një klime të shëndetshme e të butë edhe në dimër.

Së treti, me Kakomenë si investim i sigurtë, më

në fund, do t'i afrohet Shqipërisë edhe kapitali investues i huaj (jo vetëm menaxhues) i firmave të njohura ndërkombëtare, ndërtuese resortesh nga më të bukurat anembanë globit.

Së katërti dhe që përbën përmasën sociale dhe gjithëpërfshirëse në dobi të turizmit tonë, ende pa filluar resorti aktivitetin, grupi investues po mendon të angazhohet në nismat lokale dhe kombëtare për pastrimin e bregdetit, të bregdetit Jon në rradhë të parë, dhe pastaj të të gjithë bregdetit shqiptar.

KAKOME SI NISJE E INVESTIMEVE ELITARE NË TURIZMIN SHQIPTAR

Parashikohet një vlerë investimi rreth 60 milionë euro. Disa banka të rëndësishme dhe me potencial të jashtëzakonshëm, janë treguar të gatshme të mbështesin investimin. Ndër to, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Kompanitë ndërtuese të Resortit Kakome janë shoqëri kryesisht prodhuese dhe ndërtuese. Ato asnjëherë nuk kanë përfituar, por vetëm kanë kontribuar në fondet dhe paratë publike.

Projekti i Gjirit të Kakomesë përfaqëson një angazhim të madh dhe serioz, i cili do të hapë te pakten mbi 500 vende të reja pune te perhershme për banorët e zonës (për të mos folur për mijëra vendet e reja të punës së furnitorëve të resortit dhe te kompanive të lidhura me të) dhe kryesorja, do të bëhet një histori suksesi dhe pranie markash ndërkombëtare menaxhimi, që do të sjellë besim, entuziazëm dhe një fluks idesh dhe projektesh cilësore dhe elitare për turizmin shqiptar, si dhe kapital të konsiderueshëm të huaj. Një qasje e ngjashme me atë të Kroacisë dhe zhvillimit turistik të ishujve të saj.



EKONOMI

RIKTHIMI I ÇAMËRISË NË PARLAMENT

78 vjetori i genocidit grek ndaj shqiptarëve, përkujtimore që nga Argjentina e Izmiri deri në Maqedoninë e Veriut



Nga REZARTA DELISULA

Burra, gra e të rinj, zemërdjegur nga e shkuara e tmerrshme e familjeve të tyre, nga rropatjet disa vjecare e trajtimi i vazhdueshëm sikur nuk ekzistojnë, qëndruan para parlamentit të Shqipërisë më 8 prill 2004, duke kërkuar miratimin e rezolutës ku kërkohej që në kuadër të Traktatit të Miqësisë, Bashkëpunimit e Fqinjësisë së Shqipërisë me Greqinë të rimerrej në shqyrtim çështja çame, për tu zgjidhur një herë e përgjithnjë problematika e pronave dhe pasurive të tjera të tyre në territorin që sot i përket Greqisë. Presioni politik ishte i jashtëzakonshëm ndaj shkopinj gome u derdhën mbi çamët, të cilët edhe pse të rrahur e gjakosur ndenjën aty, stoikë, deri sa rezoluta u miratua. 18 vjet më vonë, dëshmitarë të gjallë të genocidit grek mbi popullsinë e Çamërisë, aktivistë të shoqërisë civile, ambasadorë e studiues, mbushën sallën e parlamentit në përkujtim të 27 qershorit, ditës së gjenocidit mbi shqiptarët e Çamërisë dhe spastrimin etnik. Çdo qershor, deputetë të Grupit Parlamentar Demokraci dhe Integrim,



PDIU, Fondacioni Çamëria “Hasan Tahsini” dhe shoqata Patriotike “Çamëria” organizojnë javën e Çamërisë, organizim i cili më 2022 shkoi përtej kufinjëve të Shqipërisë. Ndërkaq pas një fjalimi shumë domethënës së deputetit dhe kreut të PDIU gjatë seancës plenare të 30 qershorit ai u kërkoj kolegëve të ngiheshin më këmbë e të mbanin një minutë heshtje në nderim të viktimave të gjenocidit grek ndaj Çamërisë, bazuar në ligjin e miratuar më 30 qershor 1994 për shpalljen e datës 27 qershor në kalendarin kombëtar, si dita përkujtimore e gjenocidit ndaj shqiptarëve të Çamërisë, shpallur me dekretin 885, në datën 12.7.1994. Ndërkohë në tavolinat e deputetëve ishin vendosur edhe trëndafila të kuq në shenjë respekti për viktimat e gjenocidit.

DËSHMITË RRËNQETHËSE

Profesor Nexhat Merxhushi është një ndër dëshmitarët e gjallë që i mbijetoi krimeve ndaj popullsisë së pafajshme çame gjatë viteve 1944-1945. Edhe pse

PROFESOR NEXHAT MERXHUSHI
DHE KRYETARI I PDIU-SË, SHPËTIM IDRIZI



Vallja Çame e Osman Takës

Me vallen e udhëheqësit çam Osman Taka, valle që kërcëhet edhe në dasmat shqiptare, u mbyll aktiviteti i organizuar në Parlament, në kuadër të Javës çame. Osman Taka është një ndër figurat më të njohura të Rilindjes Shqiptare për rezistencën dhe organizimin e kryengritjeve anti-osmane. Pasi u arrestua dhe u burgos në Janinë ai u dënua me vdekje ndërsa si dëshirë të fundit kërkoi të kërcente. Sigurisht që xhandarët osmanë ia plotësuan dëshirën dhe pasi u mrekulluan nga vallja e kërcyer prej udhëheqësit çam, i falën lirinë. Osman Taka u vra pak ditë më vonë në Korfuz.

në moshë të madhe ai nuk ndalet së shkruari për historinë e vendit të tij, për krimet e bëra ndaj bashkëqytetarëve të tij. “Në një dokument të noterizuar të vitit 1945 tregohet se një grup grash të moshuara (ku në vend të firmës kanë vendosur gishtin), tri ditë pasi kish ndodhur masakra e 27 qershorit në Paramithi, shkuan dhe pastruan klasat e shkollës. Në mure të klasave kishin ngjitur tru me gjakun e të masakruarve. Një grua e moshuar çame, Mevludja, që banon në Laprakë, më tha:

Zor e kam të rroj! Plagët dhembin kur ftohen. Dhe kujton tmerrin e ditës së martë: “Ishte ditë e martë, 27 qershori 1944, ora 7:00. Xhelatët zervistë gratë i mbyllën në një shtëpi-burg, ndërsa u nxorën sytë vëllezërve Abedin dhe Gani Bako. Motrave, Mekos dhe Hajrijes, u ra të fiktë. I vetmi faj i vëllezërve Bako ishte se u mësonin gjuhën shqipe fëmijëve çamë fshehurazi nëpër shtëpi. Gratë ishin trimëresha. Dy zervistë i thanë nënë Ballkizes në burg “ta vramë dhe Xhelalin”. Megjithë dhimbjen që e shpoi si thikë, u përgjigj: S’ka gjë, luftë është, edhe do vriten, por mos harroni se kam edhe tre të tjerë. A harrohet djegia me benzinë e Sanije Nurit?! Apo therja e djalit të Fatime Pronjos, e cila paraqiti para Komisionit Hetimor Ndërkombëtar në Konispol, në vitin 1945, një tufë flokësh nga koka e djalit të saj si dëshmi? Komisioni u trondit”, tregon profesori.

MASAKRA SIPAS HISTORIANËVE GREKË

Planin grek për masakrat ndaj shqiptarëve të Çamërisë e pohojnës vetë historianët grekë. Autori grek Niko Zhango, në librin “Imperializmi Anglez” dhe “Lufta e popullit grek për

FAKSIMILE E REZOLUTËS TË MIRATUAR NË VITIN 2004 PËR ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES ÇAME



KIM MEHMETI

“Të heshtësh gjenocidin çam, të Kosovës, por edhe në Srebrenicë, nuk tregon vetëm çfarë shqiptari je, por çfarë njeriu je. Këtë nuk duhet ta lejojmë. Duhet të numërojmë deri në fund varret e shqiptarëve, se të tjerët vijnë dhe i mbledhin eshtrat e ushtarëve të tyre, por ata i fshehin, fqinjët. Ne kemi një oborr të përbashkët që duhet të kujdesemi dhe ajo është shqiptaria. Për këtë kopsht të përbashkët mban përgjegjësi ky tempull. Nëse nuk e mban duhet të ndërrojë emrin. Nuk mund të pajtohemi që shqiptari çam të mos mund të kthehet në vendlindje dhe Çamëri dhe t’i takojë ajo që i takon atij dhe ne të dëshmojmë që Çamëria është dhe do të mbetet pjesë e shqiptarisë.”

SHABAN MURATI

“Çeshtja çame është një çeshtje e pazgjidhur e çeshtjes së pazgjidhur shqiptare. Ajo është një çeshtje e pazgjidhur dhe e hapur në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë. Përgjegjësia për moszgjidhjen e saj të deritanishme ndahet midis shtetit, që e shkaktoi, dhe shtetit, që kishte detyrën kombëtare të kërkonte të zgjidhjes. Zgjidhja e saj kërkon tani kushtin “sine qua non” të hartimit shtetëror të një platforme diplomatike për çeshtjen çame. Diplomacisë dhe shtetit shqiptar u ka munguar kjo platformë për shkak të dobësive të drejtuesve të tyre, të cilët janë pajtuar me asimetrinë e marrëdhënieve midis dy vendeve. Çdo qeveri e Shqipërisë duhet të ketë në programin e saj qeveritar detyrimin kushtetues të zgjidhjes së çeshtjes çame.”

VARREZAT MONUMENTALE TË KOLLGJERIT, ATY KU PREHEN 2900 SHQIPTARË TË ÇAMËRISË

Në vitin 1944-45 bandat e Napoleon Zervës hyn në Çamëri dhe varanë mbi 3000 mijë civilë shqiptarë të Çamërisë dhe përdoqën nga trojet e tyre mbi 30.000 të tjerë. Më shumë se 2900, fëmijë, gra, burra e pleq vdiqën në kufi nga etja, uria dhe sëmundjet. Ata prehen në Varrezën Monumentale "Trëndafilat e Çamërisë" në Kllogjer të Sarandës e cila u ndërtua pas 68 vjetësh, nga spastrimi grek ndaj çamëve.



liri", botim i vitit 1985, Athinë, përkthyer dhe në anglisht, në faqet 257-58- 59-60, kur flet për masakrat në Paramithi, shkruan: "Për tri ditë rresht, 27-28-29 qershor 1944, Paramithinë e mbuloi një hije e zezë. Andartët, me pushkë në dorë, hynë në shtëpitë e shqiptaroçamëve dhe bënë atë që menduan dhe si deshën. Çfarë kishin çamët sende floriri, i dorëzuan të gjithë. Nuk është e mundur të jepet numri i saktë i shqiptaro-çamëve të Paramithisë, që u ekzekutuan nga zervistët në grupe dhe veças,

sepse në Paramithi kishin gjetur strehë dhe shqiptaro-çamë të fshatrave përreth". Dhe autori ndihet në faj, pasi përfaqëson njerëzit e ndershëm grekë: "Nga sa munda të mbledh, mund të shikojmë fytyrën tonë në pasqyrën e historisë. Do të duhet të na vijë turp për të gjitha ato që nuk ngajjnë me krenarinë e popullit tonë dhe të krenohemi me "vepra trimërie". Therjet e grave dhe fëmijëve nuk përputhen me zemrën e madhe të popullit të Epirit". Niko Zhongo vazhdon duke përmendur çamë të



SHPËTIM IDRIZI: KEMI KËRKUAR DËNIMIN E GJENOCIDIT DHE SPASTRIMIN ETNIK. GREQIA TË NA KËRKOI FALJE PUBLIKE

“Unë quhem Shpëtim Hysni Idrizi, babai im u dëbua në moshën 2-vjeçare nga Marglliçi. Sot jam në parlamentin e Shqipërisë dhe kërkoj drejtësi për familjen time, por edhe për ata mijëra shqiptarë që ndjenë thikën në palcë. Besoj që jam para jush dhe unë ekzistoj. Unë jam si deputet në këtë foltore të parlamentit të Shqipërisë për t’iu kujtuar që ekzistoj. Por si unë në këtë sallë janë dhe të paktën 5 deputetë të tjerë që kanë gjak çam dhe që ekzistojnë. Në këtë vend janë më shumë se 200 mijë çamë dhe ata ekzistojnë. Ne shqiptarët e Çamërisë nuk jemi rastësisht këtu, jemi pasardhësit e atyre që u vranë dhe u masakruan vetëm se ishin shqiptarë. Në zgjedhjet e fundit ishin të paktën 30 deputetë çam nga të gjitha forcat politike vetëm në 5 qarqe dhe ju e dini mirë që logjika elektorale përgënjeshtrohet çdo klishe politike. Prandaj ky arsyetim i pakuptimtë i diplomacisë fqinje kërkon një përgjigje serioze”. Me këtë rrëfim personal nisi diskutimin e tij në parlament kreu i PDIU Shpëtim Idrizi në seancën pas organizimit të “Javës Çame”, që është kthimi në testamentin e vuajtjeve të të pareve të tyre. Idrizi vazhdoi të kërkojë drejtësi për shqiptarët e Çamërisë ndërsa propozoi zgjidhje konkrete që nisin nga ngritja e një komisioni të dypalësh me akademikë mes Shqipërisë dhe Greqisë për të diskutuar çështjen çame deri te përgjigjia e qeverisë shqiptare, e cila duhet t’i japë përgjigjen e duhur palës greke në momentin që ata mohojnë ekzistencën e Çamëve. “Shqiptarët e Çamërisë sot e kësaj dite nuk gëzojnë dot pronat e tyre, shkak shteti i sotëm grek. Artikulli 1 i Konventës së Këshillit të Evropës garanton të drejtën e pronës brenda dhe jashtë vendit. Ky nen u dhunua. Shteti i sotëm grek ka një përgjigje foshnjare për këtë çështje. Thonë nuk e njohim, thonë që kjo çështje nuk ekziston. E padëgjuar ndonjëherë në diplomaci kjo shprehje. Kur ne themi që çështja Çame është një çështje politike dhe universale e të drejtave të njeriut, kemi të bëjmë me disa komponentë të saj. Unë dua t’u drejtohem në këtë sallë: Kush nuk ekziston? Ne kemi kërkuar dënimin e gjenocidit dhe spastrimin etnik. Ne kërkojmë nga Greqia një falje publike.”, përfundoi kreu i PDIU Shpëtim Idrizi.

ÇAMËT E IZMIRIT, MAQEDONI E VERIUT DHE KOSOVA PËRKUJTOJNË GENOCIDIN

Një grup shqiptarësh kanë protestuar më 25 qershor 2022 përpara konsullatës greke në Izmir. Ata kanë mbajtur një pankartë ku shkruhej: “Nuk e kemi harruar dhe kurrë nuk do të lejojmë që të harrohet gjenocidi i Çamërisë”, flamuj, shqiponjën dykrenore dhe thirrjet për drejtësi për Çamërinë. Protesta është organizuar nga Shoqata Patriotike Çamëria e Izmirit. Në kuadër të 78 vjetorit të kujtimit të gjenocidit aktivitetet kanë qenë të shumta për ta kujtuar dhe për të mos harruar nga parlamenti shqiptar pak ditë më parë dhe tashmë jashtë kufijve. Veprimtari në përkujtim të spastrimit etnik të shqiptarëve nga Çamëria u mbajtën edhe në Maqedoninë e Veriut e Kosovë.



masakruar dhe të vranë, emër për emër, sikur të ishin njerëzit e tij: “U ekzekutuar 18 veta te Përroi i Kariotit, 11 veta në Shën Panaja, 27 veta poshtë vendit ku u vranë nga gjermanët 49 grekë. U ekzekutuan të tjerë në shtëpitë e tyre, në rrugë e kudo që gjendeshin”.



MASAKRAT NDAJ POPULLSISË ÇAME



BILAL XHEFERRI, SHKRIMTARI DISIDENT

“Qëndrestar në përndjekje”, titullohet filmi dokumentar mbi biografinë e shkrimtarit disident me origjinë nga Çamëria, Bilal Xheferri është prezantuar në kuadër të Javës Çame. I mundësuar nga nga Fondacioni Çamëria “Hasan Tahsini” filmi dokumentar është realizuar sipas idesë së Uran Butkës, Institutit të studimeve “Lumo Skëndo”, me skenar të Prof. Dr Bashkim Kuçukut. Ky dokumentar sjell jetën e vështirë dhe të plotë të shkrimtarit nga Çamëria Bilal Xheferri, që nga lindja në fshatin e tij Ninat, deri tek vdekja e tij në SHBA. Dokumentari përmban dosjen e plotë të sigurimit të shtetit, që nga vrasja e babait të shkrimtarit, përndjekja e rregjimit komunist, ndalimin e botimit të veprave për të, apo edhe tek ngajrja e vitit 1969, kur pas kritikës së Bilal Xheferit për Librin “Dasma” të Ismail Kadaresë, në Lidhjen e Shkrimtarëve, me urdhër të Mehmet Shehut, ai duhej të internohej jo vetëm si shkrimtar, por edhe si Çam dhe botimet e tij të ndaloheshin.



U ekzekutua Hamdi Demi me tre djemtë e tij. U ekzekutua Lik Pronja me Veli dhe Azem Pronjo. U ekzekutua Isuf Pronjo, Qazim Rexhepi. Salih Hafuzi me djemtë (Nuhu, Tati dhe nipi Haki Myftari). U ekzekutua Meko Pronjo, motra e Lihut, të cilën e kryqëzuan me gozhda. Vranë Lypsarini (bari) Dautin, i cili s’ ishte në gjendje për asgjë, veç të tregonte mungesën e tij mendore dhe rrobat copë e çikë. Ekzekutuan Muftiun (Hasan Avdulla) me gruan dhe fëmijët. U ekzekutua Muharrem Ballati me birin, Brahon, me të shoqen dhe me djalin 12-vjeçar.


U dogj me benzinë e shoqja e Rahmi Nurit, Sanie Nuri (Bollati). U ekzekutua Harun Iljazi, 14 vjeç, Agako Bollati, Beqir Hyseni, Xhelal Bollati, me të birin Myzafer. U ekzekutua Luf Bollati, me të birin Fuatin, 15 vjeç. U ekzekutua Qani Bollati me të birin, 11 vjeç. U ekzekutua djali i Tahir Bilit, 8 vjeç. U ekzekutua Rexho Berberi, me gruan dhe vajzat (8-10 vjeç). U ekzekutua Avdo Hima, Gani dhe Abedin Bako, Fejzo Bakiu, Rexhep dhe Vesel Breka. U ekzekutua nusja e Nuhut të Asim Dinos me vajzën dhe djemtë (Lutfi 13 vjeç dhe Asim 10 vjeç) dhe dy fëmijët e vajzës (3 dhe 1 vjeç) si dhe burri i vajzës, Ahmet Beu, (djali i Fuat Pronjos).

U ekzekutua Omer Murati, Omer Merxhushi, vëllezërit Esat, Emin dhe Enever Elezin, Met Elezi, Haxhi Shehi dhe djali i Agako Beqo Sadikut (Nedimi, 11 vjeç). U ther si cjaq në



ALKET VELIU

“Ne jemi gati të falim për hir të paqes dhe bashkëjetesës në harmoni të brezave që vijnë, por për këtë duhet një pakt i guximshmëm i shtetit grek për të pranuar gjenocidin e ushtruar dhe për ta futur çështjen çame në rrugën e zgjidhjes në kuadër të të drejtave të njeriut, duke i kthyer shqiptarëve të Çamërisë çdo të drejtë të mohuar.”



PROF. DR. BASHKIM KUÇUKU

LIBRAT PËR ÇAMËRINË

Në kuadër të Javës Çame janë promovuar librat e shkrimtarit dhe aktivistit të çështjes çame, Hekuran Halili. Të dy librat “Babai dhe “Mite, legjenda dhe përralla nga Çamëria” tregojnë lashtësinë e krahinës së Çamërisë. Autori i veprave, Hekuran Halili, tregoi se në to, lexuesi gjen jo vetëm letërsi, por më shumë historinë e një popullate që vjen nga krahina e Çamërisë dhe ka vlera jo vetëm kulturore dhe patriotike, por ka vlera të shqiptarizmit. Po kështu Java Çame vijoi me promovimin e librit “Muhamet Kuçuku-Çami” përgatitur nga Prof. Dr. Bashkim Kuçuku, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i mundësuar nga Fondacioni Çamëria “Hasan Tahsini”. Vepra letrare tregon për dokumentimin e hershëm të çamërishtes. Sipas studiuesve ajo është një udhërrëfyes shumë i mirë studimor, jo vetëm dialektor, por i pasur në stilistikë, që tregon identitetin tonë si shqiptar të hershëm.

oborrit e shkollës Malo Kekeci. U ekzekutuan Malo Salica, Avdulla Salica (17 vjeç), Hajri Kupi me shokun e tij Mustafanë, Kupin e Dem Beqirit, Maksut Beqirin me të shoqen...

Nga mania për të gjetur para dy andartë sa nuk u vranë njëri me tjetrin. Në shtëpinë-burg të Sali Hafuzit vdiqën mbi 30 fëmijë nën 3 vjeç nga qumështi pluhur, ngaqë si sheqer përdornin xhamin e grirë shumë hollë. Asnjë masë nuk

u mor nga Dhespoti, Mirarhio apo autoritetet greke. (faqe 258-260). Shumica e të masakruarve dhe të vrarëve u bënë të shkolla e Paramithisë (Dhimotiko Skolio) me armë të ftohta.

Këto janë vetëm disa dëshmi të mbledhura nga masakrat e grekëve ndaj popullsisë çame, ndërsa sot e kësaj dite çamët nuk mund të kthehen dot në vendin e tyre, madje as për të vizituar shtëpitë e të parëve të tyre...



HISTORIA

78 VJETORI I GENOCIDIT GREK, MESHË NË KISHËN ORTODOSKE SHQIPTARE NË ARGJENTINË



ALEJANDRO GRECO

Alejandro Greco, i njohur si kryepeshkopi Aleksandër i Shqiptarëve, ka mbajtur një meshë me rastin e 78 vjetorit të genocidit ndaj popullsisë Çame. Duke cituar Fan Nolin i cili ka thënë se “Çamët janë Shqiptarë dhe vendi i tyre është Çamëria”, kryepeshkopi i Buenos Aires njoftoi se; me rastin e 78-të vjetorit të Genocidit Çam, nga fanatizmi i frikacakëve grek, ku u masakruan 100.000 Shqiptar, sot më 27 qershor, ora 21.30, mbahet në Kishën Ortodokse Shqiptare të Buenos Aires në Argjentinë, Shërbesë Mbrëmësore në Vigjilje të Natës së flijimit të Dëshmorëve e Popullit Çam/Shqiptar... Çamëria ka qenë dhe mbetet një vatër e trimërisë shqiptare, një vatër diturie. Çamëria ose Thesprotia shtrihet nga lumi Pavël i vjetër deri në Prevezë, nga deti Jon në perëndim deri në malet e Pindit në lindje, si pjesë Etnike e Kombit Shqiptar, që është nga popujt më të vjetër të Evropës...! gjithë Kombi jemi Çamëri!!!

OTHER MESSAGE
IN
From: OCCUPATION (Maj. SMITH)
To: FORCE 399 for DG

TOP SECRET

No 1 of 4 Oct.
Folio No: 1530

From BRITISH. BOMB today called meeting all heads missions made following statement. *29 and 30 Sept Partisan forces near Greek frontier at ATHENS attacked by mixed forces Ems and GERVAS who crossed into ALBANIA. Two Partisans killed seven wounded. Order from BOMB Partisans will pursue GERVAS into GREECE as their action considered open aggression though ALBANIAN do wish interfere with other nationalities."

Distribution:-

DG Action
Comd
ISS MAP
Mr. Good
Comd LPA
HQ SOU
SOM Liaison Staff AFHQ
Mr. Patis
War Diary (2)

RAPORTET TOP SECRETË ARKIVAVE
BRITANIKE TË DEKLASIFIKUARA



REFUGJATË ÇAMË NË KAVAJË, MARS 1945, UNRRA,
S-0800-0001-13-28, ARKIVA E KOMBEVE TË BASHKUARA (FOTO: RISTANI)

RAPORTI SEKRET

BRITANIKËT: "18 MIJË ÇAM U DËBUAN, 800 U VRANË", SI U KRYE GENOCIDI GREK NË SHQIPËRI

| Nga ERALD KAPRI

Tragjedia dhe genocidi ndaj shqiptarëve të Çamërisë i vitit 1944 është një ngjarje që mohohet ende nga Shteti Grek. Vrasjet, largimet me dhunë nga trojet historike, marrja e çdo pasurie dhe prone, mbetet një çështje e pazgjidhur në kushtet kur pala greke nuk pranon asnjë përgjegjësi.

Arsyeja themelore e mohimit grek mbetet, sipas tyre, mungesa e fakteve. Genocidi ndaj Çamërisë mohohet për arsye etnike dhe pranohen vetëm episode për shkak të Luftës së Dytë Botërore.

Por pavarësisht këtij narracioni mohues, Tragjedia Çame është e dokumentuar. Jo thjeshtë e vetëm përmes dëshmive

78 vjetori i Genocidit grek kundër shqiptarëve të Çamërisë përcillet në faqet e revistës Newsbomb.al me dokumentet sekrete britanike të kohës. Pala greke, kurrë nuk e ka pranuar genocidin, nuk ka kërkuar falje për vrasjet makabre. Por dokumentet janë aty, veç dëshmimeve të mbijetuarve. Çfarë kanë shkruar kolonelët britanikë në raportet e tyre dhe cilat janë opsionet e shtetit shqiptar për të rihedhur këtë “plagë” në tryezën e bisedimeve...

të mbijetuarve, por mbi të gjitha përmes një dokumentacioni të rrallë të kohës të hartuar nga ushtria aleate britanike, e cila hetoi në fshehtësi të plotë në vitin 1944 çfarë ndodhi me shqiptarët e Çamërisë.

Dokumentacioni i ushtrisë Britanike fle akoma në arkivat e njohura të Londrës dhe mund të ishte shumë i vlefshëm nëse Shqipëria do hapte një proces ndërkombëtar ligjor që do detyronte Greqinë të pranonte përgjegjësinë e saj; njohjen e tragjedisë Çame, respektimin e të gjithë detyrimeve të të drejtave të njeriut, dhënia e një ndjese dhe lejitimit të shqiptarëve të Çamërisë të ktheheshin në trojet e tyre shekullore.

Disa dosje në Arkivin Britanik përmbajnë raporte nga terreni të disa oficerëve britanikë dhe analiza të tjera të cilat hedhin dritë mbi dëbimin dhe vrasjen e Shqiptarëve të Çamërisë.

Pozicionimi i forcave të Napolon Zervës (një gjeneral grek lindur në Artë të Epirit) në zonën bregdetare shqiptare ngjalli dyshime dhe britanikët vëzhguan operacionet ushtarake të tyre, në kushtet kur forcat gjermane nuk ishin larguar ende nga Greqia.

Një dosje prej dhjetëra faqesh e vitit 1945, e hartuar nga Ministria e Jashtme

Britanike, i dedikohet dëbimit të shqiptarëve dhe përgjegjësisë së çdo pale, madje edhe të vetë britanikëve dhe rolit të tyre në këtë dëbim.

Dosja me kodin HS 5/91 përmban korrespondencat e kohës së oficerëve britanikë në terren, me komandën e tyre në Bari të Italisë, si dhe disa raporte interesante.

Në një prej raporteve të kësaj dosjeje, konfirmohet se shqiptarët ishin paralajmëruar për tragjedinë dhe masakrat që po i prisnin. Sipas tyre, një ditë para nisjes së sulmeve së Zervës, ishin vetë gjermanët që paralajmëruan minoritetin shqiptar çam të largohet, duke u dhënë madje 40 ditë kohë. Për shkak të arsyeve taktike ushtarake, gjermanët nuk vepruan mbi trupat e Zervës.

“Në qershor të vitit 1944, trupat e Zervës sulmuan dhe morën zonat e Paramithisë dhe Pargës, duke kërcënuar kështu të gjithë minoritetin shqiptar nga Margariti në perëndim në bregdet, dhe në veri në rrugën Janinë-Igumenicë. Për arsye taktike, gjermanët vendosën që këto zona të mos i rimarrin dhe paralajmëruan minoritetin shqiptar të vendoset në veri të rrugës Janinë- Igumenicë, në një periudhë prej 40 ditësh, duke nisur nga data 26 qershor, 1944. Ata e ndoqën këtë këshillë dhe trupat e Zervës ecën në gjurmët e tyre. I gjithë minoriteti shqiptar në këto zona, me gra e fëmijë, bashkë me gjënë e gjallë, shkuan drejt veriut për në Shqipëri, ndërsa burrat qëndruan rreth zonës së Filatit, për të luftuar me grekët. Ka shumë mundësi që këta minoritarë kanë luftuar kundra Zervës bashkë me gjermanët”, thuhet në një raport britanik të 21 shtatorit, 1944, i hartuar nga kapiteni britanik Mind.

Ai raportoi më tej se pozita e shqiptarëve të Çamërisë do të përkeqësohet, për shkak se një pjesë e madhe e tyre ishin bashkuar me grupet komuniste të EAM-it në Greqi. Trupat e nacionalistit grek, Napolon Zerva dhe EAM kishin nisur tashmë armiqësinë mes tyre, që shkoi deri në një luftë civile disavjeçare në Greqi.

Ndonëse komunistët shqiptarë të Luftës Nacional Çlirimtare (LNÇ) qëndruan mjaft pasivë mbi tragjedinë çame, ata u përballën me një incident tepër të fortë me trupat e Napolon Zervës, ku u përfshi personalisht edhe Enver Hoxha.

Sipas britanikëve, në datën 4 tetor 1944, Enver Hoxha thirri në një takim urgjent të


**RAPORTET
TOP SECRET
TË ARKIVAVE
BRITANIKE, TË
DEKLASIFIKUARA**

gjithë misionarët ushtarakë të huaj në Shqipëri, për t'u raportuar se trupat e Zervës kishin sulmuar partizanët shqiptarë në afërsi të kufirit në Konispol, duke lënë të vranë dy partizanë shqiptarë e duke plagosur 7 të tjerë. Sipas Hoxhës, Zerva kishte mbështetjen e gjermanëve në këtë aksion.

“Enver Hoxha thirri sot në një takim të gjithë krerët e misioneve të huaja dhe dha këtë deklaram: Në datat 29 dhe 30 shtator, forcat greke në afërsi të Konispolit dhe pranë kufirit sulmuan forcat partizane me një grup të përbërë me forca të Zervës dhe gjermanë, të cilët kaluan kufirin për në Shqipëri, 2 partizanë shqiptarë u vranë dhe 7 të tjerë u plagosën. Me urdhrin tim, forcat partizane do të ndjekin Zervën deri në Greqi, pasi aksioni i tyre konsiderohet si një agresion i hapur ndaj shqiptarëve, të cilët nuk kanë dëshirë të përfshihen me vendet e tjera”, raportoi për komandën e tij më 4 tetor 1944 oficeri britanik Smith.

Por, britanikët paralajmëruan ashpër Enver Hoxhën që të mos tentonte të kalonte kufirin me Greqinë. Duket se ata ia arritën ta bindin Hoxhën, nisur edhe nga fakti se çdo acarim situatë nuk do t'i vlente aspak Hoxhës. Nga ana tjetër, britanikët paralajmëruan edhe Zervën të mos vepronte në kufirin me Shqipërinë.

Sipas kreut ushtarak të komandës britanike në Bari, Zerva sulmoi zonat e shqiptarëve në Çamëri me justifikimin që ai të kalonte në bregdet për më shumë furnizime, por po ashtu edhe t'u merrte shqiptarëve ushqime e mall. Por, britanikët nuk dyshuan aspak se qëllimi i Zervës ishte vetëm dëbimi i shqiptarëve nga



RAPORTET TOP SECRET TË ARKIVAVE
BRITANIKE TË DEKLASHIKUARA

trojet e tyre.

“Zerva dëshironte të shkonte me ambiciet irredentiste greke, për të pastruar të gjitha tokat greke nga shqiptarët. Nuk është shumë e qartë se sa e drejtë ishte arsyeja e parë, e cila u përdor si justifikim nga Zerva për të bërë sulmin, që u cilësua si çështja më e rëndësishme nga Zerva. Por nisur nga akuzat se po sulmohen grekët që jetojnë në Jugun e Shqipërisë dhe dëshira e tij e shprehur që të shkojë në Veri, përtej kufirit, në

fakt tregon se arsyeja e vërtetë dhe më e rëndësishme ishte e arsyeja e fundit (përzënia e shqiptarëve). Për më tepër, minoriteti shqiptar përbuzet nga Zerva për më shumë se një arsye, dhe bashkëpunimi i tyre me EAM/ELAS i ka dhënë atij një justifikim më shumë për të goditur EAM/ELAS, sepse tashmë ai mund t'i akuzojë ata se bashkëpunojnë me minoritetin shqiptar “gjermanofil”, raportoi për Londrën komandanti britanik.

Por në mënyrë të hapur, ai pranoi edhe përgjegjësinë e palës britanike në tragjedinë çame. Sipas tij, misionet britanike ndihmuan shqiptarët të largoheshin sa më parë nga shtëpitë e tyre, për t'i shpëtuar dhunës. Sipas tyre, kjo u bë për qëllime humanitare.





REFUGJATË ÇAMË NË KAVAJË, MARS 1945.
UNRRA, S-0800-0001-13-28,
ARKIVA E KOMBEVE TË BASHKUARA (FOTO: RISTANI)



RAPORTI SEKRET

“Është e mundshme që partizanët shqiptarë nuk kanë besim te minoriteti shqiptar i Greqisë, pasi kanë frikë se mes tyre ka shumë njerëz që janë progrekë dhe me këtë rast kanë penetruar në Shqipëri, me qëllim për të parapërgatitur dhe avancuar një pushtim grek”

“Misionet britanike haptazi ndihmuan në evakuimin e minoritetit shqiptar; ai ishte një akt humanitar, për të parandaluar keqtrajtimin e tyre në Greqi”, raportoi oficeri lt. kolonel Deakin.

Gjatë vjeshtës së vitit 1944, një kapiten i ushtrisë britanike, Harlou, udhëtoi në jug të Shqipërisë për të mbledhur informacion në lidhje me shqetësimet për debimin e shqiptarëve nga Çamëria. Në datën 13 dhjetor 1944, komanda ushtarake e britanikëve në Bari të Italisë dërgoi drejt Londrës përfundimet dhe të dhënat e raportit të kapitenit britanik, të cilat më pas gjenden pothuajse në çdo raport zyrtar të tyre për marrëdhëniet shqiptaro-greke. Ky raport i dhjetorit 1944, duket se ishte mjaft i rëndësishëm për britanikët. [5]

Siç tregon ky raport, kapiteni Harloi udhëtoi në jug të Shqipërisë me një përkthyes që ai e vlerësoi si progrek. Ai kishte për qëllim të shikonte nga afër gjendjen e të larguarve shqiptarë nga Greqia, si dhe të hetonte akuzat e palës greke, sipas të cilave shqiptarët po keqtrajtonin minoritetin grek në Shqipëri. Të dhënat e këtij raporti janë mjaft interesante.

Kështu, kapiteni britanik raportoi edhe shifra reale të tragjedisë çame, duke i marrë nga terreni dhe informacionin që kishin mbledhur agjentët probritanikë. Sipas tij, ishin mbi 18 mijë

shqiptarë të larguar nga Greqia dhe kishin humbur jetën rreth 800 prej tyre.

“Shumë prej tyre janë lëvizur dhe i kanë çuar më në veri, madje edhe më larg Tiranës. Për shkak të situatës ekonomike, këta refugjatë po vdesin dita-ditës (me një kalkulum, mesatarisht vdesin 4 veta në ditë) dhe partizanët shqiptarë po konsiderojnë mundësinë për t’i detyruar ata t’i kthejnë edhe një herë në Greqi. Kur gjermanët u tërhoqën në muajin shtator, forcat e Zervës patën mundësinë të hakmerren në shkallë të gjerë, duke vrarë rreth 800 shqiptarë. Kjo shifër, rreth 800 vetë, është cituar nga shumë burime”, thuhet në raport, më 13 dhjetor 1944.

Ai shton më tej se minoriteti shqiptar nuk trajtohej mirë nga partizanët shqiptarë-komunistë, pasi i shihnin me dyshim. *“Është e mundshme që partizanët shqiptarë nuk kanë besim te minoriteti shqiptar i Greqisë, pasi kanë frikë se mes tyre ka shumë njerëz që janë progrekë dhe me këtë rast kanë penetruar në Shqipëri, me qëllim për të parapërgatitur dhe avancuar një pushtim grek”*, raportoi Harlou.

Kapiteni Harlou shënoi në raportin e tij se përkthyesi i tij ishte progrek, por ai nuk i gjeti dot asnjë shembull konkret dhe real të reprezaljeve që ishin akuzuar shqiptarët ndaj minoritetit grek që jeton në jug të Shqipërisë.

Gjithsesi, ai raportoi disa të dhëna interesante. Të rinj të minoritetit grek shkonin në Greqi për t’u bërë ushtarë të Zervës, personi që kreu masakrat ndaj shqiptarëve. Ushtaraku britanik raportoi se shumë prej tyre ishin nga radhët e partizanëve shqiptarë dhe, nisur nga ky fakt, shumë prej tyre u bënë shembull. Atyre iu dogj shtëpia nga partizanët shqiptarë, si paralajmërim dhe shenjë disipline. Sipas tij, në 3 muaj, rreth më shumë se 600 të rinj grekë shkuan në jug, kaluan kufirin dhe u bashkuan me forcat e Zervës në afërsi të Janinës.

Në lidhje me këtë çështje, kapiteni Harlou thotë se partizanët shqiptarë i cilësojnë si dezertime nga ushtria e tyre dhe sugjeron që këta të rinj e kanë justifikuar shkuarjen e tyre në Greqi, duke thënë se janë persekutuar. Nga këto ndëshkime, janë prekur rreth 250 familje të “dezertorëve” dhe partizanët përdorin një ndëshkim të njohur e të praktikuar nga të gjitha regjimet në Shqipëri ndër vite, siç është djegia e shtëpive dhe sekuestrimi i të gjithë mallit dhe pasurisë. Këto lloj reprezaljesh u ndërmorën në disa fshatra në jug, në linjën mes Sarandës, Delvinës dhe Gjirokastrës.

“Kryesisht janë 2 ose 3 raste për çdo fshat”, thuhet në raportin e tij. Kapiteni Harlou raportoi se nuk ka pasur prova që partizanë shqiptarë kanë prëzënë grekët për në veri të Greqisë.

NJË LOPË DHURATË PËR NËNAT, TAKSA SHITESË PËR BEQARËT

Në sistemin komunist, aborti ishte i paligjshëm. Ishte koha kur beqaria, paguhej me taksë, ndërsa nëna heroinë vlerësohej nga Partia. Ishte koha kur bëheshin mirë llogaritë e shtetit me trupin e tjetrit

| Nga LUELA MYFTARI

Vetëm nga rreth 200 dështime që janë bërë gjatë vitit 1978 në maternitetin e Tiranës mjaft gra janë bërë invalide ose vuajnë nga sëmundje gjinekologjike. Gjithashtu për çdo grua që ndërpret barrën, paafësia e përkohshme në punë është mesatarisht dhjetë ditë. Duke e llogaritur këtë me numrin e aborteve që janë bërë gjatë vitit 1976 në rang republike, i bie përafërsisht 149.300 ditë pune të humbura, e barabartë kjo me punën e një viti të një fabrike me afërsisht 500 punëtorë. Po t'i shtojmë kësaj shifre edhe shpenzimet e shtetit që bën gjatë kohës së shtrimit të grave në maternitet (45 lekë në ditë mesatarisht për çdo

grua), dëmet që i shkaktohen ekonomisë janë shumë të mëdha”.

Kjo është mënyra se si llogaritë e Partisë Komuniste në Shqipërinë e viteve '70 bëheshin për planifikimin familjar. Nuk kishte rëndësi nëse fëmija ishte pjesë e një abuzimi që do të duhej ta mbaje mend gjithë jetën, nuk kishte rëndësi nëse ishte gati apo jo, Enver Hoxha kishte thënë në Ksamil se “gruaja është një forcë e madhe që me mundin e saj revolucionar jep një kontribut të pamasë për ndërtimin e socializmit nëse do të lind shumë fëmijë”.

Ishte koha kur kontraceptivët ishin me numër dhe se të kishe njohuri për to ishte si të kishe një pasaportë e me të të kishe dalë jashtë shtetit. Ishte si të kishe kaluar kufijtë. Në një kohë, kur në botë njiheshim mjetet mbrojtëse kundrejt sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, në vendin tonë vajza dhe gra në emër të ruajtjes së nderit rrezikonin të humbnin edhe jetën duke shkatërruar një shtatëzani, fshehurazi, me shtizat e gjyshes apo me një dorë ilaçesh që me siguri do ta shkrumonin embrionin/fetusin. Ishte koha kur mamaitë në kushte shkandaloze, vdekjeprurëse, pa asnjë firmë, vulë apo përgjegjësi shuanin jo vetëm një jetë që po krijohet, por edhe jetën e vajzës që prante çdo kusht makabër për të hequr barrën.

Ishte koha kur gjininë e fëmijës së tyre nënat e mësonin në momentin e lindjes. Unë jam një nga ato fëmijë, kur nëna e re besonte çdo grua me

SHTATZANË APO ME BARRË? DËSHTIM APO ABORT?

Ato kanë dy konotacione të ndryshme si fjalë. Ashtu sikurse është vetë ndjesia kur diçka po ndryshon në jetën e një vajze. Besoj të gjithë e njohin një nënë që të thotë të vazhdojë shkollën se burri dhe fëmija aty janë. “Të gjithë kanë pjellë”, besoj se e dëgjojmë shpesh te nënat që besojnë se karriera është e rëndësishme në jetën e një vajze. Ashtu sikurse me siguri njihni dhe nëna që pyesin: “Po, he ç’pret, jepi, bëj një fëmijë tani” dhe këtë ia thonë jo vetëm vajzave të tyre, por edhe komshijeve. Nuk ka rëndësi çfarë të bën të lumtur, një nga nënat e lagjes do ketë gjithnjë diçka për të thënë. Por, çka duket më interesante edhe nga ana gjuhësore, linguistike janë edhe fjalët që përdorim për një shtatzani.

Sipas fjalorit të gjuhës shqipe gjejmë:

Shtatzënë (shtatzanë) mbiemër; emër i gjinisë femërore; edhe si emër; emër i gjinisë femërore; që është me barrë. Dhe sado të duash ta përkufizosh ndryshe këtë fjalë, shpjegimi që i bëhet është sërish me fjalën “barrë”. Nëse do të shohim fjalëformimin e njërës atë të fjalës shtatzanë, kupton se thekshe dhe bukur e shpjegojnë pritjen e ëmbël të një bebi me një togfjalësh që do të thotë se e ke shtatin të zanë. Dikur Edmond Tupja më kish thënë ta ndaja këtë fjalë njëlloj si shtojzovalle që ai e shpjegonte me shprehjen “Shtoji o Zot vallet”. Ndaj edhe shtazanë duhet të mos e ndaja “shtat i zan”, por “shtat si zan”. Sidoqoftë, kjo fjalë përdoret për më pozitivet e këtyre situatave.

Në herë të tjera kur fëmija është i paplanifikuar, një lajm i parpritur, një lajm i padëshiruar për momentin, një fëmijë jashtë martesë po vjen, e në disa situata të tjera abuzimi, zakonisht përdoret fjala me konotacion tjetër: “me barrë”. Këtë fjalë nuk ke pse ta ndash. E kryesisht këtë e kanë përdorur ato që nuk e shijojnë shtatzaninë si një pritje të ëmbël. Sepse fëmija jo për të gjithë është një ‘barrë’ që duhet ta mbash me vete. Me të njëjtin konotacion apo veshje negative vishte edhe fjala abort ndonjëherë duke u barazuar me fjalën dështim. Aborti nuk është një dështim në jetë, për disa është një fatkeqësi, për disa të tjerë një zgjedhje, por, aborti s’ka se si të jetë një dështim. Mirëpo, në shoqërinë shqiptare nëse nuk dëshiron të bësh fëmijë, do të duhet të përballësh me fjalën dështim, madje edhe nëse je në pritje të ndonjë lajmi të mirë, por gjërat nuk të shkojnë edhe aq mirë, përdoret fjala “dështim”. Por, sa kohë je vonë, o ke dështuar, o ke dështuar. Por aborti s’ka si të jetë i tillë, një dështim. Dhe besoj se nuk ka kuptim të sjell këtu një përkufizim të fjalës abort. Sepse në debatin e madh, nëse është zgjedhje apo një fatkeqësi, spontan apo i planifikuar e di se një vajzë detyrohet nga rrethanat ose kështu ia ka hedh ZOTI fatin dhe se veç ajo e di se ç’ndjen. Ndaj nuk gjej dot përkufizim për këtë fjalë. Kështu zgjedh të ndaj vetëm fjalinë që e dëgjoj shpesh nga familjarët dhe miqtë e mi: “Fëmija dhe dashuria për të, e mban këtë botë në këmbë”.

përvo-
jë në lindje,
teksta i thonte: “E ke
djalë, ndaj të pëlqejnë të
tharrrat” ose “ha ëmbëlsira,
ha se do bësh një vajzë të ëmbël”. Por, pa-
varësisht “ëmbëlsisë” së vajzës në familjen e
burrit ishte e privileguar nëse sillje një djalë, ndaj
të pëlqenin apo jo ëmbëlsirat, në sy të vjehrrës
mirë ishte të haje ato të tharrrat. Një shqetësim
që sot, nuk vishet me të tharrra a të ëmbla, por
me një pyetje të thjeshtë pas ekos: “Hë, a ishte
djalë”? Sepse ndonëse kohët kanë ndryshuar,
disa njerëz ende jo. Sot, me një eko zbulon shumë
më shpejt çfarë fëmije ke? Të mirë, të gjatë, të
pashëndetshëm. Vajzë apo djalë? Pyetje është kjo?
Pyetje është, pyetje që ende sot familje shqiptare
e bëjnë, pyetje që të çon drejt abortit selektiv.

Ndaj edhe mjekët vijnë ende t’i thonë “JO
ABORTIT”, sidomos kur ky është selektiv. Mi-
moza Keta është një nga ato doktoresha të vjetra
që nuk lodhet ta përsërisë këtë thirrje.

NDALOHEJ ABORTI, TURP EDHE TË FLISJE

Muri i Berlinit kishte rënë. Por, edhe në vitin 1990-1991, të flitej në ekran për një femër që kishte rënë shtatzënë pa qenë e martuar dhe aq më tepër pa e pasur një burrë përkrah, ishte akoma tabu. Besa Myftiu, një vajzë e re e guximshme shkroi një histori të tillë njerëzore, që ne e njohim sot si filmin "Unë e dua Erën". Këtë histori njerëzore që do të interpretohej nga Luiza Xhuvani dhe Ndrim Xhepa, nën drejtimin e regjisorit Mevlan Shanaj, shumë shqiptarë e panë si një film të guximshëm për të cilin do ta pyesja Besa Myftiun, në një nga vizitat e saj në Shqipëri. Sot, ajo i sheh si skena ku drama njerëzore nëpërmjet nostalgjisë dhe ëndrrës vjen e bëhet një zhanër tragjikomik. Mbyl mend që gjatë intervistës më tha: "Për mua ishte tragjik fakti që nuk lejoheshin mjetet mbrojtëse. Një femër atë kohë i duhej të rrezikonte për të mbijetuar. Aborti nuk ishte i ligjshëm. Një vajzë që mund t'i bënte një lëshim të dashurit të saj të zemrës gjendej papritur buzë vdekjes. Atë kohë dënoheshin të gjithë ata që sillnin kontraceptivë dhe mjete të tjera mbrojtëse nga jashtë. Më vjen mirë që e kemi kaluar këtë fazë. Një femër e lënë këshu në duart e fatit, në atë kohë kur nuk të dilnin paratë të rrisje dy fëmijë, duhet të ishte e detyruar të luftonte për të mos pasur një të tretë dhe të ndërmerre rrezikun për të lënë dy fëmijë të tjerë jetimë". Ajo më kujton se kur shkroi skenarin e filmit, jo pak herë ka dëgjuar t'ia përmendnin fjalën turp.

Më vonë, në Zvicër, në frengjisht Besa Myftiu shkroi edhe një libër tjetër që e titulloi "Drejt së pamundurës" ku përmes nëntë tregimeve, të ndara në tri pjesë ajo tregon si ndihet në femër shqiptare kur përballet me një botë më të hapur. Në pjesën e parë titulluar "Me syrin e një shqiptareje" trajtohet zbulimi i botës perëndimore. Pjesa e dytë që titullohet "Të shkuara të paharruara" trajton temën e seksualitetit në Shqipëri dhe fatin e gruas shqiptare. Ndërsa, pjesa e fundit titullohet "Histori dashurie". Të gjitha tregimet janë të inspiruara nga realiteti. Në një tregim të saj me titullin "Kurva", Besa shkruan: "Kurvat e kohës sime ishin të virgjëra, nuk kishin puthur asnjëherë ndonjë djalë dhe nuk dinin asgjë mbi seksualitetin".

mund të paraqiten shqetësime, ku mungesa e tyre zgjat 3-4 ditë, por ditën e katërt e të pestë shfaqen gjakosje të konsiderueshme, dhimbje të mprehta të barkut dhe temperaturë rreth 38 gradë celcius. Kjo gjendje nuk duhet të zgjasë më shumë se 24 orë, përndryshe gruaja duhet të paraqitet menjëherë te mjeku gjinekolog". Keta e vë theksin në të gjitha këto detaje përkujdesjeje, pasi kryesisht neglizhohen ato pas abortit, duke i dhënë rëndësi ndonjë ndjenje faji apo gjendjes

"Në vendin tonë vitet e fundit lindin më shumë djem sesa vajza. Këto rezultate i ka nxjerrë një studim në Francë, i cili ka konstatuar një ndryshim të konsiderueshëm në numrin e vajzave dhe djemve të lindur në Kaukaz dhe Ballkan. Raporti thekson se në disa pjesë të këtyre rajoneve evidentohen raste të shumta të aborteve selektive. Në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, Kosovën dhe Malin e Zi, raporti i lindjeve djem dhe vajza është në favor të djemve pasi ende ekziston aborti selektiv. Tani Shqipëria ka arritur nivelin 112-111 djem në 100 vajza", tregon Keta për abortin selektiv.

Për të njëjtet shqetësime është edhe kujdesi që duhet treguar kur zgjedh të kryesh një abort, ku me kë, çfarë metode zgjidhet dhe sigurisht kujdesi pas kësaj zgjedhjeje që në shumicën e rasteve nuk është e thjeshtë, pasi lë shenja psikologjike te ajo që për rrethana të ndryshme e ka zgjedhur abortin si zgjidhje. Kur e pyes për kujdesin pas një aborti Keta tregon: "Medikamentet që përdoren për anestezinë kanë efektet e tyre të dëmshme dhe rekomandohet që gruaja pas abortit të shoqërohet në shtëpi me automjet duke përjashtuar ecjen në këmbë. Për të qetësuar dhembjet, nuk duhet të përdoren analgjezikë si dhe nuk duhet të konsumohen pije alkoolike. Gjatë 10-të ditëve të para pas abortit, kur nuk paraqitet gjakosje e qafës së mitrës, rreziku i infeksionit është shumë i mundur. Për t'u ruajtur nga kjo situatë, është e këshillueshme moskryerja e raporteve seksuale. Rekomandohet përdorimi i pecetave higjienike njëpërdorimshme për mbrojtje nga ambienti i jashtëm, si dhe rekomandohet mospërdorimi i tamponëve vaginalë. Gjithashtu, pas abortit duhet shmangur dushi, sidomos dushi në vaskë me ujë të nxehtë apo ngrohtë.

Në disa raste ndodh, që të nesërmen e pas abortit të mos paraqiten gjakosje, dhimbje dhe temperatura të jetë normale. Në raste të tjera

psikologjike pasi gjithçka “ka mbaruar”. Sepse kryesisht vetëmohimi i asaj çka ka ndodhur është pjesë e abortit.

Nisur edhe nga fakti se aborti u kthye në një diskutim mbarëbotëror, nisur edhe nga fakti që të dhënat e nga Instituti i Statistikave në Shqipëri tregonin shifra të larta të abortit, ndërkohë që disa vende po i ndalojnë ato me ligj, vendosa të rikthehem pas në kohë, në Shqipërinë komuniste, kur aborti ishte i ndaluar dhe kur shumë vajza humbnin jetën apo të drejtën për t'u bërë nëna më vonë për shkak të abortit. Dhe shifrat ishin sërish të larta, përtej panoramës së bukur të lajmeve dhe fotografive të asaj kohe. Nga dokumentet që gjen në Arkivin Qendror Shtetëror sot, panorama është krejt ndryshe. Këtë dua të rrëfej sot përmes këtij shkrimi.

NËNAT HEROINA

Më 13 mars 1954, në cilësinë e Kryetarit të Presidiumit Popullor, Haxhi Lleshi i propozonte Enver Hoxhës krijimin e dy medaljeve “Hero i Punës Socialiste” dhe “Nënë Heroinë”. Në shkresën sekret Nr. 79 drejtuar Kryeministrit, Lleshi tregonte se medalja për “nënë” ishte mjaft e përhapur në Bashkimin Sovjetik. Ai propozonte që ky titull i duhej dhënë nënave që “kanë lindur, rritur dhe edukuar 10 fëmijë”. Por më interesante është mënyra se si përpigjet ta bindë Partinë me fjalitë optimiste si kjo: *“Duke pasur parasysh se në të ardhmen do të jetë më kollaj rritja e 10 fëmijëve, mbasi gjendja ekonomike do të përmirësohet vazhdimisht, mëtojmë se dhënëja e urdhërit “Nëna Heroinë” do të jetë me vend.”*

Dhe për një kohë të gjatë nënat u dekoruan me këtë titull. Tropoja është treva që mbante vemdin e parë të nënave heroinë. Para viteve '90. Gratë aty thyenin rekorde të lindjes së fëmijëve dhe duket sikur e bënin pa vështirësi këtë punë. Ndonjëherë nuk kishte nevojë të shkoje në spital, sidomos gratë në zona të izoluara nga bora apo në fshatra ku spitalet ishin larg. Ato ishin mësuar me 8 a 9 fëmijë. Të dhjetën fëmijë dinin ta bënin edhe vetë.

Duke kërkuar për nënat heroina, lexoj se vetëm në vitin 1988 e deri në vitin 1989, periudhë e përafërt me të cilën u lindi edhe unë, nëntë gra tropojane u shpallën “Heroina”, pasi lindën dhjetë fëmijë, një prej tyre madje dymbëdhjetë fëmijë. Lulë Muslia, Zade Haklaj, Neslie Gjura, Aishe Lamaj, Feride Hoxha, Zade Sulaj, Ajman Muhametaj, Cymë Sadikaj, dhe Mire Doshiani janë nënat “heroina” të atij viti.

Mirëpo, lufta ideologjike për të bindur gratë shqiptare që të lindnin sa më shumë fëmijë kishte nisur shumë më herët. Dhe një nga mënyrat ishte shpërblimi i tyre. Po si mund të shpërblehen nga shteti këto gra, kur vetë shteti është i varfër? Me këtë pyetje kishte marrë përgjigje një tjetër “urdhër” fantastik i asaj kohe. “Liria” paguhej shtrenjtë. Beqarët kishin taksa dhe ato shkonin për nënat heroina.

TAKSË PËR BEQARËT DHE VEJANET

Jeni 22 vjeç dhe akoma beqarë? Jeni 22 vjeç dhe e keni mendjen te karriera? Nuk keni menduar akoma për familjen? Epo duhet të paguani taksa. Dhe jo pak, por 3% deri në 4% të pagës suaj, apo të të ardhurave vjetore.


Me një dekret që mban datën 9 Shkurt të vitit 1951, qeveria komuniste e asaj kohe kishte vendosur tatim mbi beqarët. Nga dokumentet e publikuara së fundmi nga Arkivi Qendror Shtetëror, të detyruar për të paguar taksa në bazë të këtij vendimi ishin të gjithë beqarët, personat e ve pa fëmijë dhe të shkurorëzuarit pa fëmijë. Taksa fillonte nga mosha 20-vjeçare si për meshkujt, ashtu edhe për femrat. Dhe tekstualisht neni 1 dhe 2 i dedikohet beqarëve dhe personave të ve kështu:

“Neni 1

Të gjithë shtetasit beqarë, të vejët pa fëmijë dhe të çkurorëzuarit pa fëmijë detyrohen të paguajnë tatim sipas dispozitave të këtij dekreti.

Neni 2.

Tatimi mbi beqarët, të vejët pa fëmijë dhe të çkurorëzuarit pa fëmijë merret nga personat me moshë lart nga 20 vjeç deri 50 vjeç për meshkuj dhe lart nga 20 vjeç deri 40 për femrat. Tatimi fillon të paguhet nga 1 Janari pas vitit që pagëdhënësit kanë mbushur 20



Në Shqipërinë komuniste, numri i aborteve ishte i madh, por sa kohë diçka ndalohej, si aborti asokohe, numri është edhe më madh se sa deklarohet. Ndryshe nga sa panorama e asaj kohe tregon nënat me shumë fëmijë, dokumentet që kemi zbardhur sot tregojnë një tjetër histori

vjetët dhe pushon në mbarim të vitit kalendar në të cilin burrat mbushin 50 vjetet dhe gratë 40 vjetët”.

Tregtarët, zejtarët dhe profesionistët do të paguanin më shumë nga të gjithë, 4% mbi të ardhurat vjetore, nëpunësi 3% të këtyre të ardhurave, fshatarët vetëm 600 lekë në vit, ndërsa personat e tjerë 200 lekë në vit.

“Neni 6

Për gjithë punëtorët dhe nëpunësit, 3% mbi të ardhurat e tyre mujore.

Për tregtarët, zejtarët dhe profesionistët, 4% mbi të ardhurat vjetore.

Për fshatarët që paguajnë tatimin mbi ekonominë bujqësore dhe antarët e kooperativave bujqësore, 600 lekë në vit.

Për personat e tjerë 200 lekë në vit”.

Kështu nga pak Shqipëria shkoi në kushtet ku aborti ishte diçka e ndaluar. Të flitej, të diskutohej, të shkruaje për të ishte e ndaluar. Por kjo nuk e ndaloi fenomenin, madje më shumë shifra kemi nga ajo kohë.

RAPORTET PËR ABORTET

Në Shqipërinë komuniste, numri i aborteve ishte i madh, por sa kohë diçka ndalohej, si aborti asokohe, numri është edhe më madh se sa deklarohet. Ndryshe nga sa panorama e asaj kohe tregon nënat me shumë fëmijë, dokumentet që kemi zbardhur sot tregojnë një tjetër histori.

“Me gjithë punën intensive të bërë nga Partia dhe kujdesin e madh që tregohet për shëndetin e gruas, numri i aborteve është ende i madh. Madje po të krahasosh vitin 1976 me vitin 1978 numri i aborteve është rritur. Problemi mbetet akoma i mprehtë. Kështu në qoftë se në vitin 1976 si Republikë kishim një raport 5.4 lindje me një abort, në vitin 1978 ky raport u zvogëluar në 4.7

lindje me një abort. Pra numri i aborteve është rritur nga 14.109 në 14.933. Por, këto janë rastet e konfirmuara dhe të deklaruara. Besohet se numri është shumë më i madh. Në rrethin e Tiranës ky problem është mjaft shqetësues, raporti është gati 1 me 1, ndërsa Vlorë, Korçë dhe Fier afërsisht raporti është 4 me 1.” Kështu shkruhet në raportin e bërë gati nga Sektori Social në vitin 1979, ndërsa propozohet që të shtohet gama e sëmundjeve që lejojnë kryerjen e aborteve në mënyrë që këto të mos bëhen fshehurazi dhe të rrezikojnë jetën e vajzave dhe grave. Në këto raporte zbulon shumë, si për moshën e atyre që bëjnë abortet (25-29 vjeç atë kohë), për numrin e fëmijëve që donin (kryesisht 2 apo tre fëmijë ata që jetonin në qytet), por po ashtu edhe për abortin selektiv, që prej vitesh e trashëgojmë si një plagë që ende ndan një djalë dhe një vajzë që para lindjes...

Po, sot situata nuk është shumë ndryshe. Shqipëria është vendi me numrin më të lartë të aborteve në Rajon. Gati 26 mijë aborte janë kryer në vend në harkun e 5 viteve. Ky nivel është më i larti ndër vendet e Rajonit. Nga të dhënat rezulton se në vend, për çdo 1 mijë lindje ka 162 aborte, nivel ky më i lartë se Kosova, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut apo Serbia. Dëshira për të pasur djalë, mosha jo e përshtatshme dhe pasiguritë ekonomike janë ndër arsyet që po ushqejnë këtë fenomen. Dëshira për të pasur djalë apo mosha jo e përshtatshme nuk janë arsye të vetme të aborteve në shkallë të lartë në vend.

Referuar të dhënave nga Instituti i Statistikave, në harkun e viteve 5 viteve në vend janë kryer gati 26 mijë aborte, shifër gati e njëjtë me numrin total të bebeve të lindura në vitin 2021.


DEBATI QË NUK U SHUA KURRË

Aborti u legalizua në fillim të viteve '90 dhe rregullohet me një ligj të vitit 1995. Ndërprerjet e shtatzanisë lejohet të kryhen deri në javën e 12-të dhe pas kësaj kohe, vetëm në rastet kur një komision mjekësor vlerëson se shtatzania rrezikon jetën ose shëndetin e nënës. Por, në Shqipëri ka ende një debat për abortin selektiv, i cili është i paligjshëm dhe kryesisht realizohet pas javës së 16-të kur edhe dallohet gjinia e fetusit.

Mentaliteti patriarkal në Shqipëri e ka nxitur këtë abort, duke bërë që mjaft gra të bien pre e presionit të familjes së bashkëshortit, të shoqërisë dhe të kryejnë, në mënyrë të jashtëligjshme dhe të pasigurt ndërprerje shtatzanie në momentin që konstatohet se fetusit është i gjinisë femërore. Ka dy studime kombëtare nga organizata joqeveritare World Vision, nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë dhe Together For Life mbi abortin selektiv.

“Raporti i lindjes djem -vajza në Shqipëri është 112 meshkuj kundrejt 100 femrave, që do të thotë se raporti natyral meshkuj-femra duhet të jetë 105 me 100. Sipas studimit të UNFPA është një raport jo i drejtë, që tregon se për hir të paragjykimëve që ekzistojnë akoma ndodhin aborte selektive, pra përzgjidhet seksi para lindjes”.

Dhe më ironike është kur urimi që ke sjellë në jetë një vajzë të vjen si kartolinë me fjalët: “Tjetër herë me djalë”. Që veç urim për vajzën nuk është, e që padiskutim do të jetë refreni i një debati që duket se do të vijojë gjatë.



Think Luxury Say Prado

LIVADH, HIMARË



PRADO
LUXURY HOTEL

EVERY DETAIL AND MEMORABLE EXPERIENCE TELLS THE STORY
OF THE WARMTH AND SPIRIT OF OUR ICONIC ALBANIAN RIVIERA.

WWW.PRADORESORT.COM

📞 Contact us: +355 68 900 99 20

✉ E-mail: reservation@pradoresort.com

📷 [prado_luxury_hotel](https://www.instagram.com/prado_luxury_hotel)






VRASJA E 17-VJEÇARIT ALTIN BASHA DHE LINDJA E GERMANA-S NË AMBASADË

Nga AFRIM KRASNIQI

Deri më 1 korrik 1990 kishte rreth 60-70 qytetarë që kishin hyrë në ambasadat e ndryshme në Tiranë. Në total 16 qytetarë ishin larguar nga vendi me marrëveshje midis ambasadave dhe qeverisë shqiptare dhe rreth 20 të tjerë ishin në pritje. E vetmja ambasadë e njohur ku ende nuk kishte asnjë rast hyrjeje ishte ambasadat e RFGJ. Prej pak ditësh kishte nisur aktivitetin diplomatik në selinë e re tek rruga “Skënderbej”.

Më 1 korrik, rreth orës 23.00, pesë persona kapërcyen murin rrethues dhe hynë në oborrin e

DOSJA E AMBASADAVE 1990



jo tek autoritetet dhe aktet politike. Në përgjigje të këtij vendimi dhe qëndrimi, policia dhe Sigurimi u porositën që më 3 korrik hyrja për viza në ambasada të bëhej normalisht nga dera.

2 KORRIK - HYRJET NË AMBASADA DHE VRASJA E PARË NGA POLICIA

Disa orë pas këtyre takimeve më, 2 korrik 1990, situata u bë shpërthyesë. Ajo ka mbetur data simbol e hyrjes në ambasada për shkak të një numri të madh treguesish.

Treguesi kryesor ishte hyrja demonstrative me automjete në tri ambasada, në atë gjermane, italiane dhe turke. Autoritetet policore të kohës njoftonin se hyrja në ambasadën turk ndodhi në 7.15 me një makinë e plehrave të Ndërmarrjes Komunale ku ndodheshin 6 persona; hyrja në ambasadën italiane ndodhi rreth orës 11.50 po ashtu me 6 persona; si dhe hyrja në ambasadën gjermane ndodhi në mbrëmje vonë me një kamion ku ndodheshin 34 persona. Midis personave që hynë me automjete nuk kishte vetëm të rinj rebelë, por edhe familjarë e fëmijë, duke i dhënë jetë një dukurie të re proteste e emigrimi, atij familjar e kolektiv. Numri i qytetarëve në ambasadën gjermane arriti në 86 veta, ndërkohë që në të gjitha ambasadat e huaja numri ishte dy herë më i madh.

Treguesi i dytë i veçantë i 2 korrikut është bilanci dramatik i përlëshjeve midis policisë sekrete dhe qytetarëve. Asnjëherë më parë në historinë e Tiranës në periudhën komuniste nuk kishte kaq shumë qytetarë të mbledhur në një akt të qartë dhe me thirrje politike kundër regjimit dhe vendosmëri për t'u përballur me pasojat e brutalitetit të mundshëm policor.

Treguesi i tretë lidhet me përdorimin për herë të parë të armëve nga policia dhe Sigurimi. Një person u vra, e gjashtë të tjerë u plagosën. Ky bilanc, tërhoqi vëmendjen e të gjitha kancelarive dhe mediave kryesore perëndimore dhe për rrjedhojë, fenomeni i hyrjeve sporadike në ambasada u shndërrua në eksod masiv dhe krizë politike.

ambasadës. Ish-ambasadori gjerman në detyrë Eëner Daum kujton: “Më 1 korrik 1990 një makinë udhëtoi drejt ambasadës tonë, katër qytetarë kërcyen në oborrin e ambasadës, Sigurimi qëllloi dhe plagosi njërin prej tyre. Më 2 korrik ishin rreth 60-70 refugjatë në ambasada, tek greku, italian, francezi dhe tek ne...një makinë rrëzoi murin e ambasadës, prej saj vrapuan një grup refugjatësh. Sigurimi qëllloi, një mori plumba në bark e mushkëri, një polic me armë hyri brenda territorit të ambasadës. Në një demonstratë në rrugën e ambasadës u qëlluan me armë dy protestues, një shumë i plagosur u dërgua në spital. Sigurimi veprroi tani me një brutalitet të pabesueshëm, por qytetarët nuk lejuan të frikësohen”.

Me hyrjen në ambasadën e RFGJ, tanimë qytetarët ishin futur pothuaj në gjithë ambasadat evropiane në Tiranë dhe “vala e pushtimit” të ambasadave do të shndërrohej në një krizë politike me përmasa ndërkombëtare.

Referuar arkivave, paraditen e 2 korrikut, në Ministrinë e Jashtme u organizua një mbledhje e jashtëzakonshme. Ata nuk kishin pritshmëri për zhvillimet që ndodhën pasdite, ndaj preokupimi kryesor ishte e nesërmja, 3 korriku, kur çdo individ që kishte pasaportë mund të shkonte në ambasada për të aplikuar për vizë. MPJ thirri në zyrë ambasadorët e huaj për t'i vënë në dijeni se shtetasit shqiptarë do të ishin të lirë të venin në ambasadë për të marrë viza. Pritshmëria e MPJ dhe e MPB ishte se ky veprim do të ulte tensionet dhe nga ana tjetër do të mundësonte që shtetasit me pasaporta të fokusoheshin tek ambasadat në kërkim të vizës,

2 korriku u bë i rëndësishëm edhe për një sërë faktorësh të tjerë, përfshirë simbolikën e zhvillimeve në Kosovë, ku parlamenti i krijuar nga shqiptarët shpalli deklaratën e Pavarësisë.

Ish-drejtori i policisë, Dilaver Bengasi ka pranuar disa herë publikisht se më 2 korrik nxori pistoletën dhe qëlloi në ajër. Ai thotë se ky veprim e sprapsi turmën. Vrasja e një personi dhe plagosja e gjashtë qytetarëve të tjerë mbeti pa u hetuar, ndaj edhe vetë arma e përdorur nga drejtori i përgjithshëm i policisë nuk iu nënshtrua asnjëherë ekzaminimit hetimor. Përvec jehonës ndërkom-bëtare, vala e reagimit kritik u bë e fortë në kryeqytet, në Tiranë. Ramiz Alia, pesë ditë më vonë, në përpjekje për largimin e përgjegjësisë, u detyrua të shkarkojë Bengasin dhe e akuzoi se me veprimet e tij krijoi provokacione të rrezikshme. Në Plenumin e 11-të në një diskutim të brendshëm (jo publik) Alia konfirmoi se *“edhe në ngjarjet e ambasadave policia gaboi. Nuk duhej kurrësi të përdorej arma. Disa arsyetojnë se polici armën e përdori nga që u kërcënua. Nga kush u kërcënua? Ndofta ndokush nga turma qëllloi me tulla e gurë. Por kjo nuk e përligj përdorimin e armës nga polici. Veprime të tilla janë provokacione tepër të rrezikshme dhe të kërkueshme nga armiku”*. Akuza nuk ishte publike, por vetëm për përdorim të brendshëm.

BILANCI ZYRTAR, MBI 423 QYTETARË TË ARRESTUAR

Informacione të detajuara mbi bilancin e ndërhyrjes policore gjatë natës së

2 korrikut paraqet një relacian informues i drejtorit të Drejtorisë së Punëve të Brendshme Tiranë, Zef Loka, drejtuar Ministrit të Punëve të Brendshme. Sipas raportit *“pasditen e datës*

2 korrik 1990 elementë armiq e keqbërës të organizuar hidhnin parulla të karakterit kundërrevolucionar dhe ndërmorën veprime konkrete hakmarrëse ndaj punonjësve të organeve të Punëve të Brendshme që kryenin detyrën në territorin e ambasadave dhe atyre të rendit. Në këtë kohë disa nga këta elementë hynë në ambasadat e huaja, por pas pak gjendja u parandalua mbasi në ndihmë të shërbimeve erdhën përforcime”. Termi *“parandalim”* nuk nënkuptonte përlëshje midis policisë dhe qytetarëve, por vijimi i relacionit e provon këtë. Loka informonte se ishin arrestuar 74 qytetarë. Nga këta, 12 qytetarë ishin të moshës deri 20 vjeç, 33 qytetarë të moshës 21-25 vjeç, 19 qytetarë të moshës 26-30 vjeç, 10 qytetarë të moshës 31-40 vjeç. Lidhur me arsimin dhe punësimin, sipas relacionit, 2 qytetarë kishin arsim të lartë, 57 ishin në marrëdhënie pune dhe 17 ishin të papunë. Lidhur me banimin, 59 ishin banorë të qytetit Tiranë, 10 ishin nga fshatrat e Tiranës dhe 5 qytetarë vinin



kerkueshme nga
publike, por vetëm

mbi bilancin
të natës së

SECRET
Tiranë, më 2.8.1990

RELACIONI I TITUT DHE I TË TITUTIT DHE
TË ARRESTUARIT
DATE 2.8.1990

NR.	EMRI	TË KALUAR GJATËS	TË ARRESTUAR GJATËS	TË PAMUNDIT DËSHUAR NË GJYK										TOTAL	TË ARRESTUAR
				1	2	3	4	5	6	7	8	9	10		
1.	YFIRI	100	65	64	44	34	2	4	0	0	0	0	0	0	0
2.	YFIRI	71	30	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3.	PIRE	60	22	17	25	17	0	0	0	0	0	0	0	0	0
4.	QREKUR	60	44	31	28	31	0	1	1	10	0	0	0	0	0
5.	QREKUR	33	22	13	11	11	0	0	0	0	0	0	0	0	0
6.	QREKUR	23	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
7.	QREKUR	23	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
8.	QREKUR	16	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
9.	QREKUR	10	16	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
10.	QREKUR	19	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
11.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
13.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
14.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
15.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
16.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
17.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
18.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
19.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
20.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
21.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
22.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
23.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
24.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
25.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
26.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
27.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
28.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
29.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
30.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
31.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
32.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
33.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
34.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
35.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
36.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
37.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
38.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
39.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
40.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
41.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
42.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
43.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
44.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
45.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
46.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
47.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
48.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
49.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
50.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
51.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
52.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
53.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
54.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
55.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
56.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
57.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
58.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
59.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
60.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
61.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
62.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
63.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
64.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
65.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
66.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
67.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
68.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
69.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
70.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
71.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
72.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
73.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
74.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
75.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
76.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
77.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
78.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
79.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
80.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
81.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
82.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
83.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
84.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
85.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
86.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
87.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
88.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
89.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
90.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
91.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
92.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
93.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
94.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
95.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
96.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
97.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
98.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
99.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
100.	QREKUR	15	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0



PAGUAJ **SI YLL**

Me CREDINS Online

- ✓ PAGUAJ FATURAT UTILITARE
- ✓ APLIKO PËR KREDI
- ✓ KONTROLLO GJENDJEN BANKARE
- ✓ HAP LLOGARI
- ✓ TRANSFERO PARA



NUMRI I QYTETARËVE QË U LARGUAN PËRMES AMBASADAVE NË KORRIK 1990

SIPAS AMBASADAVE	Burimi: MPJ	Burimi: MPB	Burimi: AIDSSH
Në ambasadën e RF gjermane	3163	3172	3123
Në ambasadën italiane	816	809	803
Në ambasadën franceze	549	547	551
Në ambasadën turke	77	73	59
Në ambasadën polake	52	52	57
Në ambasadën çekoslovake	51	51	51
Në ambasadën hungareze	39	40	39
Në ambasadën greke	31	29	28
Në ambasadën jugosllave	6	6	6
Në ambasadën egjiptiane	6	6	5
Në ambasadën bullgare	5	5	5
TOTAL	4795	4790	4727

nga rrethet. Midis banorëve të Tiranës, 30 prej tyre ishin nga zona e Kombinatit të Tekstileve "Stalin" në Tiranë. Gjithashtu ai pranon se 310 qytetarë "janë thirrur e paralajmëruar për këto tendenca në rajonet e policisë". Bazuar vetëm në këtë informacion zyrtar të MPB rezultoi se kemi 310 persona të thirrur në rajonet e policisë për këshillim, 91 ndodheshin të arrestuar, 22 të ndaluar të tjerë për verifikim, pra në total 423 qytetarë. Kjo ishte shifra më e lartë e personave të arrestuar në një ngjarje nga policia e Tiranës dhe Sigurimi në të gjithë historinë saj pas viteve '50. Cili ishte krimi i tyre? Kanë tentuar të grumbullohen pranë zonave të ambasadave, kanë lëshuar thirrje politike dhe kanë shprehur synimin për t'u arratisur nga vendi. Secila prej këtyre akteve

nuk ndalohej më nga legislacioni në fuqi, pas ndryshimit të Kodit Penal në maj 1990. Numri kaq i madh i arrestimeve është tregues i qartë i klimës së 2 korrikut në Tiranë e vitit 1990, ndërsa policia dhe ushtria arrestonin, rrihin dhe keqtrajtonin edhe në rrugët e kryeqytetit këdo që e supozonin "të dyshuar".

NJOFTIMI I "ZËRIT TË POPULLIT"

Shifrat e ndalimeve dhe raprezaljes nuk u bënë ndonjëherë publike për qytetarët. Gazeta zyrtare e PPSH, "Zëri i Popullit" më 3 korrik 1990 dha vetëm njoftimin e mëposhtëm: "në mbrëmje të datës 2 korrik në Tiranë, rreth orës 22:00, një grup vagabondësh, ish-të burgosur për faje të vogla ordinere si vjedhje, llotarira klandestine, kumar, si dhe disa adoleshentë të mashtruar, kërkuar të hyjnë forcërisht në një ambasadë të huaj, duke goditur me gurë, tulla e mjete të tjera forcat e rendit. Në mbështetje të kësaj mase u grumbulluan edhe familjarët e tyre, që krijuan një gjendje alarmuese, duke ndaluar qarkullimin në rrugë të qytetarëve, duke hedhur gurë mbi personat zyrtarë e popullin që kishte dalë për të mbrojtur rendin, duke thyer xhamat e disa dyqaneve e duke bërë zhurmë". "Zëri i Popullit" citon se turma përbëhej nga 300-400 persona.

MUSTAFARAJ URDHËROI ARRESTIMET MASIVE NË TIRANË?

Ish-kreu i Hetuesisë Qemal Lame, që ishte prezent, kujton se "erdhën forcat speciale të repartit 326 dhe filluan të goda-





NDARJA E QYTETARËVE NË AMBASADA SIPAS MOSHËS



sin personat që ishin ulur në trotualet tek rruga e Kavajës”. Më pas ai konfirmon se “zv/ministri i Brendshëm Mustafaraj dha urdhër për arrestime masive të demonstruesve”, por kur doli urdhri, nuk kishte më njerëz tek ambasadat, ndaj “atëherë policia nisi të ndalojë autobusët dhe të ndalojë persona që supozohej se kanë qenë në protestë, sampistët kapnin çdo person të parruar ose me flokë të gjatë dhe me dhunë e ulnin nga autobusët”. Sa i përket dhunës së ushtruar, ai shton “disa që kundërshtojnë, jo vetëm që i godisin, por i kapnin njësoj si bagëtitë, duke i ngritur lart, horizontalisht me tokën dhe i përplasnin me forcë në asfaltin e rrugës ose në pllakat e trotuareve, pastaj i hipnin në makina dhe i dërgonin për t’i ndaluar në dhomat e izolimit” dhe se “rreth orës 24.00 përfundoi kjo masakër”.

Një detaj me rëndësi treguar nga Qemal Lame (Ish-kryehetues) ishte vizita e tij me ministrat Isai dhe Stefani në rajonin numër 1 të policisë ku ishin ndaluar 100 vetë. Sipas Lames, Hekuran Isai me detyrë Sekretar i Komitetit Qendror dhe anëtar i Byrosë Politike, kapi prej flokësh dhe keqtrajtonte personat e ndaluar. Në fund, dha urdhër të qetheshin të gjithë, - një formë poshtërimi që policia e vitit 1990 përdorte ndaj të rinjve në qytetet kryesore. Të nesërmen ai kujton se u paraqitën vendimet e ndalimit për 94

persona. Të gjithë e kishin kokën të zeruar nga flokët.

BASHKËSHORTJA E AMBASADORIT ITALIAN MBANTE DITAR

Annarosa Mannetti, bashkëshortja e ish-ambasadorit italian në Tiranë në 1990, ka mbajtur ditar për ato ditë të ethshme të qëndrimit të saj në Shqipëri. Në fletët e ditarit të saj, për 2 korrikun, pasi përshkruhen skenat e dhunës brutale të policisë, ajo shkruan: “Jemi vërtet të rrethuar nga vrasës! Të paktën ishim dëshmitarë okularë të sjelljes së tyre kriminale dhe gjithashtu edhe kolegët tanë francezë në ndërtesën përballë, që dëgjuan britmat. Mund t’i denoncojmë përpara opinionit publik botëror. Duhet të gjejmë një mënyrë për ta bërë të ditur sa më shpejt të jetë e mundur, që qeveritë e vendeve të përfshira, bashkë me tonën, t’i japin fund heshtjes “diplomatike” për atë që po ndodh në Tiranë”. Gazeta gjermane “Die Zeit” komentoi se “ashpërsia me të

cilën forcat e sigurisë reagues ndaj qytetarëve që kërkuar azil në ambasadat e huaja hedh dyshime të forta mbi dëshirën e shefit të shtetit e të partisë, Ramiz Alia, për të bërë përpara me reforma”. Raporti amerikan mbi të drejtat e njeriut 1990 ndonëse theksoi se nuk ka evidencë për vrasje politike gjatë vitit 1990 në Shqipëri, raportoi se “në demonstratat dhe protestat kundër kushteve të përgjithshme të jetesës në fundin e qershorit dhe fillimin e korrikut 1990 në Tiranë, organet e sigurisë përdorën forcën përfshirë armët e zjarrit për të shtypur demonstratat dhe për të shpërndarë turmat”.

QEVERIA VONON 2 DITË REAGIMIN ZYRTAR

E ndërsa komuniteti ndërkombëtar vëzhgonte, dhe sapo kishte filluar deklaratat e para, në 4 korrik, qeveria shqiptare del me deklaratë zyrtare për ngjarjet. Në 4 korrik, deklarata u shpërnda nga Ministria e Jashtme në gjuhën franceze tek të gjitha ambasadat e huaja.

“Në mbrëmjen e datës 2 korrik, rreth orës 22.00 përsëri një grup vagabondësh, kryesisht ish të burgosur për vjedhje e faje të tjera ordinere, si dhe disa adoleshentë të gënjyer kërkuar të hyjnë forcërisht në ambasadën e RFGJ, duke fyer, sharë e goditur me gurë e mjete të tjera mbrojtësit e rendit publik. Ky grup vagabondësh dhe huliganësh, i mbështetur edhe nga pjesëtarë

të familjeve të tyre, ndërpreu trafikun dhe kalimin e lirë të qytetarëve, ofendoi personat zyrtarë, lëshoi britma, qëllloi me gurë ruajtësit e rendit publik duke thyer xhamat e dyqaneve dhe llambat e ndriçimit rrugor, u përpoq të krijonte një situatë të turbullt e alarmuese”.

Deklarata e MPJ thekson më tej se “pas ndërhyrjes së forcave të rendit dhe qytetarëve të tjerë të kryeqytetit situata u qetësua menjëherë, prishësit e rregullit u shpërndanë, ndërsa huliganët u mbajtën nga policia për të kryer veprimet e nevojshme konform ligjit. Siç është njoftuar edhe nga shtypi ynë, agresiviteti i huliganëve u bë shkak që të ketë edhe të plagosur lehtë nga të dy palët”.

Deklarata e MPJ dukej më e ashpër sesa e Hetuesisë dhe organeve të tjera. Kishte disa elementë të rinj, si p.sh, se grupi “i vagabondëve dhe huliganëve” është mbështetur nga pjesëtarë të familjeve të tyre, që konfirmon prezencën e familjeve. MPJ nuk tregon askund se u hodhën deklarata politike, por “lëshoi britma” dhe i akuzon ata se kanë ofenduar persona zyrtarë, apo kanë bllokuar trafikun, në Tiranën e vitit 1990, ku nuk kishte asnjë automjet privat. Elementi i tretë me rëndësi është citimi se ndërhyja është bërë nga policia dhe qytetarët e tjerë, duke nënkuptuar forcat rezerviste të thirrura nga Sigurimi dhe të sjella edhe nga organizatat e masave. Elementi i fundit është se ka pasur të plagosur lehtë nga të dyja palët, kur në realitet së paku një 17 vjeçar vdiq dhe vetë MPJ pretendoi se edhe një polic ishte një gjendje të rëndë, pretendim që nuk u faktua asnjëherë.

Në kujtimet e tij ish-kryehetuesi Qemal Lame nxjerr edhe një detaj tjetër për viktimat e 2 korrikut. Ai konfirmon se edhe një qytetar tjetër, P.Mancaku u vra “barbarisht nga policia, para derës së shtëpisë së tij, për shkak të kundërshtimit të veprimeve të policisë për të kryer një verifikim në banesën e tij.

MBLEDHJA E PANJOHUR:

SHTAB LUFTE KUNDËR REFUGJATËVE

Qemal Lame në kujtimet e tij u kthehet mbledhjeve të rëndësishme të 6 korrikut, në orën 18.00 në Komitetin e Partisë së Tiranës dhe më pas në ora 23.00 në zyrën e Ministrit të Brendshëm, ku merrnin pjesë zyrtarët më të lartë të kohës nga të gjitha institucionet.

Në mbledhjen e orës 18.00 në emër të udhëheqjes, Hekuran Isai, Sekretari i Komitetit Qendror, shpalli një plan masash emergjente.

U shpall vendimi që:

- të mos lejohet asnjë përqendrim qytetarësh përpara ambasadave;
- të arrestohen dhe të dërgohen në hetuesi individët që dalin nga ambasadat dhe marrin ushqime për të furnizuar shokët e tyre;
- të nxiten dhe lejohen familjarët që duan t’u bëjnë thirrje të afërmve të tyre për të dalë nga ambasadat;
- të ndërhyjë me forcë policia kur ka re-



zistencë nga personat që janë në afërsi të ambasadave apo grumbullime të paligjshme;

- jashtë ambasadave të qëllohet me armë nga policia nëse e konsideron të domosdoshme; të spastrohen rrugët kryesore afër ambasadave;

- policët dhe ushtarët të përdorin shkopinj të gomës ndaj cilido që afrohet ose dyshohet në zonë;

- të spastrohet Tirana nga ata që duan të



hyjnë në ambasada duke krijuar filtra kontrolli në automjetet që vijnë në Tiranë dhe tek stacioni i trenit.

Në takimin e mbrëmjes vonë në Ministrinë e Brendshme, me krerët kryesore të qeverisë e shtetit u krijua shtabi i luftës kundër situatës së krijuar. Ky shtab funksionoi rregullisht deri në shtator 1990, duke u mbledhur edhe 2-3 herë në ditë. Nga dokumentacioni i MPJ rezulton se shtabi u bë me urdhër të R. Alisë duke përdorur tone kritike dhe krahasime të tilla si “Genscher e krijoi shtabin menjëherë kurse pala jonë ende nuk ka një strukturë të tillë”.


Hekuran Isai deklaroi se “*jemi mbledhur me porosi të shokut Ramiz. Ne që jemi këtu jemi caktuar si shtab i luftës kundër situatës së tanishme. Është vendosur të kemi të gjitha kompetencat e nevojshme për të ndërhyrë e për të vendosur për çdo problem, që del dhe për çdo masë që duhet marrë në vend. Situatën serioze në ambasada dhe gjendjen e krijuar*

duhet ta stabilizojmë sa më parë. Kërkohet të rivendosim rendin dhe qetësinë në Tiranë dhe në gjithë vendin”.

DEBATI MBI VRASJEN (VRASJET) ENIGMATIKE TË KORRIKUT 1990

17 vjeçari Altin Basha, sapo kishte përfunduar vitin e dytë në shkollën e mesme industriale në Tiranë, ishte viktima e vetme zyrtare e vrasjes nga policia më 2 korrik 1990. Ai u plagos me armë mbrëmjen e datës 2, ndërkohë që ndodhej brenda ambasadës gjermane dhe vdiq në spital nga plagët më 4 korrik 1990. Punonjësi i sigurisë i Ambasadës Lothar Parzeller, i ndodhur në ato momente në ambasadë, e përshkruan kështu ngjarjen në dëshminë e tij. “*Nuk arrinim të shihnim ata që qëlloheshin para se të hynin përmes të çarës në territorin që i përkiste ambasadës sonë. Më kujtohet një djalë i ri që sapo kaloi të çarën u rrëzua. Nuk merrte dot frymë dhe ishte zbardhur, bërë si mehit në fytyrë. I hoqëm rrobat. Pamë se kishte dy vrima, një në anën e majtë të kraharorit, tjetrën në të djathtë. Bashkë me një polic të ambasadës e çuam në spital, në kirurgji.*

Mjekut i thamë që është nën kujdesin tonë. Ai e futi urgjentisht në sallë. Ne prisnim pas derës. Në një moment të caktuar në spital vijnë njerëzit e Sigurimit. Donin të hynin tek salla e operacionit dhe ta merrnin djalin. E vetmja armë që kishim ishte pasaporta diplomatike që e kishim marrë me vete. U thamë sigurimsave “ju nuk mund të hyni këtu”, duke u tundur pasaportat tona në fytyrë. Ndenjëm pa lëvizur për 48 orë para sallës së reanimacioni, kishim uri, etje por nuk lëvizëm. Pastaj erdhi një urdhër me radiomarrës që të ktheheshin në ambasadë. Sigurimi kishte bërë me dije se nuk do të merrej më parasysh pasaporta diplomatike dhe nëse nuk largoheshim do të shpallehim “persona non grata”. U kthyem në ambasadë ku na prisnin të plagosur të tjerë. Më vonë, nga një doktor ku-



banez, që ndodhej në spital morëm vesh që Sigurimi e kishte marrë nga reanimacioni dhe nxjerrë në pavijon. Më erdhi shumë keq, kur mora vesh që kishte vdekur”.

Autoritetet policore të kohës asnjëherë nuk pranuan vrasjen nga policia të 17 vjeçarit. Ata nuk ofruan variant alternativ, por e trajtuan vrasjen e tij si ngjarje të mistershme, duke aluduar kalimin e përgjegjësisë tek pala gjermane. Dosja e të vrarit në ambasadën gjermane u rihap politikisht në takimin që Ramiz Alia zhvilloi me disa intelektualë të përzgjedhur më 10 gusht 1990. Në këtë takim Alia reagoi thënë “Çfarë t’i bënim ne? Hero ta bënim këtë njeri që po hyn në ambasadë e po arratiset? Çfarë kërkon më tepër? Ne deklaruar që është plagosur. Pikë. Çfarë t’i themi më tepër? Ngushëllime t’i themi familjes së tij? Këtë kërkojmë ne? Kjo nuk është korrekte. Po pse nuk thotë anën e kundërt? Se ai njeri, se ajo makinë sulmoi policin, aty. Gjermani vetë që ishte, vajti dhe i ra policit me hekur kokës... Tani çfarë t’i bëj kësaj unë në gazetë? T’i qaj hallin atij policit, atij djalit?”.

Lidhur me bilancin e vrasjeve më 1-2 korrik 1990 ka pasur raportime dhe referime të debatueshme, pa pasur asnjëherë një bilanc të pranuar. Raportimet e mediave perëndimore fillimisht flisnin për një numër të vrarësh nga 4 në 50. Për shembull, “La Repubblica” njoftoi se së paku dy qytetarë u vranë më 2 korrik, media austriake njoftoi se njëri prej dy personave që nxori përjashta ambasada e Kubës kreu vetëvrasje në burg, gazeta gjermane “Die Zeit” raporti se “në trazirat në Tiranë thuhet se janë plagosur shumë njerëz, madje flitet se ka pasur edhe 4 të vrarë”, të tjera duke iu referuar diplomatëve të RFGJ shkruan “anëtarët e shërbimit të sigurimit shqiptar, “Sigurimi”, me brutalitet ekstrem kanë shtirë kundër shqiptarëve, të cilët u përpogën të futeshin në ambasadë”. Për të gjitha rastet, dyshimet dhe raportimet, si pas 14 korrikut 1990 dhe edhe më tej pas ndryshimit të sistemit politik nuk pati nisma për hetime ose komision të posaçëm për rastin e personave të vrarë, plagosur apo zhdukur në ngjarjet e ambasadave.

KUSH U LARGUA NGA SHQIPËRIA

Statistikat zyrtare treguan se numri i personave me arsim të lartë në ambasada ishte i vogël në raport me numrin total të refugjatëve, rreth 123-133 persona dhe 59-60 studentë në universitet. Debati mbi cilësinë dhe formimin arsimor të qytetarëve që hynë në ambasada shpesh ka lënë në hije aktin e tyre, i cili pavarësisht moshës, formimit dhe biografisë politike, ishte akt heroik për kohën dhe për riskun me të cilin përballej.

AMBASADAT	Hyrja në autobus	Nisja nga Tirana	Mbërritja
Ambasada franceze	22.30	23.00	24.15
Amb. Gjer. I (10 autobusë)	23.00	24.00	01.15
Amb. Gjer. II (12 autobusë)	24.00	01.00	02.15
Amb. Gjer. III (11 autobusë)	01.00	02.00	03.15
Amb. Italiane (9 autobusë)	02.00	03.00	04.15

Shënim: Në autobusin e parë të jenë gratë, të sëmurët dhe të dëmtuarit



Madje krijohet perceptimi sikur duhet të merret e mirëqenë pritshmëria për intelektualë në ambasada. Referuar përvojave të njëjta në Hungari e Çekosllovakia më 1989, apo situatave të tilla në Amerikanë Latine, me përjashtim të emigrimit masiv të opozitës pas marrjes së pushtetit nga Pinoçeti, nuk ka pasur raste të tjera kur eksodi përmes ambasadave dhe kufirit të ketë pasur protagonistë intelektualë dhe figura të njohur publike e politike. Dominimi i shtresës së mesme, punëtorë dhe të rinj, në kategoritë e personave që hynë në ambasada ka përputhje me vetë logjikën klasore të diktaturës dhe regjimit komunist.

RAST UNIK: DISA GRA SHTATZËNA, NË AMBASADËN GJERMANE LIND NJË VAJZË

Një detaj që lidhet me lindjen në ambasadën gjermane është edhe emri i vajzës. Ambasadori Daum e quan “Germana”, dhe ky emër është përdorur në disa raportime e botime lidhur me korrikun 1990. Në listën zyrtare të MPJ për personat që u larguan drejt Gjermanisë është shënuar emri “Patricia Shkëlqim Maloku”, emër që përputhet me notën e ambasadës, drejtuar MPJ-së. Lindja e një vajze në ambasadën gjermane nuk ishte e vetmja. Një grua tjetër shtatzënë dështoi në lindje në ambasadën franceze, ndërkohë që katër gra të tjera shtatzëna ishin pjesë e kontingjentit të refugjatëve që u larguan përmes ambasadave. E dhëna u konfirmua nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar,



EMRAT E ANIJEVE	ANIJET	KOHA NË DOK
I - Orient Star	Francë - 550	23.00
II - Grecia	RFGJ - 945+35	24.00
III - APPIA	RFGJ - 1130+36	01.30
IV - Cephallonia Sky	RFGJ - 1000+35	02.30
V - IONES	Itali - 900 (800)	03.30
	Greqi - 829	03.30



sipas të cilit, “në mesin e refugjatëve gjendeshin edhe 3-4 gra shtatzëna, ndaj në Brindisi u sollën në gatishmëri disa specialistë gjinekologe.

EPILOGU?

Ngjarjet e ambasadave ose “pushtimi i ambasadave” ndikuan edhe në disa ndryshime në sjelljen politike të Tiranës, sidomos në periudhën e

vjeshtës 1990. Në nëntor regjimi pranoi rishikimin e Kushtetutës në funksion të përshtatjes së saj me rrethanat e reja politike, ku ndryshimet më të rëndësishme ishin rivlerësimi i rolit udhëheqës të Partisë në shtet e shoqëri, si dhe heqja e pengesave kushtetuese për kredi e marrëveshje ekonomike me jashtë. Fakti që një pjesë e këtyre masave është e lidhur me ngjarjet e ambasadave provohet nga procesverbalet e debatit, ku shpeshherë citohen presionet politike të korrikut dhe pakënaqësitë e kërkesat qytetare për ndryshime.

Në vitet pasuese të gjithë aktorët politikë, shtetërorë e publikë të përfshirë në ngjarjet e ambasadave e revizionuan pozicionin dhe pikëpamjen e tyre. Vetë Alia 3 vjet më vonë ndryshoi qëndrim, duke theksuar se “*eksodi i dy korrikut për mendimin tim qe tentimi i parë i hapur i rinisë drejt Europës, një tentim dramatik dhe i dhimbshëm. Vërshimi në ambasada u duk si një zgjidhje më e realizueshme për daljen në botë, sidomos pas rrëzimit të Murit të Berlinit*”.

Shumica absolute e atyre që u larguan përmes ambasadave në korrik 1990 apo kaluan klonin kufitar gjatë atij viti nuk arritën në tri dekada të krijojnë zë publik dhe të bëhen faktorë referimi. Dëshmitë e tyre, kryesisht në raste përvjetorësh, në tërësi kufizohen në përjetime personale, në evokim të njohjeve e detajeve të kohës, të cilat kanë vlerë modeste dokumentare. Akti i tyre dhe sidomos impakti që ai pati në historinë e re të Shqipërisë është shumë më i madh sesa dëshmitë e rrëfyera. Eksodi i korrikut u pasua nga valë të reja eksodi në janar, mars e gusht 1991, në pranverën e vitit 1997 dhe në vitet pasuese. Asnjë prej tyre nuk ka tiparet, rëndësinë, natyrën dhe impaktin që pati korriku 1990. Ekdosi i korrikut nuk ishte ikje nga regjimi, por fillimi i fundit të ikjes së vetë regjimit.

(Marrë nga libri “KRIZA E AMBASADAVE: SHQIPËRIA 1990 “ i autorit, Afrim Krasniqi, drejtor i Institutit të Historisë në Tiranë)



MODA

NË SHQIPËRI

Nga **ERGYS ALUSHI**

Marigo Posio, për të gjithë shqiptarët, njihet si grua që përgjatë gjithë natës qëndisi Flamurin e Pavarësisë, që u ngrit në ballkonin e shtëpisë së Vlorës nga Ismail Qemali.

Do të ishte i pakët ky profil për Marigo Posion. Sepse, karakteristika e saj mbetet e paplotësuar po të mos i jepet merita e madhe e publikimit të gazetës së parë për gruan shqiptare. Në Vlorë, në 6 shkurt 1921, për komunitetin vlonjat të kohës, me mentalitet ende të prapambetur, dalja e një gazete për gruan ishte një risi.

“Shpresa kombëtare” ishte titulli i gazetës që u publikua në 12 numra. Në faqet e saj zinte vend emancipimi i gruas shqiptare dhe roli që duhet të merrte në shoqëri. “Lypset kujdesim për femëra”, “Ligje për të mbrojtur të drejtat e gruas”, “Vajza në familjen e saj”, ishin disa prej titujve në ballinën e kësaj gazete.

Ndër të tjera, në shkrimet e gazetës jepeshin këshilla edhe për veshjen e vajzave e grave, të cilat duhet të ishin kombinime të thjeshta e të hijshme, të ndryshme veshjet për në shtëpi e jashtë saj.

Për herë të parë në Shqipëri, një gazetë jo vetëm femërore, por edhe një gazetë që guxonte e fliste për femrën.

RROBAQEPËSI, SALLONE BUKURIE E DERI FILMAT, NË SHËRBIM TË MODËS!

Në fillimin e viteve 30-të të shekullit të 19-të, në qytetet kryesore të vendit pati një shtim të numrit të rrobaqepësive të hapura. Rrobaqepës burra e gra, qepnin veshje të ndryshme me copa nga më të mirat, të cilat në pjesën më të madhe të tyre vinin nga jashtë shtetit. Dyqanet e pakta me veshje të gatshme, ndikonin në rritjen e

NGA STILISTJA ITALIANE
PARA LUFTËS,
TEK **VESHJET**
E DOKUT
TË SOCIALIZMIT

Nga koha kur njeriu mësoi të ndizte zjarrin me strall dhe me këtë të fundit të përgatiste veglat e punës të gjahut, apo të gdhendte momente të jetës në gur, deri në ditët e sotme, arti njohu një zhvillim të madh deri në përsosje duke lënë shembuj kuptimplotë në gur, bronx, mermer e baltë të pjekur.

Si figurë e vyer, gruaja la gjurmët e saj, fizionominë e saj, në momentet e lashtësisë, errësirën e mesjetës për të arritur në kohët për ta parë veten të skalitur bukur, të veshur e stolisur bukur, në punë e në jetë. Moda ndryshonte sipas kohëve. Në Tiranë kanë ardhur stilistë me famë botërore para Luftës, por pas asaj, Ndërmarrjet e Prodhimit të Veshjeve, ishin të vetmet institucione që sugjeronin sesi duhet të visheshin vajzat e gratë shqiptare

numrit të rrobaqepësive, nisur dhe nga kërkesat e shumta të njerëzve, të cilët donin të visheshin sipas masës së tyre të trupit dhe shijeve të veçanta. Kërkesat ishin sipas modës së fundit që shihnin nëpër filma apo revista të ndryshme që shiteshin në Tiranë. Rrobaqepësitë më të njohura ishin në Tiranë, Vlorë, Durrës, Korçë, Shkodër. Pronarët e tyre ishin aq aktiv në biznesin e tyre sa që i kushtonin rëndësi të madhe dhe paguanin konsiderueshëm për reklamimin e biznesit në gazetat e kohës.

Krahas rrobaqepësive e dyqaneve që qepnin e tregtonin veshje për vajza e gra u hapën edhe Sallonet e Bukurisë, të cilat ofronin trajtime të ndryshme për bukurinë e tyre, që nga prerja e flokëve, manikyr e masazhe. Këto sallone në disa raste pranonin edhe vajza si praktikante duke dhënë mësimë në këtë fushë.

Kur interesi për rrobaqepësinë e modën shtoej nga një qytet në tjetrin, duke i dhënë një trajtë tjetër mendësisë së prapambetur në vend, vëllezërit Hoti nga Shkodra, e çuan në një stad më lart industrinë e bukurisë në Shqipëri. Ata hapën Fabrikën e Sapunit dhe Parfumit që prodhonte një larmi të madhe parfumeshe, kolonjash e sapunësh, për gra e burra.

E gjithë kjo panoramë u plotësua me infrastrukturën kinematografike. Filmat që shfaqeshin në kinematë e kryeqytetit e në disa qytete të tjera kishin në to, aktore femra, të cilat me mënyrën e veshjes e të tualetit, u kthyen në imazhe për shumë femra shqiptare, duke u imituar prej tyre që nga veshja e deri tek modeli i flokëve. Moda e botës së zhvilluar kishte filluar të ndiqej edhe në Shqipëri, kryesisht në Kryeqytet.

LIGJI PËR HEQJEN E PERÇES

Të shtunën e datës **6 mars 1937** Parlamenti i Shqipërisë votoi ligjin që ndalonte gruan shqiptare që të mbulonte fytyrën me mbulesën e zezë, apo perçe.

Neni 1

Ndalohen femrat me mbulue fytyrën e tyre tanësisht ose pjesërisht me çdo mjet mbulimi. Kontra-vajtësat dënohen me gjobë të randë deri në 500 fr.ari.

Neni 2

Bashkë-shorti i pa-veçuem, ati ose kujdestari nën autoritetin e të cilëve ndodhet femra që dhunoj dispozitën e sipër-tregueme, në qoftë se nuk kanë udhtruar autoritetin e tyre për me ndaluar atë dhunim, dënohen për të vetmen këtë vepër, me gjobë të randë nga 20 deri në 1000 fr.ari dhe me ndalim nga ofiqet publike për një kohë nga një deri në tre vjet.



Ligji kishte në total 7 nene, të cilat përcaktonin qartë gjoba të rënda për çdo nxitje e favoritizim për mosrepsetim të ligjit.

Miratimi i ligjit, solli për pasojë edhe nevojën për ndryshimin e veshjes dhe krijimin e veshjeve të reja, për të zëvendësuar percent që mbulonte të gjithë trupin e grave.

IGINIA PASQUALI NË TIRANË!

E pasi kishin nisur përpjekjet e para me hapjen e rrobaqepësive dhe heqjen e perçeve me ligj, një tjetër ngjarje në fillim të vitit 1937 do të gëlonte në ambjentet e zonjave të kryeqytetit. Bëheshin gati, ato që ishin më në gjendje, dhe që arrinin të ndiqnin sadopak modën, të prisnin, të shihnin, e të takoheshin me një nga ikonat e modës italiane.

Kështu, në numrin e 7 marsit 1937 të gazetës “Drita” u botua një shkrim për vizitën e pritshme në kryeqytet të Iginia Pasquali, një ndër krijueset e modës kombëtare italiane. Zonjusha Pasquali vinte në Tiranë, pasi kishte përfunduar një tur mode në Londër, Paris, Romë, Milano... Dhe pas gjithë këtyre kryeqendrave evropiane, lajmi i mbërritjes së saj edhe në Tiranë nuk kishte sesi të mos ishte në fokusin dhe vëmendjen e atyre mediaeve që publikoheshin në kryeqytet. Ardhja në Tiranë e zonjushës Pasquali pritej me shumë interes që ndiqnin Modën dhe donin të mësonin akoma më shumë për veshjet e bukurinë e tyre.

“Nji cilësi e veçantë e zonjushës Pasquali asht kjo: Ajo pikturon mbi trupin e gravet, pse për çdo person krijon typin e teshës dhe ngjyrat qi përshtaten ftyrës”.

FABRIKË PËR PRODHIMIN

E STOFAVE ME LESH VENDI NË SHKODËR

Që nga viti 1930 në Shkodër kishte filluar nga puna një fabrikë për përpunimin e stofrave të leshit me anën e industrisë shtëpiake. Dyl Bego Ademi nga familja e inustrialistëve të njohur shkodranë, Ademi, pronarë të fabrikës së duhanit “Taraboshi” prodhonte stofë nga leshi i vendit me vegj (avlementa) të thjeshta nga ato që gratë shqiptare përdornin në shtëpitë e tyre për të bërë pëlhurë pambuku e mendafshi.

“Qe – thotë Dyl Bego Ademi ndër më të parat



fjalë – petkat qi kam bamë me lesh vendi dhe veg të grave të populli” – dhe më paraqet një kostum stofe leshi të tjerrun krejt hollë e mirë e të punuem krejt bukur si në pikëpamje të përlyturës ashtu edhe të kombina-sionit të ngjyrave. Nji përgjasim i fortë i stofës engleze.

“E stofa e këtij kostumi – thotë z. Ademi – nuk ka kushtue ma tepër se 89 lekë. Po me ket lesh kam të thurrun edhe një pullover dhe çorape sporti, dhe më paraqet fotografën e tij i mveshun krejtsisht me robe të bame me lesh vendi dhe me mjete të thjeshta”.
(Gazeta “Drita” 31 mars 1937)


SFILATA E PARË E MODËS NË SHQIPËRI

Në vitin 1956, në Tiranë u zhvillua parada e parë e modës për veshjet e grave e të fëmijëve.

Veshjet ishin nga më të ndryshmet, por porosia ishte që të ishin të thjeshta dhe pa shumë ngjyra. Ato ishin prodhuar nga Ndërmarrja e Prodhimit të Veshjeve sipas modeleve, skicave që kishin paraqitur nga sektori i përkatës i modelimit. Aty u ekspozuan veshje për të gjitha stinët, veshje për punë në qytet e në fshat, pallto për të rritur e fëmijë, veshje fëmijësh për klasën e parë dhe veshje të tjera për fëmijët.

Vajzat që sfiluan në paradën e parë





TOPTANI

kënaqësi

NË ÇDO COPËZ



SE VERA
SHIJOHET
NË **TOPTANI**



www.toptani.com.al

SI DUKEJ “MODA” E ANTIKITETIT

Nga gërmimet arkeologjike të kryera në shumë zona të vendit, në disa vendbanime të lashta të të parëve tanë, ilirëve, nga thellësia shekullore e nëntokës, përveç materialit arkeologjik për historinë e të parëve tanë, janë nxjerrë edhe objekte që përdoreshin si mjete stolie dhe zbukurimi nga vashat ilire.

Byzlykë, kapse rrobash dhe flokësh, unaza, rruaza për zbukurimin e gushës dhe të veshjeve në pjesën e gjoksit, vathë, pasqyra e shumë të tjera janë mes gjetjeve. Përdoreshin që nga shekulli i 5-të e i 6-të para erës sonë e deri në mesjetën e hershme.

VASHA E VLORËS

I përket shekullit IV p.e.s. Është skalitur prej guri gëlqeror, 0.87 m e lartë. Ajo përfaqësonte një vajzë të re me tipare të imta dhe delikate. Më shumë se për realizimin artistik, statuja kishte rëndësi për veshjen e saj të veçantë. Vajza kishte veshur një këmishë me mëngë të shkurtëra, të ngushta, të holla, të ngjitura pas trupit. E ngjashme me veshjen e damës antike shqiptare të Gurit të Zi. Mbi këtë këmishë vajza kishte hedhur një veshje të dytë, prej pëlhure të trashë, që vinte duke u mbledhur në pjesën e sipërme. Që nga gjoksi kjo veshje ndahej në pala dyshe, të rregullta, të ngjeshura, që zgjeroheshin duke zbritur poshtë, ku pëlhura qëndronte fare lirisht. Në supet, në bel dhe në buzën e poshtme të veshjes, dallohej qartë një rrip i

ngushtë. Pjesa e tretë e veshjes ishte mantel prej stoffe, me dimensione më të vogla, i pajisur në buzë me një kordele që dallohej dhe në çdo anë të tij kishte nga një xhufkë. Manteli e mbështillte figurën vetëm pjesërisht, duke i lënë zbuluar një cep të dorës dhe të krahut të majtë. Pas shpine manteli rrotullohej nga e djathta e në lartësinë e ijeve ishte mbështjellë në pala, duke kaluar përpara i mbajtur nga dora e djathtë.

Forma e veshjes ishte vërtet tipike, ajo dallohej krejtësisht nga tippet e veshjes klasike ilire dhe, ç’është më e rëndësishmja, po në krahinën e Vlorës ishin gjetur statuja të ngjashme me të.

Simboli i etnografisë ilire vjen edhe nga Rodoni, ku është gjetur busti pa kokë i një vajze. Kjo për shkak të

rëndësisë së garderobës së kostumit të vjetër popullor të vajzës ilire. Ajo mban të veshur një jelek karakteristik me shirita në supe e në brez. Afërsisht si veshjen e kësaj statue kanë edhe një numër i madh monumentesh arkeologjike të gjetura në pika të ndryshme të vendit.

STOLITË ARBËRORE

Ashtu si ilirët edhe arbërit e mesjetës së hershme kishin stoli të e zbukurimet e tyre. Në prodhimet artistike të arbërve përmenden stoli të veshjeve dhe të trupit, të përgatitura prej argjendi, bronxi dhe ari. Stolia më karakteristike e arbërve të mesjetës së hershme, shekujt 6-të e 8-të, ishte fibula me këmbë të përthyera, e përdorur me një funksion të dyfishtë, praktik e dekorativ, për kapjen e zbukurimin e veshjes. Spikatin edhe zbukurimet për gjoksin, vathët, sidomos ato prej argjendi me filigram, teknikë kjo e njohur që në kohët e lashta. Vend të rëndësishëm zënë edhe varëset e tipeve të ndryshme, si qaforet, byzlykët, rruazat e unazat.



shqiptare u zgjodhën me parametrat e përshtatshëm fizik, në përshtatje edhe me veshjet. Parada e parë e modës pati goxha interesim dhe u mirëprit në Tiranë dhe ndoshta kjo e trembi pushtetin komunist, i cili nuk e lejoi të zhvillohej më. Në vend të paradave të modës, organizoheshin vetëm ekspozita nga Ndërmarrjet e Prodhimit të Veshjeve (NPV-të e dikurshme), ku prezantoheshin veshjet që prodhoheshin nga secila ndërmarrje.

Në **fillim të viteve 60-të**, bashkë me lëvizjet e ndryshme shoqërore për ndryshimin e disa zakoneve të vjetra, të cilat synonin barazinë e gruas në shoqëri, filloi edhe dhënia e këshillave për mënyrën e veshjes. Fjala e udhëheqësit komunist, raportet në Kon-

gresin e Partisë e të grave, i kushtonin një rëndësi të madhe rolin të gruas në shoqëri, veshjes, sjelljes, martesës e gjithçkaje tjetër që kishte të bënte me përditshmërinë e jetës së grave, në qytet e në fshat.

Revista “Shqiptarja e Re”, organ i Bashkimit të





VAJZA E SHEKUJVE KLEITIA

Emri ilir i Kleitias dikur ka qenë emri i një vajze të gjallë të Durrahut. Ajo është veshur me kostumin ilir vajzëror, me jelekun e brendshëm me shirita dekorativë tek rrobat anash, me një kezë mbi kokë. Rreth qafës ka një gjerdan.

Grave të Shqipërisë, gjatë atyre viteve, botonte rregullisht, në çdo numër të saj këshilla për veshjen e gjithçka tjetër që kishte të bënte me ndryshimin e imazhit të femrës në pushtetin e ri që ishte vendosur në vend pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

“Vishuni thjesht dhe bukur” ishte motoja e veshjes që orientohej në ato vite.

Sugjerimet ishin po ashtu të thjeshta e të kuptueshme për popullatën:

- Veshja duhet t'i përshtatet moshës dhe pamjes së përgjithshme të njeriut. Veç kësaj, duhet të dihet se në ç'raste duhet të vishet kjo ose ajo rrobë, që të mos biesh shumë në sy si e veshur shumë luks ose me një kostum të papërshtatur për një rast të caktuar.

- Si rregull, rinia mund të mbajë rroba të modeleve më të modës, prej stofi me ngjyra të hapta e të gjalla.

- Të rejat nuk duhet të blejnë sende shumë të shtrenjta, më mirë të blejnë më shpesh sende jo të shtrenjta. Blerja e sendeve të shtrenjta dhe shumë të modës nuk tregon aftësinë për t'u veshur. Duhet të dini se një model që i shkon një njeriut, nuk i shkon edhe tjetrit.

- Kur bëjmë provë një rrobë, pallto, kostum, fustan, duhet të shihemi në pasqyrë të madhe për të parë gjithë trupin me këpucë, me çantë.

- Modeli i fustanit për vajzat e reja duhet të theksojë cilësitë e mira të trupit dhe të korigjojë ose të zbusi të metat e tij. Për trupat e trasha dhe të gjata rekondohen fustane me forma të thjeshta, pa zbukurime të tepërta.

- Kur beli është i shkurtër (lart) rekomandohen të bëhen fustane të paprera ne mes ose me bel të ulët. Nuk duhet të bëhen breza të gjerë dhe gjithfarë kollanash me ngjyrë të hapët.

FABRIKA E TRIKOTAZHIT NË KORÇË

Nuk ishte rastësi që fabrika e Trikotazhit në Korçë të ishte ndër fabrikat më të famshme në vend. Sepse korçarët e kishin traditë, që nga fabrika e parë e krijuar në fillim të shtatorit 1925 kur Ali Alizoti që kishte ardhur nga Greqia me familjen e tij, dhe ortaku Nazim Ypi (daja i sportistit të mirënjohur Asllan Rusi) hapën fabrikën e parë. Vetë Nazimi shkoi në Gjermani për blerjen e makinerive pasi kishin shitur të dy palët pronat në Veria dhe Kozan të Greqisë.

Pasi dështoi kjo tentativë e parë, në vitet '30, Nazim Ypi e vazhdoi dhe krijoi linjën e trikotazhit.

Fabrika ngriti dhe një dyqan shitjesh në Tiranë dhe në Vlorë.

Puna në këto fabrika vazhdoi deri në 1947 kur pushteti popullor i dalë nga lufta, i shtetëzoi. Ishte pikërisht kjo fabrikë që do të përgatiste plejadën e qindra punëtorëve të specializuara për të punuar në trikotazh dhe në saje të kësaj tradite kjo industri funksionoi deri vonë.

Më vonë, nga vitet '60, nga shtypi i kohës duket qartë se fabrika vazhdonte shkëlqimin e saj në pararojën e modës së atyre viteve. "Si veproni për të ditur kërkesat e guston e konsumatorëve?

"Lidhja me organizatat e masave, sugjerimet e teknikëve dhe të vetë punëtorëve. Ne shpesh herë organizojmë takime me përfaqësues të organizatës së gruas, organizojmë ekspozita të modeleve të reja dhe presim sugjerimet e mundëshme. Veç këtyre na ndihmojnë edhe propozimet e punëtorëve.

"Për të bërë një palë çitjane duhen 8 metra mëndafsh, që kushton 8 mijë lekë, ndërsa një fustan i mirë dhe i bukur kushton 3 mijë lekë. Diferenca është 5 mijë, me të cilat mund të blesh shumë gjëra të tjera", përgjigjej përgjegjësjë e repartit të modelisteve, Theli Veshi.

Pas viteve '80, në fabrikën e trikotazhit në Korçë prodhoheshin ndër të tjera trikotazhe të brendshme e të sipërme, me fije pambuku e sintetike për të gjitha moshat, çorape me fije pambuku e sintetike, penj makine e dore, si edhe penj për qëndisje, perde pambuku e sintetike etj. Modelet ishin projekte të Byrosë Teknike të Ndërmarrjes së Prodhimit të Veshjeve nga piktorë e modelistë të saj, që ideonin duke i shoqëruar edhe me kodin përkatës. Madje, deri edhe rroba pune e veshje për fshatin reklamoheshin, por në këtë rast të modeluara nga specialistë të Byrosë Teknike të Bashkimit Qendror të Kooperativistëve. Pastaj veshja në plazh, nga fustanet te rrobat e banjës dhe këshillat në qepjen e tyre.

MODA E VESHJEVE PËR KOOPERATIVISTET

Një problem i madh për kohën ishte edhe veshja e grave të fshatit.

Fshatarët shqiptarë nuk

duhet të ishin më ato të dikurshmet, që binin të flinin me të njëjtat rroba që shkonin në punë, me ato shkonin edhe në arë ose në pyll, me ato edhe në Pazar. Ato duhet të kishin një stil të re veshjesh, për punë e për të dalë. Për të ruajtur anën estetike të këtyre veshjeve, duheshin krijuar modele për fshatin. Gratë e vajzat e fshatrave duhet të shkonin në punë me veshje të thjeshta, të lehta e të përshtatëshme.

Në fundin e viteve 60-të, në shumicën e fshatrave të Shqipërisë gratë kishin hequr veshjen e rëndë dhe e kishin zëvendësuar atë me një veshje të përshtatshme për punë, më higjienike dhe më praktike. Por, vihej re se kjo veshje jo kudo ishte e hijshme, pasi ajo zakonisht përbëhej nga tuta të gjera dhe mbi të një fustan basmeje ose fanellate. Në dimër mbi fustan vishnin edhe triko lesi. "Që gruaja kooperativiste të ishte me veshje të rregullt edhe në punë, - propoznte propaganda e kohës, - do të ishte më mirë që të përdorte





Siguria Juaj Prioriteti Ynë

Paketat e Shëndetit

01

EKONOMIKE

BAZË

02

03

STANDART

SUPERIOR

04

Na Kontaktoni!



MË SKANO





pantallona dhe një bluzë të gjatë mbi to”.

MODA E VESHJEVE PËR PLAZH

Në **prag të verës së vitit 1971**, në redaksinë e revistës “Shqiptarja e Re” filluan të vinin letra nga të reja, të cilat kërkonin të njiheshin me modelet e veshjeve për plazh. Pjesa më e madhe e tyre ishin studentë që kishin përfunduar vitin shkollor dhe përgatiteshin për të shkuar me pushime, por edhe nga vajza e gra që punonin në sektorë të ndryshëm.

Kërkesës së këtyre vajzave, redaksia e revistës iu përgjigj duke botuar në numrin e muajit maj disa kostume banje prej doku, ose basma kombinati që mund të priten lehtë edhe ato vetë.

OMODA JASHTË PROPAGANDËS KOMUNISTE!

Jashtë këshillave e modele të propagandës komuniste për mënyrën e veshjes së gruas kooperativiste dhe asaj që jetonte e punonte në qytet, ishte edhe një tjetër modë që ndiqej në Tiranë. Pantallonat caëboy e me shtrat të shkurtër, të kombinuara me këmishat e ngushta u bënë, veshja e preferuar e të rinjve të kryeqytetit, si të shkollave të mesme edhe të rinisë universitare. Në kryeqytetin e atyre viteve filluan të vishen nga një pjesë e rinisë edhe pantallonat xhins, sigurisht nga ata që i kishin mundësitë për t'i gjetur, dhe që përgjithësisht vinin nga jashtë. Toleranca kulturore deri në vitin 1973 krijoi një atmosferë lirie veprimi e veshje në pjesën më të madhe të rinisë së kryeqytetit, ndikuar edhe nga fakti që në Tiranë ishte vendosur ajka e intelektualëve dhe artistëve shqiptarë. Festivalet e Këngës u ktheyn gati në parade mode për këngëtalet femra që merrnin pjesë në të, ku spikasnin fundet e shkurtëra e dekollet si dhe kombinimet shumëngjyrëshe.



500 + ZINC+ **D3** *DIRECT*

PËRTHITHJE MAKSIMALE

Rrit imunitetin

Lufton viruset

Zn

D3

C

- **funksionimin normal të sistemit imunitar**
- **mbrojtjen e qelizave nga stresi oksidativ**

Bustina të tretshme

Merret pa ujë

Shtesë ushqimore



TE “MAMA’S” RESTORANTI NË PRISHTINË QË U VURI “VIZËN” EVROPIANËVE

Shpejtim Përcejli, një mesoburrë tek të 50-at, nuk ngurroi që në derën e restorantit të tij në Prishtinë “Mama’s”, ngjitur me zyrat e EULEX, të vendosë një tabelë: “No entry for EU citizens without visa”. Në një rrëfim për revistën Newsbomb.al, Shpejtimi tregon sesi la mërgimin për t’u rikthyer në Kosovën e çliruar: emocionet, të qarat, brimat si fëmijë në rrugët e Hellbron në Gjermani kur NATO bombardoi Serbinë. E mandej, 13 vitet si prishtinali me restorantin e tij dhe vendimin drastik, derisa kosovarët të trajtohen njëllëj me shtetasit evropianë...

Nga REZARTA DELISULA

Me një korridor të gjatë, ku vetëm në tokë mund të shkelësh mbi pllaka sepse në çdo cep të vendit sheh lule të llojeve të ndryshme, aq sa të duket se po hyn në një lulishtari dhe jo në një restorant, me vargje të pafundme dritash që llamburisin gjatë natës, karrige e tavolina të vendosura në rregull, sikur të jesh në një restorant evropian, i rrethuar nga gjithë anët veç me punime druri, me një guzhinë evropiane e ngjitur me zyrat e EULEX në Prishtinë, gjendet restoranti “Mama’s”. Në Prishtinë është shumë i famshëm, pse jo, dhe në Kosovë. Jehona e Mama’s ka mbërritur edhe në Shqipëri, për një vendim sa të guximshëm, aq edhe kuptimplotë të pronarit të këtij restoranti: asnjë shtetas evropian, nuk pranohet të drekojë, darkojë, apo edhe të pijë një kafe në oazin e bukur të bar-restorantit. Vendimin e ka marrë vetë pronari prishtinali.

Ai është një burrë i guximshëm, që edhe pse i është dashur shumë punë dhe mund për të arritur një nivel të mirë jetese, sot rrezikon të humbë para për një vendim që ka marrë së fundmi: t’i bëjë embargo shtetasve të BE për

të hyrë në restorantin e tij në Prishtinë.

Ky është Shpejtim Përcejli, 50 vjeç por kur bisedojmë me të, kuptojmë se i gjithë ky guxim, i vjen nga ndjesia e të ndjerit si një 18 vjeçar rebel. “No entry for EU citizens without visa”. Kjo është tabela e vendosur në hyrje të lokalit Mama’s, që ndodhet pranë zyrave të Eulex në Kosovë, dhe do të vazhdojë të qëndrojë aty në formë proteste deri sa Kosovës t’i liberalizohen vizat për në Bashkimin Europian.

Në vitet 1990 atëherë kur Jugosllavia nisi shpërbërjen dhe shumë të rinj thirrreshin ende për të kryer shpërbimin ushtarak, nisën largimet masive drejt shteteve evropiane në kërkim të një jetë më të mirë, në kërkim të lirisë. Shpejtimi atëherë 18 vjeç u nis në Gjermani, ku u martua me një vajzë kosovare, por jeta e tyre nuk ishte aq e thjeshtë për t’u përballuar. Si një i ri që duhet të mbante dhe familjen e sapokrijuar, Shpejtimi punonte dy punë, thuahe gjithë ditën. Nga mëngjesi herët deri në 16.30 shkonte si punëtor në një firmë që merrej me izolime, suvatime dhe lysterje godinash, ndërsa nga ora 17.30, punonte kamarier dhe pjatatarës në një lokal.





“Më është dashur të punoj shumë me u kujdes për shpenzimet e familjes, banesën, ushqimin ndërsa rrogën tjetër për me kursy për Kosovën, pasi gjatë qëndrimit tim në Gjermani filloi dhe rezistenca e armatosur n’Kosovë, dhe ne atëherë si mërgatë, jemi organizuar, kemi punuar shumë dhe kemi mbledh shumë të holla për luftën” thotë Shpejtim Përçeji ndërsa shton se edhe pse jo fizikisht në luftë, emigrantët kanë kontribuar shumë për vendin e tyre.

LIRIA E SHUMËPRITUR

“Më kujtohet kur përfundoi lufta edhe është liru Kosova prej okupatorit serb. Në ato momente vendosa me u kthi në Kosovë isha me gruan dhe tre fëmijët. Kur i tregova shefit tim se po kthehem në vendlindje ai mendoi se po bëja shaka, dhe më tha se s’kisha pse të kthehesha në një shtet të sapo dalë nga lufta, i djegur dhe i kallur në tmerr. Ja kam fillu me qajt si fëmijë dhe si sot më kujtohet se edhe të ma kishin shtrur rrugën me diamante prej Shtutgartit deri Berlin unë do të kthehesha në Kosovë, sepse unë e du vendin tim, e du lirinë” - thotë Shpejtimi. Mes emocioneve, rrëfen se momenti më i keq për të ka qenë lufta, ndërsa sot vazhdon të jetë diskriminimi i vendit të tij nga Bashkimi Europian. Por trishtimi i hapi udhë shpejt entuziazmit, kur NATO u angazhua me gjithë fuqinë e vet kundër okupatorit serb e bombardimet po i jepnin fund “bishës” së plagosur. “Atë natë kam qenë në Hellbron në Gjermani. Dola në rrugë e shtrihesha, bërtisja, qaja prej gëzimit. Ka qenë një moment i papërshkrueshëm pasi kuptova se po vinte liria për vendin tim dhe se mundesha me u kthi në shtëpi. Kurrë, sa të jem gjallë nuk do ta harroj atë çast”, tregon Shpejtimi. Duke qenë besimtar musliman ai ia atribuon këtë mrekulli Zotit, sepse vetëm Zoti mund të bënte mrekulli me angazhuar NATO-n për të ndihmuar Kosovën e tij.

ME “VIZË” NË RESTORANT

“Faji për mos realizimin e vizave normal që i takon edhe politikanëve kosovarë pasi është paaftësia e tyre për të ndëruar një shtet të mirëfilltë, një ligj të mirëfilltë, një arsim të mirëfilltë



Mama’s është hapur rreth 13 vjet më parë dhe i është vënë ky emër pasi pronari i saj, Shpejtimi ka punuar vite më parë në një lokal që quhej kështu. Lokali është përballë zyrave të Eulex dhe janë ato klientët më të shpeshtë që e popullonin restorantin. Sot, shtetasve të BE i është ndaluar hyrja në këtë lokal, pa “viza”



si dhe një ekonomi të mirëfilltë. Por prapë se prapë, kësaj radhe jam shumë i sigurt që fajin e ka pasur Bashkësia Ndërkombëtare ose Unioni Evropian i cili nuk na dha liberalizimin e vizave, prandaj më lindi dhe ideja për këtë lloj proteste” – thotë Shpejtimi.

Në samitin e fundit të BE më datë 22-23 qershor Kosova përjetoj një zhgënjim absolut kur BE nuk liberalizoi vizat për shtetasit kosovarë. Vetë kosovarët ishin të bindur se këtë herë do e fitonin, pasi sipas tyre kriteret për liberalizimin e vizave i kanë plotësuar qysh në vitin 2018. Ishte pikërisht hidhërimi për refuzimin e BE, lindja e protestës së Shpejtim Perqejlit.

“Ky ishte një diskriminim total për ne ndaj vendosa dhe unë të bëj një shenjë proteste ndaj Unionit Evropian dhe me vendos ndalesën ndaj shtetasve të Unionit, të cilët prej shumë vitesh kanë frekuentuar lokalin tim, por tani ato nuk e kanë këtë të drejtë pa viza” thotë pronari i lokal Mama’s, duke shtuar se menjëherë pas vendimit në Samit, ai lajmëroi klientët që punojnë në Euleks se do të vendoste tabelën për ndalimin e tyre në shenjë revolte për mosliberalizimin e vizave.

Për fat, Shpejtimi është mirëkuptuar nga ata, dhe ka pasur raste që i kanë dhënë të drejtë në vendimin e marrë. “Deri më sot nuk kam pasur asnjë rast që të më duhet të largoj dikë nga lokali sepse askush nga punonjësit e EULEX nuk është futur në lokal. Pllakarta është mjaft e dukshme dhe e qartë, dhe ato janë njerëz të kulturuar në këtë aspekt, i respektojnë ndalesat, e kam fjalën për qytetarët e Bashkimit Evropian” - vijon Shpejtimi.

Ai na tregon se miqtë, shokët, klientët e kanë vlerësuar shumë vendimin e marrë për ndalimin e shtetasve të BE në lokalin Mama’s, madje sipas tyre vendim të tillë duhet të marrin edhe pronarët

e lokaleve të tjera në shenjë revolte.

Megjithatë ky vendim i Shpejtimit do të ketë kosto për biznesin dhe të ardhurat që ai merr prej tij. “Përderisa restoranti që unë kam varet më së shumti prej klientëve që punojnë në EULEX sigurisht që do të kem humbje, por unë jam i përgatitur. Kjo humbje ja vlen për me e ba për shtetin tim, rininë e vendit tim, për fëmijët e mi, ndaj unë jam i vendosur ta mbaj këtë vendim deri në liberalizimin e vizave për Kosovën” – shprehet pronari i lokalit Mama’s. Shpejtimi i bën thirrje të gjithë biznesmenëve

“Përderisa restoranti që unë kam varet më së shumti prej klientëve që punojnë në EULEX sigurisht që do të kem humbje, por unë jam i përgatitur. Kjo humbje ja vlen për me e ba për shtetin tim, rininë e vendit tim, për fëmijët e mi, ndaj unë jam i vendosur ta mbaj këtë vendim deri në liberalizimin e vizave për Kosovën”



kosovarë për t'u vënë këtë lloj emargo shtetasve të BE, sepse sipas tij sa më shumë të jenë aq më e fortë do të jetë protesta karshi Unionit Evropian. “Bashkimi bën fuqinë dhe ndryshimin”, përfundon bisedën 50 vjeçari që i mbylli derën e restorantit shtetasve të BE në Prishtinë.



MIELLI ASSOS



MIELLI I PARË SHQIPTAR BIO



BASHKIM ALIBALI

Artisti i pakohë...

Këtë tetor Bashkim Alibali do të festojë 65 vjetorin. Një këngëtar që flet pak nëpër intervista, por që radhitet i pari ndër ata që arritën të bëjnë koncert recital në kohën e komunizmit. 150 koncerte recitale kam bërë atëkohë dhe paguhesha 150 lekë, rrëfen ai për revistën Newsbomb.al. Dhe vlerësimi më i madh që ka marrë nuk është monetar, duartrokitjet e spektatorëve janë ato që i kanë mbushur zemrën

Nga SUADA DACI

Intervista ime e parë me Bashkim Alibalin ka qenë në vitin 2019-të dhe ndonëse njiheshim ju siguroj që nuk ishte fort e lehtë ta bindja për këtë rrëfim të plotë e të gjatë për revistën tonë. U takuam rreth orës 10:30 në një nga baret afër lagjes së tij (lagjen nuk ua them) dhe artisti i njohur ishte super korrekt. Që në nisje të bisedës e pyes se cila është formula e rinisë së tij të përjetshme dhe me humorin që e karakterizon (humor shkodran besoj se nuk keni nevojë për më shumë detaje) më thotë se janë genet e mira, por edhe përkujdesja që bashkëshortja e tij Mimoza tregon për të.

Bashkim Alibali është këngëtar i që me zërin e tij bëri të madh e të vogël të dashurohej me këngën e nënës me tekstin e Zhuljana Jorganxhi. “Në Duart e Nënës” mori menjëherë dashurinë e spektatorëve, jo vetëm për tekstin kuptimplotë, por edhe për zërin e papërsëritshëm dhe tonalitetin që i dha Bashkimi.

*Në duart e tua u rrita o nënë
Netëve pa gjumë/ Piko! dritë e hënës
Dhe veten qortova/ Të zënë në gabime
Zemrën kur ta theva/ O e shtrenjta ime
Vij nga rrugë e gjatë/ Ti më pret e para
T’i puth ato duar/ Mbushur plot me mall
Në çdo rrudhën tënde/ Në çdo flok të bardhë
Unë shoh fëmijërinë/ Hapin tim të parë
Dhe nga unë fëmija/ Kërkove në jetë
Të rritem i mbarë/ Për këtë tokë të shtrenjtë*

“Përpara se të vija këtu gruaja më tha mos kritiko njerëz në intervistë, kështu që do të jem i kujdesshëm”, thotë duke qeshur “Mjeshtri i Madh” i muzikës shqiptare. Zakonisht personazhet pub-

likë i pyes në fund për jetën e tyre private, por me zotin Alibali ndodhi ndryshe, rrëfimin e tij e filluam se si u njohë ai me bashkëshorten e tij Mimozën (së cilës i ka dedikuar dy këngë). Inxhinierja është kujdesur gjithnjë jo vetëm për pamjen e tij, por mbi të gjitha për muzikën e këngëtarit duke qenë një nga kritikët më të mëdha të tij. Madje- madje, nuk ka qenë aspak xhelozë për fanset e tij, veçanërisht vajzat, që e kanë ndjekur më kërkshëri karrierën muzikore të tij.

“Kam qenë shumë i njohur kur vendosa t’a ndaloja Mimozën, por kur iu afrova për herë të parë ajo më tha: “nuk të njoh fare”. Ishte totalisht injorim. Ajo ishte komshije me dajën tim. Nuk e dija që babai i saj, Iljazi kishte edhe dy vajza, përveç dy djemve. Sapo e pashë më lindi një shkëndijë e fortë dhe i kam shkruar një muaj nga pas. Doja të gjeja rastin kur ajo të ishte vetëm. E ndalova, protestoi edhe nuk donte të më fliste fare. Pas një viti kam folur me të edhe u fejuam. Thonë që po u martove me Alibaltë të mbajnë në pëllëmb të dorës”, tregon ai duke qeshur.

Nga fryti i kësaj dashurie ata sollën në jetë dy fëmijë, një vajzë dhe një djalë të cilët sot jetojnë jashtë shtetit.

“Vajza ka studiuar për drejtësi në Udine të Italisë, zotëron 5 gjuhë të huaja dhe bashkëshorti i saj është gazetar. Edhe vajza ka marrë statusin e gazetares, pasi merret me lajmet shqip. Ndërsa djali ka mbaruar për frengjisht, punon dizanji edhe Dj. Bën vetë muzikë e jeton në Gjermani...”, tregon Bashkim Alibali i cili mezi pret që të dy fëmijët ta

gëzojnë së shpejti me ndonjë nip ose mbesë.

“I them më bëni more gjysh, kam shumë dëshirë të rrisë fëmijë. I dua fëmijët janë moshë më e pastër dhe kanë shumë singeritet”.



“Mua më ka pëlqyer gjithnjë skena, përpara se të bëhesha këngëtar unë kam dal në teatër si aktor, se kisha dhe djalin e hallës aktor në teatrin Migjenin, babai i ka rënë mandolinës, pra ishim një familje shumë e lidhur me artin. S’kam lënë shfaqje pa parë që i vogël. Nëse s’do isha bërë këngëtar do isha bërë patjetër aktor”

POR SI KA QENË FËMIJËRIA E TIJ...

“Kam qenë një fëmijë shumë i prapë dhe i përkëdhelur, sepse nga fisi i mamasë kam qenë fëmija i parë. Kam qenë i shkathët më tepër se duhet dhe kur shkoja tek gjyshja bëja ndonjë prapësi. Ajo e kishte zakon nuk më fliste aty për aty, por kur bija në gjumë në darkë më fuste nën jorgan dhe më binte me thupër. Që atëherë më është hapur zëri nga të bërtiturat”, kujton ai. “Mua më ka pëlqyer gjithnjë skena, përpara se të bëhesha këngëtar unë kam dal në teatër si aktor, se kisha dhe djalin e hallës aktor në teatrin “Migjeni”, babai i ka rënë mandolinës, pra ishim një familje shumë e lidhur me artin. S’kam lënë shfaqje pa parë që i vogël. Nëse s’do isha bërë këngëtar do isha bërë patjetër aktor”, thotë ai.

ARTISTI EMBLEMATIK I FESTIVALEVE

Bashkim Alibali ka patur një jetë interesante artistike të mbushur me ngjarje, ku pasioni dhe këmbëngulja i kanë dhënë një vend të nderuar në radhët e këngëtarëve më të shquar shqiptarë.

Magjia e zërit ka qenë çelësi i sukseseve të tij.

Ishte Festivali i 10-të i RTSH-së kur u prezantua për herë të parë me gjithë shqiptarët dhe më pas ai do të merrte pjesë gjithnjë në këtë kompeticion, që për kohën ishte më i rëndësishmi në Shqipëri. Ai u shkëput 6 vjet nga skena (për shkak të festivalit famëkeq të 11-të) dhe pas këtij momenti, nëse i hedh një sy CV-së së tij artistike, vëren se ai nuk është shkëputur për asnjë moment nga ky festival dhe dalja e tij e fundit ka qenë në vitin 2011 me këngën “Këngën time merr vehte”. Andaj natyrshëm më lind pyetja nëse do të jetë pjesëmarrës në festivalin e këtij viti?!

“Jo. Nuk marr pjesë, sepse festivali e ka humbur kuptimin. Unë nuk shoh asgjë shqiptare përveçse matrapazllëk dhe korrupsion. Gjithë festivali bëhet për Eurovision,

çfarë është festivali europian?

Shumë më i bukur është ai i Sanremos”, thotë artisti shkodran, i cili është i pari artist që futi kulturën e recitaleve në Shqipëri.

KONCERTI I PARË RECITAL

“Kur kam realizuar koncertin e parë recital në vitin 1985, kam qenë i pari që kam bërë diçka të tillë në Shqipëri. Nuk e bëra në Shkodër sepse ishte një formë e re dhe kishin pasiguri që ta bënin një koncert të tillë, prandaj erdha në Pallatin e Kulturës në Tiranë. Dola pesë herë përpara publikut me atë recital. Pastaj më thirri drejtori i Estradës dhe e



 **FRANC ZHUDRA**

bëra 80 herë në Tiranë. Ndërsa në gjithë Republikën më shumë se 150 herë”, kujton ai.

Keni patur mjaftueshëm këngë për të realizuar një projekt kaq të madh e pyes unë. “Kam lënë edhe këngë jashtë tij aq shumë këngë kam patur. Koncertin e ka prezantuar Koço Devole dhe fute-shin brenda natë për natë 600 veta, ndërsa unë jam paguar thjesht 150 lekë”.

PO SI E KUJTON AI KOMEDIANIN E NJOHUR, KOÇO DEVOLE...

Unë me Koçon kam shkuar shumë mirë, madje gjatë koncertit kemi bërë edhe shumë numra e batuta. Ai thoshte tani vjen përpara jush Bashkim Alibali unë nuk i dilja nga krahu i duhur, por nga ana tjetër dhe publiku qeshte me lot. Në mes të skenës kishte shkallë ku më vinin vajza që më përqaфонin. Dhe pas kësaj mblidhet komiteti i Partisë dhe kërkuan që të hiqej shkalla. Kjo për mua ishte kulmi i injorancës.

Mirëpo Koço me thoshte të morën në qafë ta hoqën shkallën. Kam dashur të bëjë një koncert interaktiv përshembull kur këndoja këngën “Duart e nënës” merrja në skenë një zonjë”.

E di që këto gjëra i bëjnë sot në koncerte këngëtarë të njohur botëror, si përshembull Enrique Iglesias, - e ngacmoj unë.

“Kur më kanë bërë dikur një intervistë përpara viteve ’90 më thonin që kisha shumë të përbashkëta me babain e tij, Julio Iglesias. Po i thashë kam shumë të përbashkëta me të. Këngëtar ai, këngëtar unë. Ai ka makinë edhe unë kam makinë, rroje, mishi, etj. Ai ka bërë lutje në komitet për shtëpi edhe unë të njëjtën gjë kam bërë. Unë nuk e kam imituar kurrë Julion”, tregon Bashkim Alibali.

MARRËDHËNIA E VEÇANTË ME KOSOVËN...

Shumë nga artistët e njohur shqiptarë të para viteve ’90-të kanë patur fansa fanatikë edhe përtej



“E kam pas shumë të vështirë të kërkoj sponsorizime, sepse më duket lypje moderne. Kështu që të gjitha klipet i kam paguar vetë. Ne si komb nuk punojmë për edukimin patriotik. Unë kam jetuar në një qytet të vogël në Gjermani dhe atje ishte një monument i një tenisteje gjermane. Krenohej qyteti me të, krenohej Gjermania me të”



kufinjëve shqiptarë e veçanërisht në Kosovë. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me Bashkim Alibalin, madje me Kosovën e lidh një histori shumë e veçantë, që nis me emrin e tij... BASHKIM.

“Në vitin 1980 kam shkuar për herë të parë me grupin popullor të radio Shkodrës në Kosovë. Babai im ka qenë arsimtar dhe ka punuar për zhdukjen e analfabetizmit menjëherë pas luftës në 1975. Aty ka patur një shok të ngushtë që kanë jetuar në një shtëpi bashkë dhe që ndanin çdo gjë me njëri-tjetrin. Kur do nisesha për për Kosovë i thashë babait çfarë të të sjellë dhe ai më tha vetëm më tako Berhan Badivukun. Kur u prishën marrëdhëniet ata i dhanë besën njëri-tjetrit që nëse do të lindin djemë



duhet t'ja vendosnin emrin “Bashkim”. Prandaj e kam unë emrin Bashkim por edhe djali i tij, Bashkim Badivuku... Në Kosovë na dukej vetja si perëndi, sepse na shikonin me shumë mall. Atyre u mungonte Shqipëria dhe kishin dashuri shumë të madhe. U desh lufta që ne të bashkoheshim përsëri, por mendoj që politika na ka ndarë”.

PENGU I BASHKIMIT ALIBALI

Nëse i hedh një sy karrierës së tij artistike do të shohim që përveç hiteve të tij solo ka edhe bashkëpunime të sukseshme me kolegë si Irma Libohova, Valdete Hoxha, Mimoza Dhamo, Eduart Jubani, etj. Por me cilin prej tyre e ka peng që nuk e ka bërë një duet.

“Me Vaçen. Kam pas projekt për të bërë një këngë me të. Kemi qenë së bashku me Avni Mulën në shtëpinë e saj për drekë (madje e mbaj mend kemi

ngrenë mish me fasule) edhe i thashë “Vaçe ti je e madhe, por për mua je shumë e vogël. Pse? - Më tha. Sepse do bëhesh më e madhe nëse do të bësh një duet me mua. Më raft pika, - tha, - do bëj një këngë me ty”. Por nuk u pugen kushtet. Ka qenë një shoqëri shumë e pastër, ne e kemi dashur shumë njëri-tjetrin. Unë kam marrë pjesë edhe vitet e fundit në festival por shihte gjithkush punën e vet nuk e vriste njeri mendjen për tjetrin”, tregon artisti shkodran, i cili është si një orë që nuk di të ndalet kur vjen puna tek muzika.

DY ALBUME NË NJË...

“Kam dy albume të reja për të publikuar. Kam bërë gjithashtu edhe një këngë për një prift, i cili ishte njeri me kokën plot që të jepte përgjigje për çdo gjë. E kam bërë edhe shqip edhe italisht. Tekstin e ka bërë Zhuljana Jorganxhi, muzikën Flamur Shehu, orkestracionin e ka bërë Sokol Marsi, dhe një pjesë tjetër e kam bërë në Finlandë. Këtë këngë dua t'ja çoj Papës së Romës dhe Berlusconi, kaq mund të them... Kam edhe një këngë tjetër që flet për tolerancën fetare, kënga mbyllet me fjalët “le të lutemi bashkë për Shqipërinë”. Albumin do ta bëj me dy CD, dizanjin ma ka bërë djali. Është Bashkimi në vitin 1979 i përqafuar nga Bashkimi i viteve të fundit dhe e kam titulluar “Dje edhe sot”. Dje është një CD më vete që ka 17 këngë si dhe Sot që ka po 17 këngë brend”, thotë ai.

Jo më kot e pyes nëse shpenzon shumë për klipet dhe këngët që ka realizuar së fundmi dhe ai thotë:

“E kam pas shumë të vështirë të kërkoj sponsorizime, sepse më duket lypje moderne. Kështu që të gjitha klipet i kam paguar vetë. Ne si komb nuk punojmë për edukimin patriotik. Unë kam jetuar në një qytet të vogël në Gjermani dhe atje ishte një monument i një tenisteje gjermane. Krenohej qyteti me të, krenohej Gjermania me të”. Ajo i dha Gjermanisë, por edhe Gjermania e nderonte atë. Ndërsa këtu ndodh e kundërta. Megjithatë unë kam ndërë kënaqësi kur më kanë respektuar si artist, nuk kam rrahur kurrë gjoksin që unë jam Bashkim Alibali. Gjoksi im i rrahur ka qenë duartroktija e spektaktorit. Dashuria e publikut të mban gjallë”, përfundon ai.



NIPI I LEGJENDËS SË FUTBOLLIT FLET NGA KANADAJA, KRYEBASHKIAKU: SI DO FESTOJMË NË SHKODËR



Të shkruash për Loro Boriçin, padyshim është kënaqësi, privilegj dhe përgjegjësi e madhe. Vepra e tij qëndron ende e gjallë mes gjithë sportdashësve shqiptarë. Data 4 gusht do të shënojë 100-vjetorin e lindjes, për legjendën e futbollit shqiptar që nuk do të vdesë kurrë. Në këtë shkrim për herë të parë do ketë intervistë ekskluzive të pabotuar ndonjëherë në mediat shqiptare me familjarët e tij, larguar 30 vite më parë nga Shqipëria. Në Shkodër ngrejnë supet për të afërmit e tij, por ata janë të shumtë sikurse sukseset e Loros në futbollin shqiptar. Qyteti i lindjes po përgatitet për një event të madh që do të mbahet në stadiumin që mban emrin e legjendës shkodrane. Kryetari Bardh Spahia tregon mes emocioneve se çdo të ndodhë në ditën e 4 gushtit

Nga RETIN TOKA

KLORINDA BORIÇI, MOTRA E LORO BORIÇIT 92-VJEÇARJA QË JETON NË TIRANË

“Alo”, dëgjoj një zë nga ana tjetër e telefonit. Ishte disi i lodhur, por me dëshirën për të mos qenë vetëm.

“Nënë Klorinda, jam një gazetar dhe jam i interesuar për t’iu takuar”, iu përgjigja unë. “Po, urdhnoni, urdhnoni”, më ktheu me një ton shumë mikpritës. M’u duk se kisha zbuluar një thesar të madh. Kisha pyetur në shumë vende dhe të gjithë ishin në dijeni se vetëm një motër e Loro Boriçit ishte gjallë, por nuk kishin informacion se cila dhe ku ishte vendodhja e saj. Pas hulumtimesh të shumta, arrita të gjej se jetonte në Tiranë, në moshën 92-vjeçare. Gjunjët s’i përgjigjeshin më si dikur, por mendja po. Kujtimet për të vëllanë i ruante të freskëta. Pamundësia fizike e saj më detyroi të mos e

100
vjetori
i
**LORO
BORIÇIT**



TRAJNERI LORO BORIÇI (NË MES)
DUKE DISKUTUAR ME LIN SHLLAKUN
NË PUSHIM TË NDESHJES

**“Nga bisedat me të, mbaj mend që i
njihte lojtarët nga detajet më të imëta.
Në atë kohë më fliste shumë për të
ndjerin Arben Minga. Më thoshte se
ka potencialin për t’u bërë lojtar i
madh. Dhe më vonë kjo u vërtetua.
Koha i dha të drejtë xhaxhait tim”**

më pas nisi të tregonte gjitha kujtimet. Loro Boriçi kishte qenë një futbollist mjaft i talentuar, por mbi të gjitha një njeri fantastik. Kështu e mban mend edhe Platori: *“Ishte i jashtëzakonshëm, mjaft i zgjuar edhe përtej fushës së sportit. Ulesha të komunikoja me të dhe ndihesha shumë rehat. Shpesh e pyesja dhe për futbollin në vitet 70’-80”*.



SPORT

shqetësoja më shumë, megjithëse dëshirën e kishte të madhe për të treguar. Nuk u ndala këtu, por vijova të kërkoj.

Loro Boriçi vjen nga një familje e madhe shkodrane. Kishte pasur dy vëllezër, Markun dhe Pjerinin, si edhe tre motra, Angjelinën, Margaritën dhe Klorindën. Loro ka lindur në 4 gusht të vitit 1922, ishte i mesit nga djemtë. Ndërsa motrat më të vogla.

KUJTIMET PËR LEGJENDËN SHKODRANË, KONTAKTET ME NIPIN NË KANADANË E LARGËT

Në bindjen time kisha krijuar gjithë intervistën që do të zhvilloja me një person të afërm të Loro Boriçit. Ishte e pamundur që një legjendë si ai, që rridhte nga një familje e madhe, mos të kishte trashëgimtarë. Edhe pse vetë s’u martua kurrë, Loro kishte lënë nipër dhe mbesa. Dhe në fakt kështu rezultoi. Arrij të gjej nipin e tij. Plator Boriçi, i biri i Pjerin Boriçit prej 25-vitesh ishte zhvendosur në Toronto të Kanadasë. Ishte “CEO” i lartë i programimeve në një kompani prestigjioze kanadeze. *“Më thoni, çfarë doni konkretisht për xhaxhain tim?”*, ishte përgjigja e parë e tij. Pasi e kuptoi se do të ishte pjesë e artikullit të revistës së Newsbomb, hezitoi fillimisht, por



PLATOR BORIÇI

ARBEN MINGA, KOLLOSI I FUTBOLLIT SHQIPTAR QË U PIKAS NGA LORO BORIÇI

Bisedat me Loro Boriçin, nipi i tij i ruan të gjalla dhe kjo duket nga imtësitë që zbulon. Arben Minga, kollosi i futbollit shqiptar, është zbuluar pikërisht nga legjenda shkodrane. Shumë pak mund ta dijnë, por sot për herë të parë e tregon edhe Platori. *“Nga bisedat me të, mbaj mend që i njihte lojtarët nga detajet më të imëta. Në atë kohë më fliste shumë për të ndjerin Arben Minga. Më thoshte se ka potencialin për t’u bërë lojtar i madh. Dhe më vonë kjo u vërtetua. Koha i dha të drejtë xhaxhait tim”*. Loro e donin të gjithë. Ishte jo vetëm shok skuadre i shkëlqyer, por më vonë edhe trajner i suksesshëm. Me sa duket dinte t’i merrte maksimumin futbollistëve. *“Ai ishte si një psikolog, kur vinte puna për të drejtuar lojtarët e skuadrës. Arrinte të merrte maksimumin nga të gjithë ata që kishte në dispozicion”,* tregon më tej Platori.

“I QETË DHE I RAFINUAR”, SI E PËRSHKRUANTE I VËLLAI PJERINI, LORO BORIÇIN

Asnjëri nuk ata nuk jeton më, megjithatë Plator Boriçi arrin të kujtojë fjalët e të atit për xhaxhain. Tregon se si e shihnin në fushë dhe cilësitë që kishte. *“Ishte një lojtar me një teknikë të rafinuar, golashënues dhe shumë i*



LORO BORICI (NË RRETH)

qetë. Kapiten i vërtetë në fushë. Kështu thoshte babai. Ndoshta kjo ka qenë dhe cilësia më e mirë që e bëri gjithashtu një trajner shumë të rëndësishëm në Shqipëri”, shprehet Platori.

Në Shqipëri nuk kanë shkruar ndonjëherë për familjarët e Boriçit. Në një ceremoni të zhvilluar para disa vitesh në Shkodër, ka qenë e ftuar vetëm e motra e tij, Klorinda. Por, të dokumentuar nuk ka asnjë artikull. Ndofta largësia e familjarëve ka bërë që të zbehet edhe interesi. Megjithatë në familje, Platori tregon se vijnë të mbajnë të gjallë kujtimet për xhaxhain dhe gjithë fisin në përgjithësi: *“Familja gjithmonë ka qenë e dedikuar për të ruajtur veprën e tij për t’ia transmetuar brezave të tjerë. Për Loron ka edhe një film dokumentar në Kinostudio të realizuar nga Mark Topollaj. Një pjesë kryesore e nipërve dhe mbesave jetojnë larg. Unë dhe motra ime gjendemi prej shumë vitesh në Kanada. Ndoshta kjo është arsyeja se pse mediat nuk kanë pasur mundësi të na kontaktojnë thjeshtë, siç mund ta bënin në Shqipëri”.*

PROFILI SPORTIV, SUKSESET ME VLLAZNINË, LAZION DHE PARTIZANIN

Loro Boriçi nisi për herë të parë futbollin profesionist në moshën 15-vjeçare. Gazetarët e kohës tregojnë se ai luajti për herë të parë në ndeshjen Vllaznia-Dragoi i Pogradecit, më 6 qershor 1937, kur ishte 14 vjeç e 297 ditë. Një rekord! Interessant është fakti se, vëllai i tij më i madh, Mark Boriçi, luante si portier.

“Nuk mbaj mend shumë nga xhaxhai tjetër, por më kanë thënë që merrej dhe ai me sport”, tregon shkurtimisht Platori. Loro Boriçi ishte një pasionant i madh pas futbollit, me një trup

elegant, tepër i fuqishëm teksa bëhet pjesë e Vllaznisë, së vitit 1937, njëherësh edhe kampionati i shtatë Kombëtar dhe i fundit i para LIIB. Nuk zgjati shumë aventura me Vllazninë, pasi ai shkoi në Itali për të kryer studimet në Fakultetin e Drejtësisë. *“Kalimi i Loros në Itali është edhe i dokumentuar. Në sezonin 1941-1942 ai kaloi te Lazio”,* vijon bisedën nipi Plator Boriçi që duket mjaft i mallëngjyer nga kujtimet që i kalojnë në mendje.

Në vitet 1941-1943, shtatlarti shkodran u ble



Loro Boriçi nisi për herë të parë futbollin profesionist në moshën 15-vjeçare. Gazetarët e kohës tregojnë se ai luajti për herë të parë në ndeshjen Vllaznia-Dragoi i Pogradecit, më 6 qershor 1937, kur ishte 14 vjeç e 297 ditë. Një rekord! Interessant është fakti se, vëllai i tij më i madh, Mark Boriçi, luante si portier



nga ana e Lazios nga Vllaznia. Paralelisht me studimet, ai jepte kontributin e tij edhe për italianët. U aktivizua në 18 ndeshje dhe shënoi 4 gola si sulmues. Një nga ndeshjet e tij të mëdha është ajo Lazio-Juventus 3-2, për një të tetat e Kupës e Italisë 1942-1943 (27 shtator 1942), ku përballë njëri-tjetrit ishte Loro Boriçi i Lacios dhe Riza Lushta i Juventusit, një duel shqiptarësh. Loro shënoi golin e barazimit 2-2, dhe më pas goli i tretë i realizuar nga gjermani Koenig (62') vulosi edhe eliminimin e juventinëve. Gjithsesi, një vit më parë, Riza Lushta kishte arritur të fitonte e Italisë me Juventusin e vitit 1942, kurse Naim Kryeziu kampionatin e Italisë, me Romën, po në vitin 1942.

Përvoja me Lazion e ndihmoi të rritej shumë teknikisht. U rikthye sërish te Vllaznia, ku në 1945 fitoi titullin e parë kampion me shkodranët. Deri në vitin 1948 kontribuoi për ekipin e vendlindjes. Në Kampionatin Ballkanik të vitit 1946 të mbajtur në Shqipëri, kuqezinjtë dolën kampion pasi mundën Rumaninë 1-0 në finale. Një nga fotografitë më të njohura të pas-finales është ajo e Boriçit në stadiumin

“Qemal Stafa” me një kuror dafine në kokë dhe trofeun në duar. Më vonë u detyrua të shkonte te Partizani pas një fletëthirrje për ushtar. Me të kuqtë luajti plot 7 vite duke qenë një nga futbollistët kryesorë të kohës. Pas mbylljes së karrierës si futbollist, Loro u bë trajneri i Partizanit, “shtëpia” e tij e dytë, duke iu përkushtuar tërësisht trajningut. Fiton tituj kampion si trajner me të kuqtë: 1962-1963, 1963-1964 dhe 1970-1971. Në palmarasin e tij janë dhe katër Kupa Republike: 1964, 1966, 1968 dhe 1970. Loroja bën Partizanin, Kampion Ballkani në vitin 1970, por ai është dhe kampion Ballkani me Shpresën, dhe fiton me Partizanin medaljen e argjendtë në Lojërat e Ushtrive të Lindjes (Hanoi) 1963. Loroj dallohej për “dashurinë” e tij për futbollistët e fuqishëm fizikë, duke sjellë një numër të konsiderueshëm nga rrethet.

KOMBËTARJA DHE AFTËSIA PËR TË MENAXHUAR FSHF-NË

Si futbollist, Loro Boriçi u aktivizua në 24 ndeshje me Kombëtaren, 11 me fanellën e Vllaznisë dhe 13 të tjera me Partizanin. Sikurse kishte bërë me ekipet e kampionatit, ashtu edhe me kuqezinjtë la gjurmë. Ndeshja e tij e parë daton në vitin 22 shtator 1946. Ndërkohë me Kombëtaren kontribuoi edhe si trajner pasi u tërhoq nga futbolli. Nuk do të harrohet asnjëherë ndeshja kundër Republikës Federale Gjermane në vitin 1954. Gjermanët vinin në Tiranë me statusin e nënkampiones së botës. Formacioni i Shqipërisë ishte: Dinella, Gjinali, Jorgaqi, Vaso, Rragami, Shllaku, Pano, Mema, Zhëga, Kazanxhi, Bizi. Ky barazim vazhdon të mbetet një nga sensacionet e futbollit tonë, ndërkohë që në Gjermani konsiderohet si një humbje. Trajneri Helmut Shën do të shprehej: “Unë dua t’i bëj një kompliment shumë të madh skuadrës shqiptare dhe trajnerit të saj, kolegut tim Loro Boriçi. Edhe një herë komplimente për Shqipërinë e futbollin shqiptar dhe për skuadrën e tij të mirë”. Dhe të mos harrojmë se Shqipërisë iu anulua nga gjyqtari Marshall, një gol i rregullt i realizuar nga Frederik Gjinali.

Boriçi është njeriu i Kinës, në mesvitet 1970, ku dha një ndihmesë të madhe në zhvillimin e futbollit kinez me stërvitjet, leksionet e drejtimin e skuadrave kineze. Dhe kinezët ia ditën shumë lektorit, pedagogut e njeriut që shkriu gjithçka nga jeta e tij në ato vite. Ato befasoheshin për orët e shumta që ai punonte gjatë tërë ditës. Ai arriti të krijonte atje një ekip shumë të mirë dhe atë gjë e bëri me shumë pasion.

Siç e përmend edhe Platoni në intervistë, Loro Boriçi ka qenë edhe një menaxher i shkëlqyer. Ai u dallua si organizator i zoti duke fituar menjëherë një vend në drejtimin e Federatës Shqiptare të Futbollit. Ai ishte anëtar i Kryesisë së Federatës Shqiptare të Futbollit, i Këshillit të Bashkimit të Fizikulturistëve Sportivë Shqiptarë, pedagog në Institutin e Kulturës Fizike “Vojo Kushi”. Ai ka drejtuar



edhe ekipet kombëtare për të rinj dhe Shpresa. Për kontributin e tij, Loro Boriçi, është nderuar me titujt e lartë sportivë: “Mjeshtër i Merituar i Sportit”, “Trajner Kombëtar”, si dhe urdhra të ndryshëm: Urdhri “Naim Frashëri” Klasi i Parë, Urdhri i Artë “Naim Frashëri”, Medalje pune: “Mjeshtri i Madh i Punës”.

25 PRILL 1984, NDARJA NGA JETA E LORO BORIÇIT

25 prilli i vitit 1984 ishte ditë e zezë për gjithë Shqipërinë, veçanërisht për sportdashësit shqiptarë. Loro Boriçi u nda nga jeta prej një sëmundje të rëndë. Atë moment e kujton edhe nipi i tij që thekson se një faktorët që ndikoi në vdekjen e parakohshme ishte konsumi i tepërt i duhanit. *“E mbaj mend atë periudhë. Kam qenë në shkollë të mesme, para se do të emigroja për në Kanada. Ishte disi e pabesueshme edhe për familjen tonë. Edhe pse la futbollin, kishte një trup atleti. Por, problemi më i madh ishte du-*

hani. Pasi ndërpreu aktivitetin sportiv, nisi ta konsumonte shumë. Besoj se kjo ishte e vetmja e metë e tij”, flet mes kujtimesh Plator Boriçi, që mundohet të na e servirë gjithçka sa më të gjallë. Siç tregohet edhe në dosierët e ndryshëm, për Loron u tregua një kujdes i posaçëm nga ish-sekretari i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, dhe më pas Sekretari i Parë, Ramiz Alia. Ai u dërgua jashtë shtetit për kurim, por nuk mundi të mbijetojë.

100-VJETORI I LINDJES, EVENTI I MADH NË SHKODËR

Data 4 gusht do të shënojë edhe 100-vjetorin e lindjes së Loro Boriçit. Me iniciativë të Federatës Shqiptare të Futbollit, Bashkia Shkodër në bashkëpunim me klubin e Vllaznisë do të organizojnë një event të madh në stadiumin “Loro Boriçi” në kujtim të legjendës së futbollit shqiptar. Kryetari Bardh Spahia, në një intervistë për Newsbomb tregon se përgatitjet kanë nisur prej ditësh dhe janë në rrugën e duhur. Madje, s’i fsheh emocionet duke thënë: *“Filimisht më lejoni t’ju falenderoj për intervistën. Organizimet e 100-vjetorit të Loro Boriçit janë drejt fundit. Ka akoma disa detaje të vogla për t’u fiksuar, por po ecim mirë me organizimin. Kur bëhet fjalë për ikona të sportit të Shkodrës dhe vëmendje ndaj qytetit tonë, jemi gjithmonë të hapur për bashkëpunime me qëllim promovimin e vlerave të cilat qyteti jonë mbart”.*

Sporti për çdo shkodran është si “fe”. Padyshim është vendi ku bashkohen të gjithë me qëllimin e përbashkët, mbështetjen e ekipit të zemrës. *“Kur ka ndeshje Vllaznia”, thotë kryetari Spahia, “e gjithë vëmendja përqendrohet në stadiumin “Loro Boriçi”. Edhe pse klubi i Vllaznisë është 100 përqind subjekt privat, vijojmë të japim gjithë suportin tonë, veçanërisht për anën e infrastrukturës”, shton më tej ai.*

E për t’u kthyer sërish në eventin e datës 4

Si futbollist, Loro Boriçi u aktivizua në 24 ndeshje me Kombëtaren, 11 me fanellën e Vllaznisë dhe 13 të tjera me Partizanin. Sikurse kishte bërë me ekipet e kampionatit, ashtu edhe me kuqezinjtë la gjurmë. Ndeshja e tij e parë daton në vitin 22 shtator 1946



LORO BORIÇI (NË RRETH)



KRYETARI I BASHKISË SË SHKODRËS, BARDH SPAHIA

gusht, kryetari pyetet nëse kujton diçka nga legjenda Loro Boriçi. Atë vit që është ndarë nga jeta, ka qenë afro 8-vjeç. Megjithatë me kujtimet e një fëmije e ka të vështirë të nxjerrë nga memoria diçka. *“Tani aq sa mund të mbajë mend kujtesa e një fëmije di të them këtë, që nga babai veçanërisht, por edhe pjestarët e tjerë të familjes, për sportin na flasin plot pasion dhe na merrnin në çdo ndeshje që Vllaznia luante në stadium. Padiskutim që këtu kanë nisur kontaktet e para me futbollin dhe sportin në tërësi dhe ajo lidhja shpirtërore që ne shkodranët e kemi të natyrshme”. Por, të afërm të tij i kanë treguar: “Veçonin artin e tij në fushën e blertë, por mbi të gjitha qytetarinë që e karakterizonte. Sepse ja diktonte prejardhja familjare, por diçka konkrete mbi këtë personalitet nuk kujtoj për momentin. Janë shumë vite të kaluara nga bisedat e bëra me familjarët e mi. Në Shkodër ka aq shumë rrëfime për këto mjeshtra që kemi patur fatin ti kemi në gjirin tonë, e kuptoni vetë sa shumë është folur e treguar për secilin prej tyre”.*

ORGANIZIMI, SHKODRA DHE TIRANA NË LËVIZJE

Organizimi i eventit në nder të 100-vjetorit të lindjes, ka vënë në lëvizje edhe kryeqytetin, Tiranën. Zyrtarë të Federatës Shqiptare të Futbollit, por edhe dashamirës të sportit janë vënë në kërkim të materialeve apo sendeve që kanë lidhje me Loro Boriçin. Për këtë, kryetari Bardh Spahia s’e fsheh kënaqësinë, përkundrazi shpreh: *“Besoj jo vetëm Shkodra e Tirana, por e gjithë Shqipëria e ka në nderin e saj ti kujtojë dhe nderojë të tilla figura që i dhanë emer sportit në vendin tonë. Ju e kuptoni fare mirë se si shkodran ndjehem shumëfish i emocionuar që bijtë e Shkodrës lartësohen në historinë e futbollit shqiptar dhe marrin vendin që i takon”.*

Të nderosh një figurë të tillë si Loro Boriçi, padyshim është privilegj i madh. Kur pyetet nëse ndihet se po organizon diçka njësoj si për babain e vet, kryetari emocionohet dhe thotë: *“Nëse pyesni sot çdo shkodran se çfarë ndjen kur vlerësohet një figurë e qytetit të tij, të gjithë*

pa përjashtim do ta përshkruajnë me ndjesinë e njëjtë, sikur të ishte për njerëzit e familjes. Janë njerëz të rallë që në kohë aspak të zakonit me talentin e tyre i dhanë emër Shqipërisë dhe na bënë krenar. Prandaj krenohemi me to dhe ndjehemi mirë që janë pjesë e familjes tonë të madhe, e Shkodrës së vlerave e qytetarisë”.

Kryetari Bardh Spahia me stafin e vet po punon maksimalisht që të mos mungojë asgjë në atë ditë të veçantë. Kurioziteti është i madh se si ai e mendon Loron nëse do të ishte gjallë. Kush do të ishte mesazhi i këtij qytetari të mrekullueshëm shkodran që është ende mes nesh përmes veprës së tij? *“Ai do të fliste ashtu siç ka ditur gjithmonë, me artin e tij në fushën e lojes dhe jam i sigurtë që po të ishte në mesin tonë, do ta bënte duke zbritur në stadium përpara tifozerisë kuqeblu. Duke shkelmuar topin dhe duke i dhënë mesazhin lojtarëve të sotëm që për Vllazninë të japin gjithçka në fushë”.*

EVENTI, TË FTUARIT SPECIALË NGA BASHKIA E SHKODRËS

Në një organizim të tillë padyshim s’mund të mungojnë as të ftuarit specialë. Sportistë, ish-futbollistë dhe shumë të tjerë do të jenë në 4 gusht në shkallët e stadiumit “Loro Boriçi”. A do të ketë ndonjë familjar? Fillimisht për këtë përgjigjet Platori, i cili kur pyetet përtypet për shkak të largësisë së madhe, megjithëse dëshira për të qenë prezent e josh. *“Nuk di ta them. Nëse do kisha më shumë kohë, besoj se do të vija. Por, deri tani s’jam ftuar”, e thotë me zërin e prerë. Ndërsa kryetari Spahia ka menduar: “Patjetër që do të ketë të ftuarit specialë. Sportistë, kolegë, trajnerë e miq do të jenë të gjithë bashkë për të kujtuar një nga emrat në të mëdhenj të sportit Shkodran. Ka për të qenë një përkujtim siç ai e meriton. Shkodra ka qenë dhe do të jetë gjithmonë shtëpia e futbollit, e artit e kultures dhe traditave më të mira, prandaj sot kemi detyrimin ta mbajmë fort këtë trashigimi që na bën të gjithëve krenar. Loro Boriçi është një prej tyre, që i përket plejadës së artit!”, përfundon ai.*

| Nga SUADA DACI

Hey si jeni me vapën?! Temperatura po rriten në të gjithë territorin e vendit duke shkuar deri në 40 gradë celsius dhe çështja është si të vishemi sa më lehtë në këto ditë të nxehta korriku. Në fakt ka edhe nga ata që mund t'i bien për shkurt të rrinë vetëm me bikini duke e kaluar të gjithë kohën vetëm në plazh, por ju kujtojmë se ka edhe nga ata që lejet i marrin në gusht, madje madje ka edhe nga ata të shuarit (si puna ime) që lejen do ta marrin në shtator. Po ne jse ky nuk është halli juaj...

Por le të kthehemi tek moda në kohët kur njerëzit nuk durojnë dot lëkurën e tyre jo më teshat në trup. Jo më kot stilistët po tregohen shumë të zgjuar, çdo herë e më shumë kanë filluar të kursejnë copat dhe tashmë veshjet tona janë 50% të zbuluar dhe 50% të mbuluar. Ajo që ka qenë risia e këtij sezoni është pikërisht të treguarit sa më shumë pjesë nga trupi juaj dhe sa më pak veshje nga stilistët e modës... (Bëj shaka) Edhe këto ditë të nxehta e kemi mundësinë që të tregojmë se sa stil dhe "cool" jemi kështu që ja disa sugjerime që kam unë për ditët e nxehta të verës...

Pra po thonim sa më shumë të zbuluar

Fustane të tilla nuk janë më ekskluzivitet i familjes Kardashian. Po t'i hedhësh një sy Instagramit dhe faqeve të ndryshme të blogereve ato i sheh të gjitha me fustane të tilla. Madje stilistja me origjinë shqiptare Nensi Dojaka është ajo që bëri revolucion me këto veshje në industrinë e modës. Kujdes ky stil s'është për të gjithë por kjo nuk do të thotë që nuk duhet të guxoni.

TË VISHESH APO
të
ç'vishesh
KJO ËSHTË
ÇËSHTJA





Fustanet e shkurtër

Nuk dalin kurrë nga moda, madje kush ka këmbë të bukura është momenti që t'i nxjerrë në pah ato sepse këto fustane janë ideale si për pjesën e paradites, por edhe në mbrëmje. Janë trend i kësaj vere sidomos kur janë edhe me ngjyra.



NEWS
BOMB
FASHION BOMB



Rrobat e banjos mund t'i përdorni si crop-e

Një pjesë e rrobave të banjos mund të funksionojë edhe si crop-top apo si kanatjere, mjafton që poshtë tyre të keni një fund me shumë ngjyra. Veshje ideale për në fundjavë kur jeni në plazh ose kur doni të shkoni në pishina.

Këpucët me platformë

Vera 2022 i përket sandaleve dhe këpucëve me platformë. Këpucët me platformë janë adekuate si për vajzat e shkurtra por edhe për ato që janë të gjata.



Mendo rozë

Dëgjoni me vëmendje çdo nuancë e rozës është perfekte për këtë verë. Nëse nuk keni ende një veshje me këtë ngjyrë në garderobën tuaj do bënit mirë të nxitonit për të blerë diçka të tillë.



Mëngët e fryra

Ishin në modë vitin e kaluar por ne nuk na mbetet hatri që janë në modë edhe këtë vit. Të tregojnë një staturë shumë femërore. Këto mëngë mund të jenë pjesë e një fustani, ose mund të zgjidhni edhe një crop me xhinse, por duhet vetëm që ai të ketë mëngë të fryra.



Mos harroni linon

Fustane lino, pantallona lino (nuk ka rëndësi të gjata apo të shkurtra). Jo më kot stilistja e njohur Cindy Conroy e ka cilësuar linon si kënaqësinë e verës. Përveçse nuk e ndjen vapën dukesh edhe stil me lino.

Mos neglizhoni aksesorët

Lisa Sanches editorja e modës në "The Nines" thotë se nga dielli nuk të mbron vetëm kremi mbrojtës, por edhe aksesorët e bukur. Prandaj një kapele e bukur, syza, varëse, çantë e madhe duhet të jenë patjetër pjesë e rëndësishme e garderobës suaj.

Këmishat e natës


Victoria Beckham sapo ka hedhur në treg linjën e saj më të re të këtyre fustaneve elegante dhe e dini se sa kushtonin ato 1000 paund. Nejse ka edhe variante më të lira që do t'ju bëjë të dukeni super elegante.



© COPYRIGHT

Nga KADRI VOKOPOLA

KINOFJALËKRYQ



HORIZONTALE

1. Penn aktor.
5. Metheny kitarist.
7. Magjistari i Lee Falk.
12. Janë pagesa shërbimesh.
14. Aulenti që qe arkitekte.
15. Një italiane.
16. Në krye të opozitës.
17. Nino Rota.
18. Ndahen me kufij.
22. Earhart që qe pilote.
27. Diftong në teatër.
28. Aktorja në foto.
34. Lumi i Bernës.
37. Aktori në foto.
39. Ajo pinot është gri.
40. Një racë qeni.
41. Janë lloje njerëzish.
42. Agjenci Transporti Sarandë.


43. Ekstre në ekstreme.
44. Qe arkitekt i famshëm me origjinë shqiptare.
48. Gjysma e festës.
49. _dhe shokët e tij në një film.
51. Massenot që qe kompozitor.
52. Ishin rivalët e Babilonasve.
54. Kërkohet shumë në vapë.
56. Turner këngëtare.
59. Mbyllin një dyqan.
60. Merren me nisma.
61. Nota e diapazonit.

VERTIKALE

1. Ndal! në kryqëzim.
2. Shkroi Korbi (inic).
3. Mbyllin një sirtar.
4. Anaïs e Delta e Venerës.
5. Lështu fillon paniku.

6. Arte pa re.
7. Në krye të masave.
8. Bronzi i romakëve.
9. Një rrugë në Paris.
10. Janë të Mëdha me Kubën.
11. Teke klase.
13. Film i Graeme Clifford.
14. Është edhe ai persik.
19. Lance aktor.
20. Gjysmë tandem.
21. Një lloj peshku.
23. Braha këngëtare.
24. Ente Furinizimi Rajonale.
25. Krijoi magjistarin Mandrake.
26. Adjusted Cost Base.
28. Irons aktor.
29. Ndërmarrje Sociale Industriale.
30. Poeti kur nuk pi.

31. Golemi soprano.
32. Ekstre në litar.
33. Një buall i Tibetit.
35. Kush nuk ka... s'është i zoti.
36. Kompozoi Berberi i Seviljes.
37. Kufizojnë lëvizjet.
38. Diftong në dietë.
42. Mund të skadojë.
45. Është e re me vello.
46. Armstrong që shkeli i pari në Hënë.
47. Emri i Boletinit.
49. Kështu fillon tema.
50. Fillojnë afrimin.
53. Ruajnë pa ujë.
55. Qëndro ndryshe.
57. Inicialet e Cruise.
58. Gati në krye.
59. Ekstre në Alaska.



MOJ E BUKURA SHQIPËRI!

HORIZONTALE

1. Sigla për bankomat.
5. Një abisin fisnik.
9. _Poetica e Horacit.
12. Kush është beson kollaj.
14. Institucione Arsimore Sarandë.
16. Foto 1.
20. Diana Ross.
21. Agjenci Prokurimi Publik.
23. Paul Anka.
25. Ishin heremitët majë kolonave.
26. Foto 2.
30. Ekstremitet në tunel.
31. Foto 3.
32. Gjysmë tandem.
34. Një bimë që përdoret edhe në gatime si erëz.
35. Fshihet nga gënjeshtarët.
39. Kufizojnë katetet.
40. Të fundit në tender.
42. Massimo këngëtar.
43. Një fazë gjumi.
46. Mund të jenë të rralla të tilla.
50. Mund të skadojë.

52. Ashtu si nuk rri zevzeku.

53. Elia që qe regjisor.
56. Është edhe ai i Hotit.
57. Këndohet në opera.
58. Benelli që qe dramaturg.
59. Qytet në Zvicër.
61. Mund të jetë kuzhine dhe gjaku.
62. Nastase ish-kampion i tenisit.
63. Film i Luc Besson.
65. Kështu fillon reforma.
66. Deti i Napolit.
67. Foto 4.
68. Metheny kitarist.

VERTIKALE

1. Gide i Imoralisti.
2. Pishtarë pa pishë.
3. Fund filmi.
4. Në krye të javës.
6. Ari në tabelë.
7. Ekstremitet në sirtar.
8. Sampras ish-tenist.
9. Ai i Shenjtë është papa.
10. Martin, rigjisor i The Front.
11. Frank, piktor e skulptor minimalist.
13. Mund të jenë lubrifikantë.
14. Mund të jetë një urdhër.
15. Një që punon për armikun.
17. Një pjesë e aspiratave.
18. Ishulli i Verne.
19. Janë ushtritë mike.
22. Édith e Milord.
24. Pak agnostike.
26. Grusht pa çifte.
27. Dolores që thirrej La Pasionaria.

28. Kështu fillon jeta.

29. Lumë në Francë.
33. Perandori që dogji Romën.
34. Shën_protomartiri.
36. Në krye të valles.
37. Ruhen në fund.
38. Qendër votimi.
39. Kush i kthen... braktis.
41. Është mjeshtri.
44. Një qengj i butë.
45. Arturo i Brecht. Arturo i Brecht.
47. Satelit i Uranit.
48. Kështu fillon terrori.
49. Edourd që qe piktor.
51. Fillojnë tinëz.
53. Një Teodor i paharruar që qe poet e politikan.
54. Abrashi mesfushor.
55. Masat pa ekstreme.
57. Falen pa fe.
58. Gjysmë siguri.
60. Rita këngëtare..
62. Diftong në dietë.
63. Në krye të noterëve.
64. Fillojnë tani.





HARD SUDOKU

						4		
	7		3		5			9
4			2	6	7			
				3			9	
		6		5	8	3		
			7		2		8	
						6		7
1		3						
	9						1	

MESATAR SUDOKU

	3		4		1		2	
								7
	9				6			5
	2							3
						1		
7		9		6	2			
4		1	9					
	6		8				3	
				5			4	

I LEHTË SUDOKU

9	6							
			7		5	2		
4					3		8	
	5		1		2			
							3	
8			3		4			6
1			9					5
		2		8			7	



KURIOZITETE

PSE MEKSIKANËT I QUANIN AMERIKANËT GRINGO?

Shumëkush ka dëgjuar, sidomos në filmat kryesisht western, ku meksikanët u drejtoheshin amerikanoveriorëve në termin gringo. Janë të shumta versionet që qarkullojnë për këtë, nga më të çuditshmet e më të pabesueshmet, por studiuesit dhe etimologët në më të shumtën e rasteve bien dakord se origjina e këtij termi lidhet me faktin që meksikanët, duke mos e kuptuar fare gjuhën angleze, e cilësonin gjuhën e tyre griego, pra greke, se për ta greqishtja ishte e pakuptueshme. Me kalimin e kohës fjala pësoi deformim dhe nga griego u bë gringo. Dhe po sipas studiuesve, nuk është e vërtetë, siç pretendojnë disa, se termi gringo përdorej si përçmim ndaj amerikanëve.




PSE MATERIALI QË PËRDORET GJËRËSISHT PËR **SKELET** DRITARESH E DYERSH QUHET DURALUMIN?

Shumë njerëz, duke u nisur nga bashkimi i fjalëve duro (italisht i fortë) dhe alumin, materialin e lehtë e lehtësisht të përkulshëm, të cilin që të gjithë e njohim, gabimisht mendojnë se bëhet fjalë për aluminin e përpunuar dhe fortësuar për t'iu përgjigjur nevojave të industrisë së aeronautikës e më gjerë. Në fakt e vërteta është se bëhet fjalë për një aliazh të alumin, bakrit, manganezit dhe magnezit, që e bën pra aluminin jo vetëm shumë të lehtë por edhe shumë rezistent ndaj përkuljeve. Por duro nuk ka të bëjë me i fortë, por është thjesht emri i Dürener Metallwerke, kompanisë që e realizoi patentën që në vitin 1909, Dur(ener) dhe alumin, pra duralumin.

PËRGJIGJET

PËRGJIGJE KINOFJALËKRYQ



PËRGJIGJE MOJ E BUKURA SHQIPËRI!



PËRGJIGJE HARD SUDOKU

3	6	5	8	9	1	4	7	2
2	7	1	3	4	5	8	6	9
4	8	9	2	6	7	1	5	3
8	5	2	6	3	4	7	9	1
7	1	6	9	5	8	3	2	4
9	3	4	7	1	2	5	8	6
5	4	8	1	2	9	6	3	7
1	2	3	5	7	6	9	4	8
6	9	7	4	8	3	2	1	5

PËRGJIGJE MESATAR SUDOKU

5	3	8	4	7	1	9	2	6
6	4	2	5	8	9	3	1	7
1	9	7	2	3	6	4	8	5
8	2	4	1	9	5	6	7	3
3	5	6	7	4	8	1	9	2
7	1	9	3	6	2	8	5	4
4	7	1	9	2	3	5	6	8
2	6	5	8	1	4	7	3	9
9	8	3	6	5	7	2	4	1

PËRGJIGJE I LEHTË SUDOKU

9	6	5	2	3	8	1	4	7
3	8	1	4	7	6	5	2	9
4	2	7	5	9	1	3	6	8
7	5	3	1	6	9	2	8	4
2	4	6	8	5	7	9	1	3
8	1	9	3	2	4	7	5	6
6	3	4	7	1	5	8	9	2
1	7	8	9	4	2	6	3	5
5	9	2	6	8	3	4	7	1

DASHI



Kuadri juaj yjor paraqitet në përgjithësi pozitiv, pasi Marsi nga pozicioni të Demi ju sjell energji e dinamizëm të mjaftueshëm për të përballuar sfidat e kësaj periudhe të nxehtë e mjaft të ngarkuar. Jeni disi në mëdyshe për të zgjedhur ndërmjet asaj që i keni vendosur objektiv vetes për të kryer dhe një ofertë të re që ju bën të ndjeheni përkohësisht mire. Sektori i financave duket se është përmirësuar ndjeshëm, por jo gjithçka shkon ashtu si duhet në raportet me të afërmit e miqtë.

DEMI



Pas një dhjetëditëshi të parë të turbullt, ku pasiguria për hapat që duhet të hidhni për të ardhmen ju ka kondicionuar ndjeshëm, ja ku vjen dëshja Mars-Merkur që ju risjell dëshirën për të reaguar e vullnetin për t'u përballur me sukses edhe me situata të ndërlikuara. Ndonëse në planin ekonomik nuk parashikohet ndonjë mrekulli, të paktën do të jeni të stabilizuar. Në planin sentimental, afrimi i Hënës mund të ndikojë në rihapjen e një bisede e për t'i dhënë fund një mosmarrëveshjeje.



PESHORJA

Gjatë kësaj periudhe, sidomos në dhjetëditëshin e dytë, do të keni ndjesinë e të ndodhurit midis dy zjarreve, ndërmjet pritshmërive nga ana e njerëzve tuaj më të afërt dhe kërkesave të po eprorëve tuaj në punë. Jeni gjithmonë në kërkim të ekuilibrit të duhura, por një hap në dukje i gabuar, mund të jetë një lloj felix culpa për ju. Një gabim pra që në vend që t'ju dëmtojë, t'ju sjellë avantazhe. Është një periudhë mjaft interesante për dashurinë, pasi do të keni Afërditën në anën tuaj.



BRICJAPI

Nuk duhet të pezmatoheni aspak nëse konstati se e keni të vështirë të përballoni ritmet e larta që ju imponohen nga konkurrenca e ashpër, pasi hyrja në shenjë e Marsit dhe mbështetja e Jupiterit bëjnë të rifitoni terren e madje të jeni një hap para rivalëve. Edhe pse në rrethana të caktuara mund të keni ndonjë problem me ndihmën e miqve tuaj do të mundni t'i bëni ballë. Kujdes në raportet me partnerin, sepse jo rrallë një farë "megalomanie" që ju ngërthen, ve në krizë marrëdhënien.

PESHQIT



Një farë monotonie që ju ka përfshirë në dhjetëditëshin e parë të këtij muaji do të reflektohet edhe në aktivitetin tuaj të përditshëm, ku rendimenti ka qenë në rënie. por ndikimi i Merkurit nga pozicioni të Gafornja ju sjell stimujt e duhur. Në fakt kuadri yjor duket shumë i favorshëm për ju por duhet të jeni më shumë të vëdijshtë për aftësitë tuaja dhe më të vendosur në hapat që hidhni. Jeni plot me energji pozitive dhe kjo duhet shfrytëzuar në maksimum për të arritur atë që dëshironi.

BINJAKËT



Tensionet e ditëve të shkuara ju kanë detyruar jo vetëm të ndryshoni taktikë, por edhe të hiqni dorë nga një objektiv që tashmë e konsideroni të paarrtshëm. Këmbëngulja nganjëherë ju çon në kryeneçësi të pakuptimtë e kjo mund të bëjë që në raportet me të tjerët të jeni disi problematikë, e në ndonjë rast edhe acarues. Ju pëlqen pavarësia dhe mendja juaj. por kjo nuk do të thotë se nuk duhet të tërhiqeni edhe kur dukshëm e shihni që jeni gabim. Pak më fleksibël edhe ndaj partnerit.



GAFORNJA

Arritjet tuaja të deritanishme mund të kenë shkaktuar smirën e dikujt tjetër, prandaj mund të prisni ndonjë përpjekje (fatmirësisht të pasuksesshme) për t'u sabotuar. Marsi e Merkuri ju sjellin stimujt të rinj, por fakti që ju zakonisht parapëlqeni të mbani një profil të ulët, shkon në favorin tuaj. Nuk mjafton vetëm dëshira për të bërë por duhet të keni edhe idetë e qarta për atë që duhet të bëni. Hëna e re dhe Afërdita ju bëjnë të matur e njëkohësisht edhe më të disponueshëm ndaj partnerit.



VI RGJËR ESHA

Pas një periudhe përgjithësisht të qetë, duket se gjërat fillojnë të ndryshojnë papritmas e me një shpejtësi që mund t'ju zerë në befasi. Marrëveshjet e paqarta që keni bërë deri më sot duket se ju venë në vështirësi e nuk do ta keni të lehtë të ruani ekuilibrit. Afërdita dhe Hëna janë në anën tuaj, por kujdes, sepse edhe pse ju stimulojnë të nxirni më të mirën tuaj, në ndonjë rast ju bëjnë agresivë. Mjaft interesant erosi, por në planin ekonomik është mirë të mbani nën kontroll financat.

HOROSKOP BOMB

QERSHOR 2022



LUANI

Dhjetëditëshi i parë i këtij muaji ka qenë mjaft intensiv për ju, pasi ju është dashur të përballeni me angazhimet e akumuluar, por falë ndikimit të Marsit do të keni stimujt e nevojshëm për t'ia dalë mbanë. Mund t'ju vijjnë shumë oferta e propozime por nuk duhet të hidhni hapa të nxituar pa pyetur më parë ekspertët dhe miqtë e mirë që nuk ju mungojnë. Hëna këtë periudhë stimulon fushën sentimentale dhe nuk përjashtohet që një njohje e re të jetë edhe një dashuri e re.



AKREPI

Duket se ky muaj ka filluar në mënyrë disi kaotike për ju, me situata që alternohen mes nervozizmit e mosmarrëveshjeve nga njëra anë dhe një dëshirë të brendshme për t'u hedhur në një aventurë të re. Marsi te Demi, edhe pse me një ndikim jo edhe aq të fuqishëm, mund të ju kthjellojë për t'i zgjidhur konfliktet në mënyrën më të mirë për ju. Ndryshime të ndjeshme pozitive priten në dhjetëditëshin e tretë dhe duhet të keni kujdes se mund të gjejnë të papërgatitur. Bëni kujdes me dietën.



UJORI

Pjesa e parë e këtij muaji nuk ka qenë nga më të mirat për ju, pasi keni qenë konfuzë dhe me mendime jo shumë pozitive, por dalëngadalë "qielli" juaj po hapet dhe Marsi e Merkurit në shenjë do t'ju sjellin ekuilibrit e nevojshme. Sidoqoftë priten një muaj kryesisht i favorshëm dhe duhet thjesht të përfitonin nga rastet jo të pakta që do t'ju paraqiten. Me ndikimin pozitiv të planetit të dashurisë, Afërditës, duket se edhe në planin sentimental gjërat do të shkojnë shumë mire. Kujdes paratë.

SHIGJETARI

Tensionet e brendshme në raport me partnerin apo edhe me njerëzit tuaj të afërt nuk zgjidhen duke iu shmangur përballjes, por duke marrë përgjegjësi e duke kërkuar kompromisin. Megjithatë, kuadri yjor për të lindurit e kësaj shenje pritet të jetë nga më pozitivët, pasi Marsi, Merkuri dhe Hëna janë në një orbitë shumë të favorshme. Disa ndryshime të domosdoshme në një plan tuajin duhen bërë pa mëdyshe sepse në fund rezultatet do t'ju japin të drejtë. Bëni kujdes me sëmundjet e stinës.

NEWS BOMB.al

ABONOHU
TANI!



REVISTA E PËRMUAJSHME
POLITIKO-KULTURORE

PËR TË BËRË ABONIMIN KONTAKTONI:

POSTA SHQIPTARE:



+355 68 50 80 753

Redaksia Newsbomb.al:



+355 69 67 32 020



abonime@newsbomb.al



newsbomb.al

204,791 FOLLOWERS



newsbomb.al

37.8k FOLLOWERS



NewsbombAl

3,456 FOLLOWERS